



Shoqata

Filladi

Shejh Abbas El Kumij

VENDQËNDRIMET E BOTËS TJETËR
(Rreth vdekjes dhe bota pas vdekjes)



Tiranë, 2008

Titulli i librit: Vendqëndrimet e botës tjetër

(Rreth vdekjes dhe bota pas saj)

Autori: Abbas El Kummij

E përktheu nga arabishtja: Afrim Smakaj


E redaktoi: Liseda Ramaj

Pëkuqjesja kompjuterike: Besnik Çela

Botoi: Shoqata Flladi



Shoqata
Flladi



Ia kushtoj këtë libër të gjithë dëshmorëve të qëndresës islame dhe ushtarëve të imam Mehdiut (shpirtrat tonë i jepen atij!)

Shahada
Fladi

Historia e librit

Libri “Vendqëndrimet e Botës Tjetër” ka një histori të rëndësishme, që tregon edukatën e lartë islame dhe madhështinë e autorit, dijetari i hadithit, Shejh Abbas El Kummij (Zoti qoftë i kënaqur me të!).

Autori i ka thënë djalit të tij të madh: “Kur kam shkruar dhe kam botuar librin *Vendqëndrimet e Botës Tjetër*, dhe kur libri mbërriti në qytetin e Kunit, libri kishte rënë në dorë të Shejh Abdurrazzakut, i cili shpjegonte rregullat e jurisprudencës në xhaminë e shenjtë të zonjës Ma’sume (Fatimeja, e bija e imam Kadhim) çdo ditë para dreke. Babai im, Muhamed Ridha, i cili kishte vizituar Kerbelanë dhe ishte i apasionuar pas Shejh Abdurrazzakut, merrte pjesë çdo ditë në dëgjimin e ligjëratave të tij.

Në një nga këto ligjërata, Shejh Abdurrazzaku kishte hapur librin dhe kishte filluar të lexonte për të pranishmit. Në të njëjtën ditë kur babai im arriti në shtëpi mu drejtua dhe më tha: 'Shejh Abbas! Ah sikur të ishte si shejhu që jep mësim dhe të arrije të ngjiteshe në minber dhe të na lexoje nga ai libër që dëgjuam nga ai sot!

Disa herë desha t'i them se ai libër është nga shkrimet e dorës sime, por e përmbajta veten dhe i thashë vetëm që lute Zotin që të më japë sukses e mbarësi.

Kjo histori përmban disa këshilla, por ne do të hedhim dritë vetëm mbi disa nga ato.

1. Rëndësia e besimit në të ***fshehtë*** e ndërtimit të jetës mbi bazën e besimit dhe të moralit, nga ku mund të përdoret shprehja: “Nuk ka moral të shkëputur nga besimi në Botën e Fshehtë”. Dhe, ndoshta zbulon për ne lidhjen mes devotshmërisë dhe besimit në të ***fshehtë***. All'llahu i Madhëruar thotë:

“ Ky është Libri, tek i cili nuk ka dyshim; është udhëzues për të devotshmit, të cilët besojnë në të fshehtë” (El Bekare, 2-3)

2. Domosdoshmëria në të kushtuarit vëmendje historisë së dijetarëve tanë të mëdhenj, e cila shërben si urë lidhëse mes njerëzve dhe njeriut më të moralshëm të njerëzimit, Muhammedit (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi atë dhe familjen e tij të pastër!). nëse bëjmë lidhjen e jetëshkrimit të Profetit dhe të familjes së tij me ato të dijetarëve, kjo do të ishte pikënisja më e mirë dhe ndoshta e vetme për shpëtimin e popullit nga uzurpimi kulturor, i cili përbën bazën e çdo uzurpimi. Nëse shikojmë në historinë e dijetarëve tanë, (Zoti qoftë i kënaqur me ta!), do të zbulojmë thesare të çmueshme me të cilat do të arrinim pavarsinë tonë dhe themelet tona në sferën e vlerave, çështje që nuk lënë vend që ne të kërkojmë për një shembull të jashtëm, sikurse veprojnë sot shumë nga ne.

3. Kjo histori zbulon gjithashtu, të fshehtë e suksesit të dhënë nga Zoti siç ishte dhe rasti i Shejh Kummij, në veçanti me librin “Çelësat e Xhenneteve” i cili konsiderohet i afërti i atyre që me dua dhe lutje i drejtohen All'llahut për falje.

Thelbi i sinqeritetit që duket në këtë histori është se autori e ka përjetuar (simbolikisht) Botën Tjetër shkallë-shkallë, derisa zemra e tij u lidh aq shumë me dashurinë e vërtetë për atdheun dhe jetën e vërtetë.

Vendqëndrimet e Botës Tjetër

Në moshën 40 vjeçare Shejh Kummij kishte në dorë librin “Fevaid Er-Redvijetu” i cili flet për dijetarët e shiizmit. Kur arriti tek biografia e tij (emri i tij sipas rendit alfabetik), nuk e shkroi por tha: “Ky libër i vyer sqaron gjendjen e dijetarëve dhe nuk e shoh të arsyeshme të shkruaj biografinë time në të, sepse unë nuk ndihem në nivelin e tyre dhe është e tepërt të rënditem ndër ta, prandaj po mjaftohem vetëm me përmendjen e disa punimeve të mija pa përmendur biografinë time.”

Ai, më pas, përmendi mes botimeve të tij, “Vendqëndrimet e Botës Tjetër” dhe nuk mund të mos e përmend rrugën me të cilën autori filloi të shkruante këtë libër. Ai tregon se dita e përfundimit të librit, viti 1347 hixhri, përkon me ditën e lindjes së Imam Hasanit (paqja qoftë mbi të!) që është 15 Ramazan, sikurse ka ardhur dhe në fund të librit.

Gjatë shfletimit të librit “Vendqëndrimet e Botës Tjetër” krijohet një njohje e qartë e autorit Kummij, i cili ka për zgjedhur histori dhe transmetime nga origjina të ndryshme, të cilat nuk mund të përmbledhen në një kapitull të vetëm por nevojiten disa të tillë, në mënyrë që t’i përcellë lexuesit mesazhe praktike për lehtësimin në përmirsimin e jetës.

Është më se e dukshme për çdo lexues të Shejh Kummij (Zoti qoftë i kënaqur me të!), se mësuesi i tij En Nuri ka lënë gjurmë në personalitetin e tij.

Duhet të dimë, gjithashtu, edhe konsideratën që kishte dijetari Nuri në shkrimet e tij në lidhje me dijetarin e njohur Ibn Tauusi (Zoti qoftë i kënaqur me të!).

Shejh Kummij mësoi nga më të mëdhenjt e këtyre ideve, që dallohen për rrugën që ndjekin për të arritur të fshehtë. Ata e përjetonin të fshehtën e Jetës Tjetër sikur të ishte mbuluar nga veshi dhe syri, dhe e jetonin atë në çdo aspekt më shumë se jetën e dukshme, sepse e fshehta është më e madhe se kjo jetë (e dukshmja) A mund të krasohen disa llambadarë me një të vetëm...?

Libri “Vendqëndrimet e Botës Tjetër” nuk është një ndër librat që mund të lexohet vetëm një herë e pastaj të lihet, sikurse ai nuk është një ndër referencat ku hulumtuesi mund t’i referohet vetëm një herë, por siç e kam përmendur më lart, ai është një mesazh praktik për Botën Tjetër, ku çdonjëri nga ne duhet ta vërë në jetë atë çka është shkruar në të. Për shembull, fraza ‘ajo çka i lehtëson vuajtjet e vdekjes’ të praktikohet me korrektësi duke pasur si qëllim përmbushjen e kënaqësisë së Zotit, do të shohë se si do t’i lehtësohen vuajtjet e vdekjes.

E njëjta gjë mund të thuhet për të gjitha etapat e cekura në këtë libër, i vlefshëm për të qenë pikënisje e bësimitarit, qetësi dhe prehje në të sa herë që të këto vështirësi dhe lodhje ia rëndojnë shpatullat, mundimet e rrugës dhe vështirësitë e udhëtimit. Ai duhet të ketë mall për të qenë pranë Zotit në Botën e Përhershme.

Autori i librit ka lindur në vitin 1294 hixhri sikurse e ka thënë edhe vetë dhe ka vdekur në vitin 1359 hixhri sipas rrëfimit të djalit të tij.

Autori e jetoj këtë botë dhe për Botën Tjetër, u përgatit mesë miri. Ai ka lënë si sateka të vazhdueshme më shumë se 55 libra si autor dhe si përkthyes, ku në një pjesë prej tyre ka punuar për më shumë se 20 vjet, sikurse përmendet për “Sefinetu El Bihar” (Anija e detrave).

Mjafton të përmendin nga punimet e tij përveç “Sefinetu El Bihar” dhe “El Kuna Vel Elkab”, “El Fevaid Er Radauijeh”, “Menazilul Ahireh”, “Mefatihul Xhinan” etj.

Zoti e mëshiroftë Shejh Kummijn dhe na dhëntë na mirësitë e tij. Zoti na dhëntë ndërmjetësimin e Pejgamberit të zgjedhur, (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të dhe familjen e tij!) Falënderimet janë vetëm për Zotin e Botëve.

Hysejn Kurani

Parathënia e autorit

Falënderimet janë vetëm për Zotin e Botëve; selamet dhe bekimet janë për Muhammedin dhe për familjen e tij të pastër.

Shejh Kummij, robi i varfër ndjekës dhe zbatues i thënieve të pjesëtarëve të familjes së Profeti (paqja dhe belimet e All'llahut qofshin mbi të!), Abbasi, i biri i Muhamed Rida, (Zoti i dhashtë përfundim të mirë dhe të gëzuar!) thotë: 'Logjika dhe praktika gjykojnë se ai njeri që bën nijet të udhëtojë, duhet që të përgatitë më shumë se çka i duhet për këtë udhëtim.'

Duke u bazuar në këtë thënie, udhëtimi për në Botën Tjetër, të cilit i jemi drejtuar dhe nuk kemi se si ta shmangim, është më primar për t'u përgatitur.

Transmetohet se Ebu Dherr El Gafari (Zoti qoftë i kënaqur me të!), erdhi në Mekën e Shenjtë dhe duke qëndruar para Qabes ka thënë: "Unë jam karkalec i kësaj bote". Kur njerëzit kureshtarë e rrethuan gjithandej, ai tha: "Nëse dikush nga ju dëshiron të udhëtojë duhet të marrë me vete atë çfarë i duhet për udhëtimin; a nuk doni të përgatiteni me ato çfarë ju duhen për udhëtimin e Ditës së Fundit?"

Nga turma u ngrit një burrë dhe tha: "Na udhëzo!"

Ebu Dherrri tha: "Agjëroni në ditë të nxehta për Ditën e Ringjalljes, vizitoni vendet e shenjta për çështje të mëdha dhe falni dy rekat namaz në netët e errëta për egërsinë e varreve."

Imam Hasan El Muxhteba (paqja e Zotit qoftë mbi të!), ka këshilluar Xhenadetu bin Ebi Ummeje, kur ishte i sëmurë duke i thënë: "Përgatitu për udhëtimin tënd dhe grumbullo sa më shumë para se të të vijë vdekja".

Udhëtimi në Botën Tjetër është i gjatë dhe i frikshëm; gjatë tij ka etapa shumë të vështira dhe ndëshkime të rënda, vende gropa-gropa, ku udhëtarit i duhet forcë e madhe për t'i kaluar. Për këtë, njeriu nuk duhet të jetë i pavëmendshëm as edhe një çast, por të mendojë për të natë dhe ditë.

Siç transmetohet, prijësi i besimtarëve (paqja e zotit qoftë mbi të!), çdo natë kur njerëzit flinin, e ngrinte zërin e tij të ëmbël sa që e dëgjonin ata që ishin në xhami dhe fqinjët duke thënë: "Përgatituni, Zoti ju mëshiroftë, ndoshta ju përshëndesim ju për në udhëtim, prandaj, pakësojini kërkesat e kësaj bote, kthehuni me atë që është më e mira për ju për udhëtim. Vërtet, para jush ka ndëshkime të rrepta, etapa të frikshme që duhet patjetër të kalohen..."

Këtu po paraqesim në mënyrë të përmbledhur disa nga këto ndëshkime të vështira dhe etapa të frikshme; disa nga më të vlefshmet për nga vështirësia dhe frika e tyre. I paraqesim këto në disa kapituj dhe nëse Zoti na mbarëson dhe jetoj më gjatë më del detyrë – me dëshirën e Zotit – të shkruaj një libër të plotësuar për këtë çështje.

Për arsye se, në këtë kohë nuk shoh njerëz të humtojnë në çështje të tilla në bazuar në seriozitet e në vërtetësi, kam shkruar këtë përmbledhje. Lus All'llahun Fuqiplotë për mbështetje dhe sukses! Me të vërtetë, Ai është më i Afërti që u përgjigjet lutjeve!

Kapitulli i parë

Vendqëndrimi i parë

Vështirësitë

Vështirësia e parë

Vendqëndrimi i parë i këtij udhëtimi është vdekja.

Në këtë vendqëndrim ka pengesa të mëdha dhe etapa të vështira ndër të cilat do të përmendim dy:

Vështirësia e parë

Dhimbjet e vdekjes dhe vështirësia e dorëzimit të shpirtit

“Dhimbja e vdekjes i vjen me atë të vërtetën (i zbulohet çështja e Ahiretit); kjo është ajo prej së cilës ke ikur.”¹

Kjo pengesë është shumë e madhe e mbushur me momente të rënda dhe të vështira që lidhen me momentin e fundit në çdo aspekt. Sëmundja e rëndë me dhimbjet e saj, ngurtësimi i gjuhës dhe humbja e fuqive të trupit nga çdo anë...

Të qarat e familjes dhe të fëmijëve, ndarja e tyre me të, dëshpërimi i fëmijëve të tij dhe të ngjelurit e tyre jetimë duke humbur ata që ishin strehë për ta, nga njëra anë.

Nga ana tjetër, dëshpërimi i ndarjes nga pasuria, shtëpia, skamja dhe angazhimet e tij si dhe nga pasuria e tij shpirtërore për të cilat ka shpenzuar vitet më të bukura për t'i arritur ato me format më të ndryshme. Në shumicën e rasteve mund të jetë kjo pasuri e marrë nga njërëzitet me patë drejtë dhe me forcë. Shumicën e të drejtave të domosdoshme i ka shkelur në këmbim të kësaj pasurie duke mos e paguar. Në këto çaste atij i tregohen punët e këqija, por koha ka kaluar dhe është shumë vonë sepse rruga e përmirsimit të tyre ka kaluar. Kjo gjë është sikurse ka thënë prijësi i besimtarëve (Zoti qoftë i kënaqur me të!): “... Kujton pasurinë që ka mbledhur duke toleruar në kërkesat e saj, duke e marrë atë (pasurinë) nga vendi i saj dhe të ngjashmet me të. Iu përkushtua mbledhjes së pasurisë duke u kujdesur se pas ndarjes më të ajo t'i ngelet atij që vjen pas tij, që të jetë i sigurt në të dhe të përfitojnë prej saj. Kështu, është i dobishëm për të tjerët dhe kujdeset për ata që vijnë pas tij.”²

Një aspekt tjetër, është frika e të shikuarit të Botës Tjetër, që është e ndryshme nga kjo që jetojmë, në momentin që syri i tij shikon çështje që nuk i ka parë më parë.

“...e Ne ta hoqëm perden tënde dhe tash ti sheh shumë mprehtë.”³

Do të shikojë të Dërguarin e Zotit dhe familjen e tij të pastër, (paqja e Zotit qoftë mbi ta!) Melekët e zemërimit do të vijnë për të ekzekutuar mbi gjykimin e përshtatshëm.⁴

¹ (Kaf, 19)

² “Nehxhul Belaga” fq. 109.

³ (Kaf, 22)

⁴ Transmetime të dobishme dhe të pranueshme rreth shikimit të Profetit dhe familjes së tij, duhet të shikosh disa referenca si p.sh. “Darus Selam” i Nurijit Vëll.4 fq. 285 “El Buhar” Vëll, 6 fq.184-196 “El Kafi” kapitulli “kush dëshiron shoqërimin me të”. Ndërsa për ardhjen e melekëve të zemëruar mjafton si argument fjala e All'Allahut të Madhëruar, që thotë:

Nga ana tjetër, do të shikojë shejtanin e mallkuar dhe ndihmësit e tij¹, që kërkojnë të bëjnë diçka që të largojnë nga ai besimin dhe të shpëputet nga kjo botë pa besim...

Sikurse shikon ardhjen e melekut të vdekjes, me çfarë paraqitjeje do të jetë? Në çfarë mënyre do t'ia marrë shpirtin dhe të tjera pyetje...

Prijësi i besimtarëve ka thënë: “I mblidhen atij dhimbjet e vdekjes dhe janë të papërshkrueshme se çfarë do t'i vijë atij.”²

Shejh Kulejni transmeton nga Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) se Prijësi i besimtarëve, (paqja qoftë mbi të!) ankohej nga sytë aq shumë sa që kur shkoi Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) ai bërtiste me zë të lartë. Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) i tha e ke nga padurimi apo nga dhimbja e madhe? Ai i tha: “O i Dërguar i All'llahut nuk kam ndier dhimbje më të madhe se kjo.” Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) iu drejtua duke i thënë: “O Ali, kur të vijë meleku i vdekjes për të marrë shpirtin e jobesimtarit do të ketë me vete një heshtë prej zjarri me të cilën do t'i nxjerrë shpirtin e tij dhe do ta hedhë në Xhehenem.” Në këtë moment, imam Aliu u ul në shesh dhe tha : “O i Dërguari i All'llahut, më përsërit edhe një herë bisedën tënde; betohem në All'llahun se ajo bisedë ma harroi dhimbjen time”. Më pas, Aliu tha: “A do të goditet me këtë heshtë ndonjë nga populli yt? Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) iu përgjigj: “Po, gjykatësi i padrejtë, ai që ha me të padrejtë pasurinë e jetimit dhe ai që dëshmon jo të drejtën a të vërtetën.”³

Çfarë i lehtëson dhimbjet e vdekjes

Dhimbjet e vdekjes lehtësohen nga:

1-2 - Kujdesi ndaj të afërmeve dhe respektimi i prindërve

Shejh Suduku transmeton se Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Ai që dëshiron që All'llahu i Madhëruar t'ia lehtësojë dhimbjet e vdekjes, le të jetë i kujdesshëm ndaj të afërmeve të tij dhe të respektojë prindërit e vet. Nëse do të jetë i tillë, All'llahu i Madhëruar do t'ia lehtësojë momentet e vdekjes dhe nuk do ta godasë në këtë botë asnjëherë varfëria.”⁴

“Eh, sikur të shihje sesi melekët ua marrin shpirtrat mohuesve! I godasin ata në fytyrë dhe shpinë...” (El Enfal, 50) Gjithashtu, rreth pranisë së Profetit dhe imamëve referohu librit “El Bihar” Vëll. 6 fq.172 dhe 195.

¹ “Buhharul Envar” vëll. 6 fq.195 si dhe në “Furuul Kafii” Vëll. 3 fq.123 dhe 136

² “Nehxhul Belaga” fq. 109

³ “El Buhar” Vëll. 6 fq. 170 marrë nga “Furuul Kafii” Vëll. 1 fq. 70

⁴ “Buhharul Envar” fq.74-81 dhe Revdatul el Vaidhin fq.367

Transmetohet se i Dërguari i All'llahut (paqja qoftë mbi të!), ishte pranë një të riu, i cili po vdiste dhe i tha: “Thuaj se nuk ka Zot tjetër përveç All'llahut, por këtij të riu i merrej goja disa herë.” Atëherë, Pejgamberi (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) pyeti një grua që ishte te koka e tij: “A e ka nënën?” Gruaja tha – “po, unë jam nëna e tij”. Profeti e pyeti përsëri: “A je e zemëruar ndaj tij?” Ajo iu përgjigj: “Po, nuk kam folur me të prej 6 vjetësh.” Pejgamberi (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), i tha asaj: “Jepe miratimin tënd dhe kënaqu me të.” Gruaja vazhdoi: “Zoti qoftë i kënaqur me të nga kënaqësia jote o i Dërguari i All'llahut.” Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) iu drejtua të riut e i tha: “Thuaj se nuk ka Zot tjetër përveç All'llahut.” Pasi ai e tha dëshminë, i Dërguari i All'llahut e pyeti se çfarë shikonte? I riu iu përgjigj: “Shikoj një burrë të zi të shëmtuar, me rroba të pista dhe erë të rëndë që mu afrua mua dhe më shtrëngoi për fyti.” Pejgamberi (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) i tha: “Thuaj, o Ti që pranon të lehtën dhe fal të vështirën! Pranoje nga unë të lehtën dhe m'i fal të shumtat; me të vërtetë, Ti je Falës, Mëshirues.” Pasi i tha këto fjalë, i Dërguari i All'llahut e pyeti të riun përsëri se çfarë shikonte? Ai iu përgjigj: “Shikoj një burrë të bardhë me një fytyrë të bukur dhe më një erë të mirë, i veshur me rroba të mira, i cili më është afruar mua dhe se ai i pari u largua nga unë.” I është thënë lutu përsëri. Pasi është lutur, është pyetur se çfarë shikonte? Ai ka thënë: “Nuk e shikoj më atë burrin e zi, shikoj vetëm burrin e bardhë, i cili më është afruar.” Transmetohet, se më pas ai ka vdekur në këtë gjendje.¹

Autori thotë: “Hulumto në këtë hadith mirë dhe shiko gjurmët e mosrespektit të prindërve se deri ku arrijnë... Me të vërtetë, ky i ri edhe pse ka qenë konsideruar si shok i Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) dhe se i Dërguari i All'llahut, vetë e vizitoi të sëmurin dhe pranë shtratit të tij ia kujtoi fjalët e Dëshmisë, por ai nuk mundi ta shqiptonte vetçse pas miratimit dhe kënaqësisë së nënës së tij, ku pas kësaj, gjuha e tij u lirua dhe shqiptoi fjalët e dëshmisë.

3 - Kujdesi ndaj vëllait

Transmetohet se Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!), ka thënë: “Ai, që e mbulon vëllain e tij me mbulojën e dimrit dhe të verës, do të jetë e drejta e All'llahut të Madhëruar, për ta mbuluar këtë njeri me rrobat e Xhennetit dhe për t'ia lehtësuar vuajtjet e vdekjes, do t'i zgjerohet varri e në momentin e daljes nga varri, do të takojë melekët me gëzim.”²

4 - Të ushqyerit e vëllait me ëmbëlsirë

Transmetohet se Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) ka thënë: “Ai që ushqen vëllain e tij me ëmbëlsirë, All'llahu i Madhëruar ia largon hidhërimet e vdekjes.”³

5-6 - Nga punët e tjera që lehtësojnë momentet e vdekjes është edhe të lexuarit në atë moment suren “Jasin” dhe “Es Safat”⁴

7 - Fjala e lehtësimit – (s'ka Zot tjetër përveç All'llahut, Atij që dburon dhe është Bamirës)... e cila thuhet në namazë.⁵

¹ “Biharul Enuar” fq.74-75 dhe Emali el Mufide 287

² “Mizanul Hikmet” Vëll. 2 fq. 543 dhe “El Bihar” kap.73 fq.380

³ “Biharul Enuar” Kap. 75 fq. 456

⁴ Theksohet se transmetimet sigurojnë që leximi i sures Jasin duhet të jetë më shumë se surja Safat. “El Bihar” Kap. 81 fq. 230 si dhe çfarë ka pas saj sidomos në faqen 240

⁵ Lutja sikurse e ka përmendur autori në fund të librit “Mefatihul Xhinan” fq.540: “Nuk ka Zot tjetër përveç All'llahut. I Lartë i Madh është Ai. I lartësuar është All'llahu, Zoti i shtatë qiejve dhe i sgtatë tokave. Zoti i atyre që ndodhen në to, ndërmjet tyre dhe mbi to dhe Ai është Sunduesi i arshit të madh. Falëndërimet janë vetëm për All'llahun, Zotin e botëve. Paqja dhe bekimi i Tij qofshin mbi profetin Muhammed dhe mbi familjen e tij të pastër.”

8 - Agjërimi i ditës së fundit të muajit Rexheb

Shejh Suduk transmeton se imam Sadiku (paqja e Zotit qoftë mbi të!), ka thënë: *“Ai që agjëron ditën e fundit të muajit Rexheb, do të jetë i mbrojtur nga dhimbjet e mëdha të vdekjes dhe i ruajtur nga dënimet e varrit.”*¹

9 - Agjërimi i 24 ditëve të muajit Rexheb

Tregohet se sipas shumë transmetimeve të sakta se për atë që agjëron 24 ditë të muajit Rexheb ka shpërblime të mëdha, thuhet: *“Atij personi që agjëron 24 ditë të muajit Rexheb, kur t’i vijë meleku i vdekjes, do t’i shfaqet në formën e një të riu, i mbuluar me një rrobe mëndafshi jeshile. Ai do të jetë i hipur mbi një kalë nga kaujt e Xhenetit, do ketë në dorë mëndafsh jeshil të lyer me një lloj misku nga xheneti. Në dorën tjetër do të ketë një gotë ari të mbushur me pije xheneti që do t’i jepet këtij njeriu kur të dorëzojë shpirtin me qëllim lehtësimin e dhimbjeve të vdekjes.”*²

10 - Namazi i natës së shtatë në muajin Rexheb

Transmetohet nga i Dërguari i All’llahut xh.sh, se ka thënë: *“Ai që natën e shtatë të muajit Rexheb fal katër rekat namaz duke lexuar Fatihanë njëherë, njësimin (suren Ihlas) dhe dy mbrojtëset (Suretul Felek dhe En Nas) nga tre herë dhe pasi që mbaron namazin, bie në salavat mbi Pejgamberin dhe familjen e tij dhjetë herë, lexon dhjetë herë Subhan Allah vel Hamdulilah Ve La Ilahe Il-la Allah VAll’llahu Ekber, Madhërimet dhe Falënderimet janë për All’llahun, s’ka Zot tjetër përveç Tij, Ai është më i Madhi, ai njeri do të jetë nën hijen e Arshit të All’llahut dhe do ta shpërblejë All’llahu i Madhëruar, sikurse shpërblen atë që ka agjëruar muajin e Ramazanit. Për këtë person do të kërkojnë falje melekët deerri sa të mbarojë namazin e tij, do t’i lehtësohen shtrëngimet dhe dhimbjet e varrit. Sikurse, nuk do shpërputet nga kjo botë pa parë vendin e tij në Xhenet dhe All’llahu do ta ruajë nga frika e madhe (xhehenemi).”*³

11 - Lutja që lexohet çdo ditë nga dhjetë herë

Në librin “Beledul Emijn” transmetohet nga i Dërguari (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) se ai që thotë këto fjalë çdo ditë nga dhjetë herë, All’llahu i Madhëruar i ka falur atij katër mijë gjynahe të mëdha, dhe e ka lehtësuar atë nga të këqijat e dhimbjeve të vdekjes dhe të shtrënguarit e dënimit të varrit. Sikurse e ruan nga njëqind të këqija nga të këqijat e Ditës së Kijametit dhe nga sherri (e keqja) i shejtanit dhe ndihmësve të tij. Këtij personi i plotësohet feja, i lehtësohet dhe i largohet e vështira dhe e rënda. Këto fjalë janë:

*“Thuaj për çdo të frikshme s’ka Zot tjetër përveç All’llahut, për çdo të vështirë atë çfarë ka dashur All’llahu, për çdo të mirë falënderimi është vetëm për All’llahun, për çdo kërkesë falënderojë All’llahun, për çdo gjë të çuditshme madhëroje All’llahun, për çdo gjynah kërkoji falje All’llahut, për çdo fatkeqësi të Zotit jemi dhe tek Ai do kthehem, për çdo padrejtësi gjykimi i përket All’llahut, për çdo gjë dhe çdo caktim iu mbështeta All’llahut, për çdo përplasje kapem pas All’llahut, pas çdo bindjeje dhe mosbindjeje thuaj s’ka forcë dhe pushtet më të madh se All’llahu i Gjithëpushtetshëm.”*⁴

12 - Përkujtimi fisnik (Dhikru Sherif)

¹ “Reudatul Uaidhijn” fq.396

² “Theuabul A’ mal ue dhe “Ikubal A’ mal” fq.81

³ “Beledul Emin” fq. 168 dhe tek “Misbahul Muxhtehid” Tusii 734

⁴ “El Bakijatu Salihat, në sqarimet e Mefatihul Xhinan” fq.197-198

Nëse ky përkujtim fisnik thuhet shtatëdhjetë herë, personi që e thotë ka një mirësi të madhe sepse përgëzohet para vdekjes. Dhikri apo përkujtimi fisnik është : **“O më i Miri Dëgjues, o më i Miri Shikues, O më i Shpejti në llogari dhe më i Drejti Gjykues.”** Ja *Esma Es Samiin ve ja Ebsar el Mubsirin ve ja Esra il Hasibin ve ja Abkemil Hakimin.*¹

13 - Surja Ez Zelzele

Transmeton Shejh Kulinij se Imam Sadiku ka thënë: **“Mos u mërzhitni së lexuari suren “Zelzele” sepse, kush lexon këtë sure në namaze vullnetare, All’llahu i Madhëruar këtij personi nuk do t’i japë dridhje dhe tronditje të mëdha asnjëherë. Ky person nuk do të goditet nga vetëtima dhe bubullima e kësaj bote. Kur të vdesë, këtij personi do t’i vijë një melek fisnik nga Zoti i tij dhe do t’i qëndrojë te koka dhe do t’i thuhet: “O meleku i vdekjes trajtoje mirë mëkëmbesin e Zotit, sepse ai më ka kujtuar shumë”**²

Vështirësia e dytë

Devijimi në momentet e vdekjes

Në librin *“El Edi’ijetul Me’tburel”* thuhet: **“O Zot kërkoj të më ruash nga devijimi në momentin e vdekjes”**. Devijim në momentin e vdekjes do të thotë drejtimi nga e vërteta për tek e pavërteta. Kjo vjen si pasojë e pranisë së shejtanit në këtë moment dhe nxitjet e tij për dyshim në fe që ta nxjerrë personin nga besimi. Për këtë arsye përmenden lutje për mbrojtje nga devijimi në momentin e vdekjes.

1- I nderuari i kërkuesve ka thënë: Ai që dëshiron të shpëtojë nga devijimi në momentet e vdekjes, le të përgatitë besimin me argumentet e tij dhe pesë parimet e fesë me argumente të sakta, me sinqeritet dhe qëllim të pastër, që All’llahu i Madhëruar t’ia kthejë ato në momentin e prezantimit të vdekjes. Pas pranisë së besimit të drejtë të tij, në ato momente le të thotë: **“O më i Madhi Mëshirues, unë të kam dorëzuar gjithë qënijen time dhe qëndrueshmërinë e fesë sime. Me të vërtetë Ti je më i Miri Pritës. Na ke urdhëruar për ruajtjen e veprave të mira, mi kthe ato në momentin e vdekjes sime.”**

Pra, në mbështetje të asaj që përmendi i nderuari, leximi i lutjes së njohur “el Adlijeh” “lutja e mbrojtjes nga devijimi”, dhe prezantimi i kuptimit të kësaj lutjeje në mendje në momentin e vdekjes do jetë shumë e dobishme.³

2 - Lutja që është transmetuar nga Imam Sadiku

Shejh Tusi (Zoti qoftë i kënaqur me të!), transmeton nga Muhamed Bin Sulejman Ed Dijlemi se ai i ka thënë Imam Sadikut që ndjekesit tuaj thonë së besimi është i ndarë në dy pjesë. Nga njëra anë është besimi i qëndrueshëm dhe konstant, dhe nga ana tjetër besimi është i ndryshueshëm dhe jo konstant. Pë këtë më mëso një lutje që kur ta them atë të më plotsohet besimi. Imam Sadiku ka thënë: **“Thuaj pas çdo namazi të obliguar: “Pranova si Zot All’llahun, Muhamedin a.s si të dërguar, Islamin si fe, Kur’anin si Libër, Kaben si drejtim, Aliun si mëkëmbes dhe të parë. Sikurse Hasanin, Hysejnin, Ali bin Hasan, Muhamed Bin Ali, Xhafer Bin Muhamed, Musa Bin Xhafer, Ali Bin Musa, Muhamed Bin Ali, Ali Bin Muhamed, Hasan Bin Ali, Huxhetu Bin Hasan Zoti qoftë i kënaqur me to, i kam pranuar si prijësa. O Zot i kam pranuar si prijësa prandaj bë ji ata të kënaqur me mua. Me të vërtetë Ti ke fuqi për çdo gjë.”**

3 - Nga veprat e dobishme që të ruajnë nga kjo e keqe e madhe, është këmbëngulja në kryerjen e namazeve të obliguar në kohë. Në një hadith transmetohet se Engjëlli i vdekjes thotë: **“..... nuk ka as në Lindje e as në Perëndim, banor i qytetit apo atyre të fshatrave, që**

¹ “Sefinetul Buhar” Vell 1 fq.555

² “Usulul Kafi” Kap “Vlerat e Kura’ni” fq. 24

³ “Mefatihul Xhinan” fq. 84

unë nuk i përshëndes çdo ditë nga pesë herë dhe e di veprën më të vogël dhe më të madhe të tyre më shumë se vetë vetja e tyre.”

I Dërguari i All'llahut (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të!) ka thënë: **“Me të vërtetë, ai (meleku i vdekjes) i përshëndet falësit e namazit në kohë që e falin atë. Nëse është nga ata që këmbëngulin në faljen e tyre në kohët e caktuara, atëherë ky melek do t'ia kujtojë këtij njeriu dëshminë se nuk ka Zot tjetër përveç All'llahut dhe se Muhamedi (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të!) është i dërguari i Tij dhe, ky melek do t'ia largojë shejtanin e mallkuar në momentet e vdekjes.**¹

4-5-6 Mos shpenzimi i asaj çfarë të ka dhënë All'llahut në atë çfarë është e ndaluar, kryenëçësia ndaj dijes së All'llahut të Madhëruar si dhe mosrespektimi dhe nderimi i të gjithë atyre që përmendin familjen e Profetit (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të!) dhe ndjekin rrugën e tyre.

Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) u shkruan kështu disa njerëzve: “ Nëse do që të mbyllen me të mirë punët e tua gjer sa të kalosh nga kjo botë, kur je duke bërë vepra të mira, madhëroje të drejtën e All'llahut duke mos i përdorur mirësitë e Tij në mëkatë ndaj Tij’ mos ji kryeneç ndaj dijes dhe urtësisë së Tij; respektoje dhe i nderoje atë që na përmend ne dhe ndjek rrugën tonë.Ty nuk ka ç’të duhet as besniku as gënjeshtari, por vetëm qëllimi yt dhe atij gënjeshtria e vet.”²

I nderuari thotë gjithashtu se nga të dobishmet për të patur përfundim të mirë dhe për të kaluar nga e keqja tek e gëzuara (e lumtura) janë:

7 - Leximi i lutjes se njëmbëdhjetë nga fletushka e plote e “Es Sexhadedu”: “O Ti që përmendja Jote është nderim për të përkujtuarit...”

8 - Leximi i lutjes “Temxhijd”, Madhështimit që përmendet në librin “El Kafi” dhe në libra tjerë sikur është përmendur tek libri “Bakijatu Es Salihat” pas lutjeve të kohës.

9 - Falja e namazit në çdo të diel të muajit Dhul Kaide.³

10 - Këmbëngulja në këtë dua të nderuar: **“Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, vetëm Ti je Dhuruesi i madh”**

11 – Kryerja e tesbijhateve të Fatime Zahrasë paqja e Zotë qoftë mbi të!).

12 - Vendosja e unazës me gurë akijku me ngjyrë të kuqe, ku mbi të është gëdhendur Muhamedi (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të!) i Dërguari i All'llahut dhe Aliu i dashuri i Zotit.

13 - Leximi i Sures El-Mu'mininun për çdo ditë të premte

14 - Leximi pas namazit të sabahut dhe të akshamit shtatë herë këtë thënie: “Bismilahi Rrahmani Rrahim ue la haule ue la kuuete il-la bil-lahil alijjil adhijm” Me emrin e Zotit i Githmëshirmi, Mëshirploti, s’ka forcë më të madhe se atë të All'llahut të Plotfuqishëm.

15- Falja e tetë rekateve namaz natën e njëzetë e dytë të muajt Rexheb, ku në çdo rekat të lexohet surja Fatiha një herë dhe surja Kafirun nga shtatë herë. Në përfundim të namazit të thuhet salavat mbi Pejgamberin dhe familjen e tij dhjetë herë dhe të pendohet (istigfare) te All'llahu i Madhëruar gjithashtu dhjetë herë.

16 - Said bin Tauus transmeton nga Profeti (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të!) se ka thënë: “Atij që, në natën e gjashtë të muajit Sha’ban, fal katër rekat namaz dhe në çdo rekat lexon suren Fatiha një herë dhe suren Ihlas pesëdhjetë herë, All'llahu i Madhëruar do ia marrë shpirtin me gëzim dhe do t’ia zgjerojë varrin, sikurse do t’a nxjerrë nga varri me fytyrë të ndëritëshme si hëna. Në atë kohë, ai do jetë duke thënë dëshminë se nuk ka Zot tjetër përveç All'llahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij.”⁴

¹ “Buharul Envar” vëll. 6 fq. 169-170

² “Sefinetul Buhar” Vëll. 1 fq. 376

³ “Mefatihul Xhinan” fq.247

⁴ Marrë nga libri “Mefatihul Xhinan”

Autori i librit thotë se ky namaz është nga namazet e prijësit të besimtarëve, imam Aliut (paqja e Zotit qoftë mbi të!) dhe se shpërblimi i këtij namazi është i madh. E shikoj të arsyeshme që me këtë rast të sjell dy rrëfime.

Rrëfimi i parë

Fudejl bin Ajjad, një nga mësuesit e besimit (Fesë), në mesin e nxënësve të tij kishte një nga më të përgatiturit...

Një ditë ky nxënësi i mirë u sëmur rëndë sa që ju afrua vdekja....

Fudejl bin Ajjadi, shkoi ta vizitonte nxënësin. Ai u ul tek koka e tij dhe filloi të lexojë suren Ja Sin.... Nxënësi, që ishte në shtratin e vdekjes, i thotë: “mos e lexo këtë sure.”

Mësuesi e ndalon leximin e sures dhe i thotë nxënësit: “Thuaj; s’ka Zot tjetër përveç All’llahut”. Nxënësi përgjigjet duke thënë: “Nuk e them këtë shprehje se e urrej” (Zot na ruaj) dhe vdiq në këtë gjendje.

I çuditur nga kjo gjë, Fudejli shkon dhe qëndron në shtëpi pa dalur fare. Natën ai shikon në ëndërr nxënësin e tij duke e hedhur në zjarrin e Xhehenemit.

Fudejl bin Ajjadi i thotë: “Ishe nxënësi më i mirë nga nxënësit e mi, çfarë ndodhi me ty që All’llahu të zhveshi nga njohuritë e tua dhe të dha një fund me një dënim kaq të vështirë?”

Ai iu përgjigj: “Shkak për këtë janë bërë tri gjëra”:

E para : Kam qenë thashethemaxhi

E dyta : Kam qenë ziliqarë (smirak)

E treta : Kam pirë alkool për shkak të sëmundjes që kisha. Doktorin më këshilloi që të pija një gotë alkool në vit, duke më thënë se nëse nuk e pi këtë nuk ka shërim për sëmundjen tënde.

Këto tri gjëra janë bërë shkak i vuajtjeve të mija.

Autori thotë: E shoh të arsyeshme që në lidhje me këtë rrëfim të sjell një transmetim të Shejh Kulejnit, marrë nga Ebi Basiri i cili ka thënë: “Kur isha te Ebi Abdullahi (Sadiku), erdhi nëna e Halidit el Ma’bedijeh dhe i tha: “U bëfsha flij për ty, kam një gurgullimë të rëndë në bark dhe doktorët e Irakut më kanë këshillur si ilaç të pi verë me, por unë e kam ndaluar së përdoruri sepse e di që ju e urreni atë lloj ilaçi dhe desha të ju pyes për këtë. Ebi Abdallah i tha: “Çfarë të pengoi ta pish këtë lloj ilaçi?” Unë të imitoj (ndjek) ty në fenë time. Në momentin që do të takoj All’llahun do t’i tregoj që Xhafer bin Muhamed më ka urdhëruar dhe më ka ndaluar mua...” Ebi Abdullahi më tha: “O babai i Muhamedit, a nuk e dëgjove këtë grua dhe çështjen e saj?” Pasha All’llahun nuk të jap leje ty të përdorësh qoftë edhe një pikë prej saj. Vërtet, ti do të pendohesh kur shpirti yt të arrijë deri këtu, dhe bëri shënjë me dorën e tij tek fyti i tij duke i thënë asaj tri hërë a e kuptove....¹”

Rrëfimi i dytë

Shejhul Behai (Zoti ia mbushtë me aromë parajse vendprehjen!), në librin e tij “El Kushkul” thotë: “Në momentet e fundit të jetës së një mëkatari, shkuan te ai disa njerëz. Sa herë që i thuhej të shqiptonte se s’ka Zot tjetër përveç All’llahut, ai thoshte këto dy vargje të një poezie:

“O Zoti im, një ditë pyeta dhe isha e lodhur Nga është rruga e hamamit të njohur.”

Shkak i kësaj gjëje ishte se një grua e pasur dhe e bukur një ditë deshi të shkonte në një hamam normal dhe i njohur tek si hamami munxhab por, ajo nuk njihnte rrugën dhe duke

¹ “Sefinetul Buhar” Vëll. 1 fq. 407-408

kërkuar lodhet nga të ecurit. Kur pa një burrë (ai i cili thoshte dy vargjet e poezisë), e pyeti për hamamin. Ai i tha: “Ja ku është, duke i bërë shenjë për tek dera e shtëpisë së tij.” Në momentin që ajo hyri në shtëpi burri mbylli derën. Kur gruaja e ndieu rrezikun e atij burri, filloi të ekspozonte pjesët e bukura të trupit të saj dhe i thotë: “Na bli diçka të mirë për të ngrënë dhe kthehu sa më shpejt.” Burri, duke i besuar asaj dhe dëshirës së saj, doli për të blerë dhe kështu gruaja shpëtoi nga rreziku i tij...”

Shiko se si kjo vepër mëkatore e ndalonte të sëmurin në shtratin e vdekjes që të përmendte dëshminë (shehadetin) në momentet e fundit të jetës së tij, edhe pse ai nuk arriti të bënte imoralitet me atë grua, por thjesht ndodhi futja e gruas në shtëpi e tij.¹

Dihet gjithashtu se Shejh Kulejni ka transmetuar nga Imam Sadiku (paqja e All'lahut qoftë mbi të!), i cili ka thënë: “Ai që pengon dhënien e një karati zekat, do të vdesë jahudi ose i krishterë.”²

Autori i librit thotë se Karati është i barabartë me 21 dinar.³

Në disa transmetime thuhet se kuptimi është për atë që ka mundësi të shkojë në Haxh dhe nuk shkon derisa vdes.

Tregohet nga disa të njohur të tij se një ditë autori ndodhej pranë një njeriu që po dorëzonte shpirtin e tij. Të pranishmit i kërkuan atij që t'ia kujtojë të sëmurit dëshminë (shehadetin). Ai i lexoi atij këto dy strofa:

“Sikur unë të isha mëkatar, vërtet do ti bëja padrejtësi të gjithë botës, por shpresoj që mirësia jote të më marrë për dore”

“Ti thua se do më marrësh për dore kur të arrij pleqërinë, por mos mendo se do të jem më i plakur se sa jam tani.”

¹ “El Kushkul” Vëll. 1 fq. 306

² “Sefinetul Buhar” (Zekati) Vëll. 1 fq. 551

³ Duket se qëllimi është për një pjesë të 21 dinarëve. Autori e përmendën dhe në librin e tij “Sefinetul Buhar” transmetuar nga disa se Karati është pjesë nga pjesët e dinarit të njohur i cili është gjysma e 10 tës në disa vende ndërsa në vendet e Shamit e konsiderojnë atë pjesë nga 24.

Kapitulli i dytë

Vendqëndrimi i dytë

Varri

Vështirësia e parë

Vetmia e varrit

Një nga vendqëndrimet e vështira gjatë udhëtimit për në Botën Tjetër është varri. Ai thotë çdo ditë: “Unë jam banesa e të panjohurës, unë jam banesa e egërsirës, unë jam banesa e krimbave të tokës.”¹

Në këtë vendqëndrim ka shumë vështirësi dhe etapa të frikshme, por ne do të hedhim dritë në këtë libër mbi disa nga këto vështirësi.

Në librin “Men La Jehdurhu El Fekih” :

Nëse dikë e ka marrë vdekja, ai nuk do të hyjë drejt në varr, sepse varri ka disa shkallë të vështira. Ai, i cili do t’i kalojë këto shkallë, le të kërkojë mbrojtje nga All’llahu i Madhëruar gjatë ngjitjeve të tyre për t’u afruar pranë varrit. Të kërkojë nga All’llahu që t’i japë durim dhe t’ia lehtësojë përgatitjen pastaj të paraqitet pranë varrit.²

Mexhlisi i parë në komentimin të këtij momenti ka thënë:

Pavarësisht se shpirti është shkëputur nga trupi dhe se shpirti biologjik ka vdekur, shpirti lëvizës është ende gjallë dhe vazhdon akoma të mbajë lidhje me trupin. Për këtë arsye, frika nga ngushtësia e varrit, pyetjet e dy melekëve Munker dhe Nekir, goditjet e robve të varreve, vuajtjet e Bërzahut janë të pranishme. Kësaj i shtohet dhe shembulli i të gjallëve, të cilët mendojnë se para tyre është një gjendje e tillë.

Në një hadith nga Junus transmetohet se ai vetë e ka dëgjuar nga Ebi Hasan Musa se ka thënë: “Duke qenë në shtëpi ka ardhur Aliu dhe më ka trokitur në derë duke thënë: ‘Kur të sillit i vdekuri tek pragu apo ana e varrit i duhet një kohë gjatë sa të bëhet gati për t’u pyetur’”³

Transmetohet nga El Berai bin Azib, një nga shokët e njohur të Profetit (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) se ai ka thënë: “Ishim tek i Dërguari i All’llahut, i cili pa një grup njerëzish dhe pyeti se për ku janë nisur ata? Iu përgjigjëm për në varreza. Kur dëgjoi Profeti (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) për varrezat nxitoi për t’u bashkuar me ta dhe me të arritur ai u ul në gjunj. El Berai tregon se ka qëndruar përballë Profetit (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) për të parër se çfarë do të bëjë. Ai, Profeti (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!), ka qarë sa ka lagur rrobat e tij me lotë dhe pastaj ka thënë: **“O vëllezërit e mi për një ditë të tillë përgatituni”**⁴

¹ “Biharul Envar” Vëll. 6 fq. 267

² “Men La Jehdurhu El Fekih” Vëll. 1 fq. 170

³ “Vesail Esh Shija” Vëll. 2 fq. 838

⁴ “Reudatul Uaidhin” fq. 494

Tregohet për Shejh El Behai se në çastet e vdekjes e kanë rrethuar disa doktorë të cilët e kanë pyetur se çfarë ndien? Ai është përgjigjur: “Si mendoni për një njeri të cilit sapo i ka filluar një udhëtim pa asnjë siguri dhe do të qëndrojë në egërsinë e varrit pa asnjë kënaqësi dhe do të dalë para një gjykimi të drejtë pa asnjë mbështetje.”¹

Kutb Raundi transmeton se Isai (paqja qoftë mbi të!) ka thirrur nënën e tij pas vdekjes së saj dhe i ka thënë: “O nëna ime! A dëshiron që të kthehesh në dynja përsëri? Ajo ka thënë: “Po, që t’i lutem Zotit në netët shumë të ftohta dhe të agjëroj në ditët shumë të ngrohta. O djali im! Me të vërtetë, kjo rrugë është shumë e frikshme.”²

Tregohet se Fatime Zahras (paqja qoftë mbi të!), kur i ka ardhur momenti i fundit ka porositur Aliun (paqja qoftë mbi të!) duke i thënë: “Kur të vdes, kujdesu ti për larjen time dhe më përgatit ti vetë xhenazen time, fale ti si imam dhe më zbrit ti në varr dhe më mbulo ti me dhe, ulu tek koka ime dhe lexo sa më shumë nga Kura’ni dhe lutje sepse është një orë e tillë që të vdekurit i duhet ndihma e njerëzve të gjallë.”³

Transmetohet nga Sejid Et Tauus se Profeti (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) ka thënë: “**Për të vdekurin nuk ka moment më të vështirë se orët e para të natës së parë të vdekjes, prandaj mëshironi të vdekurit tuaj me lëmoshë dhe nëse nuk keni mundësi të jepni sadaka le të falni dy rekatë namaz ku, në rekatën e parë të lexojë suren Fatiha një herë dhe suren Ihlas dy herë dhe në rekatën e dytë, një herë suren Fatiha dhe dhjetë herë suren Et Tekathur. Pasi që të japi selam le të thotë; Paqja e Zotit qoftë mbi të Dërguarin e Tij dhe mbi familjen e tij të pastër, O Zot dërgoji sevapet (shpërblimet) e këtij namazi në varrin e filanit djalin e filanit. Në këtë moment All’llahu i Madhëruar me Rahmetin e Tij dërgon njëmijë melekë tek varri i këtij njeriu, ku çdonjëri melek ka me vete rroba dhe mbuloja për të dhe ia zgjerojnë varrin deri ditën kur do t’i fryhet Surit. Nga këto sevapë i jepen dhe personit që fali namaz për të, i cili do të këtë vetëm të mira deri sa të bjerë dielli dhe do të ngrihet dyzet gradë si njeri i mirë.”⁴**

Namaze të tjera për të lehtësuar vuajtjet e natës së parë në varr

Falja e dy rekateve, në të cilat të lexohet në rekatën e parë Fatihaja dhe Ajeti Kursij nga një herë, në rekatën e dytë Fatihaja një herë dhe sureja Kadr dhjetë herë. Pasi të jepet selam të thuhet: ***“Paqja e Zotit qoftë mbi të Dërguarin (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) dhe familjen e tij të pastër, o Zot dërgoji sevabet dhe shpërblimet e këtij namazi në varrin e filanit”*** dhe të përmendet emri i personit të vdekur.

Shejh En Nuri i në “Darus Selam” tregon nga shejh Mevlana Sultan Ebadi (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: “Nga praktika ime ka qenë se sa herë që dëgjoja se ka vdekur ndonjëri nga ndjekësit e familjes së Pejgamberit (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) falja dy rekatë namaz për të natën e varrimit të tij pa marrë parasysh nëse e njihja apo jo dhe këtë veprim timin nuk e ka ditur asnjë njeri.

Një ditë në rrugë takova një shok, i cili më tha: ***“Kam parë në ëndërr filanin i cili ka vdekur këto ditë. E pyeta për gjendjen e tij dhe se çfarë i kishte ndodhur pas vdekjes? Ai më tha: “Kam qenë në vështirësi shumë të madhe dhe se isha gjykuar me dënim të rëndë, por vetëm ato dy rekatët namaz që fali filani, duke përmendur emrin tënd, më kanë shpëtuar nga dënimi. Zoti ia mëshiroftë prindërit e tij për këtë të mirë që më bëri mua.”***

¹ “El Kushkul” Vëll. 2 fq. 24

² “Mustedrek El Uesail” Vëll. 1 fq. 591

³ “Mustedrek El Uesail” Vëll. 1 fq. 148

⁴ “Mustedrek El Uesail” Vëll. 1 fq. 469

Sultan Ebadi thotë: *“Më pyeti shoku im për namazin që falja dhe i tregova për praktikën time të vazhdueshme për çdo rast vdekjeje.”*¹

Nga veprat e mira të dobishme për t'u ruajtur nga egërsia e varrit

1 - Transmetohet se Imam Bakir (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Ai që plotëson rukun e tij, nuk do të përballet me vetminë e varrit.”*

2 - Gjithashtu, kush thotë njëqind herë në ditë *“La Ilahe Il-la All'illahu El Melikul Hakul Mubin” “S'ka Zot tjetër përveç All'illahut, Zotëruetit të së Vërtetës së qartë”*, kjo thënie do të jetë mbrojtje nga vuajtjet dhe egërsirat e varrit, do të trajtohet si i pasur dhe do t'i hapen dyert e Xhennetit sikurse ka ardhur dhe në transmetim (Hadith).²

3 - Leximi i sures Ja Sin para gjumit.

4 - Falja e namazit natën e Regaibit. Këtë gjë e kam përmendur tek libri “Mefatihul Xhinan”, punët e mira që kanë sevape në muajin Rexheb.

5 - Transmetohet gjithashtu: *“Ai që agjëron njëzetë e dy ditë nga muaji Sha'ban, në varr do të vizitohet nga shtatëdhjetë mijë melekë çdo ditë deri sa t'i fryhet Surit.”*³

6 - Atij personi që viziton një të sëmurë, All'illahu i Madhëruar do t'i ngarkojë një melek që do ta vizitojë në varrin e tij deri Ditën e Ringjalljes (Mahsher).⁴

Transmetohet se Ebi Said El Huderij ka dëgjuar Profetin (paqja dhe bekimet e All'illahut qofshin mbi të!) që i ka thënë imam Aliut (paqja qoftë mbi të!): *“O Ali, gëzohu dhe përgëzo sepse ndjekësit tuaj nuk do të ndiejnë pikëllim, nuk do përballen me vetminë e varrit dhe Ditën e Ringjalljes nuk do jenë të dëshpëruar...”*^{5 6}

Vështirësia e dytë në varr

Ngushtësia e varrit

¹ “Daru Selam” Vëll. 2, fq. 315.

² Kështu e ka transmetuar autori i librit si hadith të Profetit (paqja dhe bekimi i All'illahut qoftë mbi të!) në “Sefinetul Bihar” (Varri) Vëll. 2, fq. 397.

³ “Theuabul A'mal ue Ikabul A'mal” i Suduk fq.87.

⁴ “Theuabul A'mal ue Ikabul A'mal” i Suduk fq. 231.

⁵ “Biharul Enuar” vëll. 7 fq.198 dhe vazhdimi i hadithi: “Dhe sikur unë jam me ata që dalin nga varret dhe shkundin dheun nga kokat e tyre ku thirrjet e tyre janë: Falënderimi i takon Atij që largoi nga ne dëshpërimin. Zoti ynë është Falës i Falënderuar, i Cili na e lejoj ne vendqëndrimin me mirësinë e Tij, në të cilin nuk na u afrua asnjë fatkeqësi dhe nuk na preku lodhja.”

Gjithashtu në “Biharul Envar” vëll. 39 fq. 228 marrë nga libri “Tarihul Bagdad”, rrëfyer nga Aishja se Profeti Muhammed (paqja dhe bekimi i All'illahut qoftë mbi të) i ka thënë Aliut (paqja qoftë mbi të!): “Mendo se për të dashurit e tu nuk do të ketë pikëllim në momentin e vdekjes së tyre dhe se nuk do të përballen me vetminë e varrit dhe s'do të ketë frikë për ta Ditën e Kijametit.

⁶ Autori i librit në fund të këti transmetimi përmend: Ferezdeku ka thënë:

“Kam frikë pas varrit nëse nuk më fal mua më se shumti në varr vuajtjet dhe ngushtimet

Kur Ditën e Kijametit të vijë një prijës i ashpër dhe drejtues të drejton o Ferezdek

Dhe hedhin nga djemtë e Ademit që e meritojnë në zjarrin e pangopur me një rreth të zi

Një kopje e kësaj ka qenë në strofa dhe janë sistemuar tek libri “Raudatil Uaidhinë” fq. 494, ku gjejmë se Hasan El Basriu i ka thënë Ferezdekut gjatë varrimit të gruas së tij Nevar: “Çfarë ke përgatitur për këtë ditë o ebu Firas? Ai ka thënë: Dëshminë se s'ka Zot tjetër veç All'illahut prej 80 vitesh, dhe pasi e kanë varrosur është ngritur në këmbë dhe ka thënë...”

Kjo është një pengesë shumë e vështirë sa që përmendja e saj sikur ia ngushton jetën njeriut.

Prijësi i besimtarëve, Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: ***“O krijesat e Zotit, për ata që nuk i falen gjynahet, gjëja më e vështirë pas vdekjes është varri, prandaj, ruhuni nga ngushtësia e tij, vështirësia e tij, errësira dhe vetmia e tij...”***

Varri çdo ditë thotë: “Unë jam banesa e vetmisë, unë jam banesa e tmerrit, unë jam banesa e kribave të tokës. Varri është kopësht nga kopshtet e Xhennetit ose vatër nga vatrat e zjarrit... derisa arriti në thënie: “Me të vërtetë, jeta e vështirë, për të cilën All’llahu i Madhëruar ka paralajmëruar armiqët e Tij, janë dënimet e varrit. All’llahu i Madhëruar për mohuesin në varrin e tij zëbret nëntëdhjetë e nëntë kafshë të egra (dragoj), të cilat i hanë mishin e tij dhe ia thyejnë kockat, duke e përsëritur këtë gjë deri në Ditën e Ringjalljes. Sikur njëri nga këta dragoj t’i frynte tokës, nuk do të mbinte asnjë bimë.”

“O krijesat e Zotit! Ju jeni të dobët dhe trupi juaj është i butë dhe delikat, për të cilat mjafton diçka e lehtë për t’i thyer ato.”

Transmetohet se Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) kur zgjohej nga gjumi nga mesi i natës, e ngrinte zërin e tij sa ta dëgjonin të gjithë që ishin në shtëpi, duke thënë: ***“O Zot më mbro mua nga e keqja në Ditën e Kijametit, ma zgjero mua ngushtësinë e varri dhe më furnizo me të mira para vdekjes dhe pas saj.”***

Nga lutjet e imam Sadikut, gjithashtu, është: ***“O Zot më begato mua në vdekje, o Zot më mbro nga vuajtjet e vdekjes, o Zot më mbro nga dëshpërimi i varrit, o Zot më ruaj mua nga ngushtimi i varrit, o Zot më mbro mua nga errësira e varrit, o Zot më mbro nga vetmia e varrit, o Zot më bëj të martohem me hyritë në Xhennet.”***

Dije o njeri se ndër shkaqet e dënimit në varr është mospasja kujdes gjatë urinimit ose e thënë ndryshe të moskushtuarit rëndësi pastërtisë ndaj tij. Gjithashtu, ndër shkaqet tjera janë, thashethemet, përgojimet dhe largimi i burrit nga gruaja e tij.¹

Mësohet, gjithashtu, nga transmetimi i Sad bin Muadhrit se morali i keq i njeriut me familjen dhe të biseduarit me ta në atë që e urrejnë, është nga shkaqet e ngushtimit të varrit.

Në një transmetim nga Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) thuhet: ***“...Për çdo njeri që nuk është besimtar do të ketë ngushtim të varrit.”***²

Në një transmetim tjetër thuhet: ***“Ngushtimi i varrit për besimtarin është dëmshpërblim dhe lehtësim për të për shkak të humbjes që i bëri mirësive.”***³

Shejh Suduku transmeton nga Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të): ***“Një burrë nga të mirët e ulën në varrin e tij dhe i thanë: “Ne do të godasim me njëqind shkopinj si dënim të Zotit.”***

Ai tha: ***“Nuk do i duroj dot”***

Ata vazhduan ta godasin deri në goditjen e fundit dhe i thanë: “Mbaruam!” Atëherë, burri pyeti se përse e goditën me shkopinj?

Ata iu përgjigjën: ***“Të goditëm sepse, një ditë ke falur namazin pa abdes si dhe ke kaluar nga një i dobët dhe nuk e ke ndihmuar atë.”***

Thotë: ***“Ata e goditën me një shkop nga dënimet e Zotit të Madhërueshëm dhe varri i tij u mbush me zjarr.”***⁴

Gjithashtu, transmetohet nga Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!): ***“Nëse një besimtar i kërkon një vëllai të tij besimtar diçka të cilën ai ka mundësi t’ia realizojë dhe nuk ia realizon, Zoti do t’i dërgojë atij një kafshë të fortë në varr, që t’ia kafshojë***

¹ “El Bihar” Vëll. 6 fq. 222

² “El Bihar” Vëll. 6 fq. 221

³ Referimi i mëparshëm.

⁴ Referimi i mëparshëm

gishtërinjtë.” Në një transmetim tjetër thuhet: “Do t’i kafshojnë gishtërinjtë e mëdhenj të dorës së tij deri në Ditën e Kijametit si mëshirë apo dënim për të.”¹

Çfarë na shpëton nga ngushtimi i varrit dhe dënimet e tij

Ne do të mjaftohemi me përmendjen e pesëmbëdhjet veprave apo punëve.²

E para: Leximi i sures “Nisa” çdo ditë të xhuma (Premte). Transmetohet se prijësi i besimtarëve ka thënë: Kush e lexon suren “Nisa” në çdo ditë të xhuma është i ruajtur nga ngushtimi i varrit.³

E dyta: Leximi i sures “Zuhruf”
Transmetohet nga imam Bakiri se: “Kush lexon suren “Zuhruf”, do ta mbrojë All’llahu i Madhëruar nga parazitët e tokës dhe nga ngushtimi i varrit...⁴

E treta: Leximi i sures “Kalem” në namaz.
Transmetohet nga Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të) se: *“Kush lexon suren “Kalem” në namazet e detyruara apo vullnetare, All’llahu i Madhëruar e ka siguruar atë person që të mos preket nga varfëria asnjëherë dhe kur të vdes All’llahu i Madhëruar e ruan nga dënimet e varrit.”⁵*

E katërta: Vdekja nga dreka e të enjtes deri në kohën e xhumasë
Transmetohet se Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Kush vdes nga dreka e ditës së enjte deri në drekën e ditës së xhuma, All’llahu i Madhëruar e ruan nga ngushtimi i varrit.”⁶*

E pesta: Namazi i natës
Transmetohet nga Imam Rizai (paqja qoftë mbi të!), i cili ka thënë: *“Kujdesuni për namazin e natës. Kush ngrihet nga fundi i natës dhe fal tetë rekate namaz vullnetar, dy rekat namaz mbrojtjeje, një rekat namazi i vitrit dhe i kërkon falje All’llahut të Madhëruar shtatëdhjetë herë, është i ruajtur nga dënimi i varrit dhe nga dënimi i zjarrit. Po ashtu, i zgjatet dhe i përmirësohet jeta në këtë botë.”⁷*

E gjashta: Leximi i sures “Tekathur” para gjumit
Transmetohet se Profeti (paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Kush lexon suren “Tekathur” para gjumit, është i mbojtur nga dënimi i varrit.”⁸*

E shtata: Këndimi dhjetë herë i duasë së mëposhtëme në çdo ditë: " Për çdo të keqe them se s’ka Zot tjetër përveç All’llahut. ” Kjo lutje është kur i përmend pengesat dhe vuajtjet e vdekjes.

¹ “Sefinetul Bihar” Vëll. 1 fq. 352

² Dihet që ka dhe vepra të tjera që na shpëtojnë nga dënimet e varrit përveç këtyre që do të përmend si leximi i lutjeve të njohura..... Autori

³ “Theuabul A`mal” fq.131

⁴ Referimi i mëparshëm. fq. 141

⁵ Referimi i mëparshëm. fq. 147.

⁶ Referimi i mëparshëm. fq. 231.

⁷ “Mustedrekl Uesail”; vëll. 1, fq. 467.

⁸ “Beledul Emin”; fq. 24 dhe “Theuabul A`mal”; fq.153.

E teta: Varrimi në Nexhefin e nderuar, sepse nga të veçantat e kësaj toke të shenjtë është se, këtu humbasin dënimet e varrit sikurse dhe llogaritë e melekëve Munker dhe Nekir për të gjithë ata që varrosen në këtë tokë.

E nënta: Dy fletët (Levozhga peme)

Nga veprat e dobishme që largojnë dënimin e varrit është dhe të vendosurit e dy fletushkave apo levozhga peme të njoma mbi të vdekurin. Transmetohet se vuajtjet e vdekjes ikin nëse me të vdekurin janë këto dy pemë të njoma.¹ Transmetohet se Profeti (paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të!) po kalonte pranë një varri ku personi që ishte në të po dënohej. Profeti kërkoi një degë peme që i kanë rënë gjethet. Atë e ndau në dy pjesë, njëren pjesë e vendosi tek koka e të vdekurit dhe tjetrën tek këmbët e tij...² Gjithashtu, nga punët e dobishme është dhe lagja e varrit me ujë, sepse tregohet që me këtë vepër dënimi i varrit largohet për sa kohë që dhe i varrit është i lagur.³

E dhjeta: Namazi në fillim të muajit Rexheb

Në ditën e parë të muajit Rexheb falen dhjetë rekate namaz, ku në çdo rekat lexohet Fatihaja një herë dhe Ihlassi tri herë. Kjo të ruan nga e keqja e varrit dhe nga dënimi në Ditën e Kijametit. Gjithashtu, edhe falja e njëzetë rekateve namaz në natën e parë të muajit Rexheb duke lexuar “Fatihanë” dhe “Ihlassin” janë të dobishme për t’u ruajtur nga dënimet e varrit.⁴

E njëmbëdhjeta: Agjërimi i katër ditëve nga muaji Rexheb dhe agjërimi i dymbëdhjetë ditëve nga muaji Shaban.⁵

E dymbëdhjeta: Leximi i sures “Mulk”

Nga veprat që ndihmojnë për shpëtimin nga dënimet e varrit është edhe leximi i sures “Mulk” pranë varrit të të vdekurit. Sikurse e transmeton Er Ravendij nga Ibn Abasi (paqja qoftë mbi të!): “Një burrë ishte shtrirë në një vend pa e ditur se aty ishte një varr. Më pas kishte lexuar suren “Mulk”. Ai dëgjoi një njeri që fliste me zë të lartë duke thënë se ajo është shpëtuese. Në atë kohë ai kujtoi thënien e Profetit (paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të!), i cili ka thënë: *“Ajo është shpëtuese nga dënimet e varrit.”*⁶ Shejh Kulejni transmeton se Imam Bakir (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Surja “Mulk” është pengesë dhe ndaluese e dënimeve të varrit...”*⁷

E trembëdhjeta: Lutja gjatë varrosjes

Në librin “Da’vat” i Ravandijit transmetohet se Profeti (paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Çdo njërit që thotë tri herë tek varri i dikujt që po varrosët: O Zot të kërkoj për hatër të Muhammedit dhe familjes së tij të pastër mos e dëno këtë të vdekur, i dëgjohet lutja dhe All'llahu i Madhëruar ia largon dënimin atij personi deri sa t'i fryhet surit.”*⁸

E katërbëdhjeta: Dy rekat namaz natën e Xhuma

¹ “Mustedrikul Uesail”; vëll. 1, fq. 105 disa hadithe që flasin për fletushkat.

² “Mustedrikul Uesail”; vëll. 1, fq. 105.

³ Ka disa hadithe që flasin në referencën paraardhëse me nëntemën “Të pëlqyerit e të lagurit të varrit me ujë...”

⁴ “Mefatihul Xhinan”; fq. 142

⁵ “Theuabul A’mal”; fq.78 dhe 87

⁶ “Da’uatu Rauandiji”; fq. 279

⁷ “Usulul Kafi”; vëll.2 fq. 633

⁸ “Ed Da’uat”; fq. 270

Shejh Tusij në librin “Misbahul Muxhtehid” transmeton se Profeti (paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Atë që fal dy rekate namaz në natën e Xhumasë duke lexuar “Fatihane” dhe suren “Zelzeleh” nga pesëmbëdhjetë herë, e ka ruajtur All'llahu i Madhëruar nga dënimet e varrit dhe nga frika e Ditës së Kijametit.”*¹

E pesëmbëdhjeta: Disa namaze

Gjithashtu, nga punët e dobishme për t'u ruajtur nga dënimet e varrit është dhe falja e tridhjetë rekateve namaz në natën e gjysmës apo mesit të muajit Rexheb, ku në çdo rekat të lexohet “Fatihaja” një herë dhe “Ihlasi” dhjetë herë.²

Gjithashtu, të njëjtin namaz në natën e gjashtëmbëdhjetë dhe të shtatëmbëdhjetë të muajit Rexheb.³

Falja e njëqind rekateve namaz natën e parë të muajit Sha'ban duke lexuar “Fatihanë” dhe suren “Ihlas” nga një herë.⁴

Falja e dy rekateve namaz natën e njëzetë e katërt të muajit Sha'ban ku në secilin rekat të lexohet “Fatihaja” një herë dhe surja “Nasr” dhjetë herë.⁵

Përmendet, gjithashtu, falja e pesëdhjetë rekateve namaz në ditën e pesëmbëdhjetë të muajit Rexheb duke lexuar “Fatihanë”, “Ihlasin”, “Felekun” dhe suren “Nas” nga një herë. Ky namaz është i dobishëm për t'u ruajtur nga dënimet e varrit sikurse falja e njëqind rekateve namaz natën e Ashuras⁶, nata e dhjetë e muajit Muharrem.

Vështirësia e tretë

Marrja në pyetje nga Munkeri dhe Nekiri

Transmetohet se Imam Sadiku (paqja e All'llahut qoftë mbi të!) ka thënë: *“Ai që mohon tri gjëra nuk është nga ndjekësit tanë; Miraxhin e Profetit, të pyetje në varr dhe ndërmjetësimin e Profetit* (paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të!)”⁷

Transmetohet se dy melekët, Munkeri dhe Nekiri, do të vijnë me pamje të frikshme, me një zë bubullimë gjëmuese dhe me shikimin si vetëtima verbuese dhe e pyesin të vdekurin: *“Kush është Zoti yt? Kush është Profeti yt? Kush është feja jote? Sikurse e pyesin për mëkëmbësin dhe imamim e tij.”*⁸

Përgjigja për të vdekurin në këto momente është shumë e vështirë, prandaj ai ka nevojë për ndihmë. Ka qenë mëse normale që atij t'i kujtohet dëshmia në dy herë:

¹ “Misbahul Mutehexhid”; fq. 228

² “Mustedrikul Uesail”; vëll. 1 fq. 457 si dhe tek “Mefatihul Xhinan”; fq.143

³ Shënim: Këtë gjë e ka përmendur El Kef'amiji në “Beledul Emin” kur ka përmendur mirësitët e këtyre namazeve me ndryshimin e vetëm se ai thotë që në çdo rekat të lexohet Fatihaja një herë dhe surja Ihlas njëmbëdhjetë herë.

⁴ Referenca e mëparshme; fq. 172 dhe ka shtuar se pas dhënies selam lexohet Fatihaja pesëdhjetë herë.

⁵ Referenca e mëparshme.

⁶ “Mustedrikul Uesail”; vëll. 1, fq. 476.

⁷ “Biharul Enuar”; vëll. 6, fq. 223.

⁸ Transmetimet për këtë çështje janë të shumta por përqëndrohu në referencën e mëparshme në fq. 225 dhe 233

E para: Në momentin e vendosjes së trupit të tij në varr ku është e pëlqyeshme të kapet supi i tij i djathtë me dorën e djathtë dhe supi i tij i majtë me dorën e majtë, të tundet dhe t'i lexohet shehadeti.¹

E dyta: Pas varrimit. Pëlqehet që të ndahet një nga njerëzit më të afërt të tij dhe pasi të jenë larguar njerëzit e tjerë, të ulet tek koka e të vdekurit dhe t'i kujtojë atij dy dëshmitë dhe besimin me një zë të ngritur. Duhet t'i vendosë duart e tij mbi varr dhe gojën e tij ta drejtojë dhe afrojë nga varri. Nëse për kryerjen e kësaj pune, ai i afërmi i të vdekurit ngarkon dikënd tjetër si zëvendësues nuk është problem.²

Transmetohet se nëse të vdekurit i kujtohet në këtë mënyrë, Munkeri i thotë Nekirit le të ikim, sepse atij ju kujtua shehadeti dhe ai argumenti i tij. Ata largohen dhe nuk pyesin atë.³

Ndërsa, në librin “Men La Jehdurul Fakih” thuhet: Kur ka vdekur Dherr bin Ebi Dherrri (Zoti e pastë mëshiruar!), Ebu Dherrri qëndroi te varri i tij dhe duke e prekur varrin me dorën e tij tha: “Zoti të mëshiroftë o Dherr. Ti ke qenë me mua i respektuar. Ti kalove nga kjo jetë dhe unë jam i kënaqur me ty. Beto hem në All'llahun se humbja jote është për mua diçka e madhe që nuk ma zëvendëson vetëm All'llahu i Madhëruar. Sikur të mos ishte ai vendi⁴ nga i cili shikohet gjendja në Kijamet, do të kënaqesha të isha në vendin tënd. Në këtë çast mërziya ndaj teje për ndarjen nga kjo jetë më ka angazhuar më shumë se sa mërziya ndaj asaj çka të pret në Kijamet.⁵ Beto hem në Zotin se nuk kam qarë për ndarjen tënde nga kjo jetë dhe kam qarë ty për atë se çfarë do të gesh në Ditën e Gjykimit. Mjerë unë dhe mjerë ndjenjat e mia për ato që kam thënë dhe për ato që të janë thënë për ty!

O Zot unë ja kam falur ata çfarë ai ka pasur detyrim ndaj meje, falja dhe Ti detyrimet e tij ndaj Teje. Vërtet, Ti je më Bujar dhe më Fisnik se unë.⁶

Kuptimi i “Në këtë çast mërziya ndaj teje për ndarjen nga kjo jetë më ka angazhuar më shumë se sa mërziya ndaj asaj çka të pret në Kijamet” është se unë në këto çaste isha i angazhuar me lutje e adhurime të dobishme për ty më shumë se me mërzinë e ndarjes tënde nga kjo botë.

Transmetohet nga Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!), i cili ka thënë: **“Kur të hyjë besimtari në varr do të jetë namazi në krahun e tij të djathtë dhe zekati në të majtin ndërsa mbi të do të qëndrojnë veprat tjera të mira të këtij personi....thotë: durimi do të qëndrojë në një anë. Kur të vijnë dy meleket të cilët ia qartësojnë atij çështjet. Durimi do u thotë namazit dhe zekatit afrohuni pranë këtij që iu ka zbatuar, sepse po i qëndruat larg atë do ta thërrasë dikush tjetër.”⁷**

Eruditi Mexhlisij transmeton në librin “El Muhasin” me sened të saktë se Imam Bakiri (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: **“Kur të vdesë njeriu besimtar do të hynë me të në varr gjashtë portrete (Vepra) nga të cilat disa do të jenë të bukura në paraqitje, disa do të jenë me erë të mirë dhe disa shumë të pastërta..... një nga këta portrete do të qëndrojë në të djathtë, një në të majtë, një në mes duarve, një pas tij, një tek këmbët dhe më e**

¹ Shehji Suduku transmeton nga Imam Sadiku (paqja e All'llahut qoftë mbi të!), i cili ka thënë: pastaj vendose dorën tënde të djathtë nën shpatullën e tij të djathtë dhe dorën tënde të majtë nën shpatullën e tij të majtë dhe në këtë gjendje të thuash o filan i biri i filanit, All'llahu është Zoti yt, Muhamedi profeti yt etj... nga libri “Men La Jehderuhul Fakih”; vëll. 1, fq. 172.

² “Misbahul Mutehexhud”; fq. 21.

³ “Men La Jehderuhul Fakih”; vëll. , fq. 173.

⁴ Vendi ku shikohen hallet e vdekjes dhe problemet e Kijametit, apo që ndodhet mes kësaj bote dhe botës tjetër.

⁵ Mërziya për vështirësitë që do hasësh në atë botë është më e madhe se mërziya e ndarjes tënde nga ne nga kjo botë.

⁶ “Men La Jehderuhul Fakih”; vëll. 1, fq. 185-186,

⁷ “Biharul Enuar”; vëll. 6 fq. 265.

mira do të qëndrojë mbi kokën e tij. Në i ardhhtë ndonjë e keqe nga e djathta do e ndalojë ajo që është në të djathtë të tij, kështu do të ndodhë për të gjashtë pozicionet e trupit të tij. Vepra më e mirë i pyet të gjitha duke u thënë: “Kush jeni ju, Zoti ua shpërbleftë në të mira?” Ajo që është në të djathtë të njeriut thotë, unë jam namazi. Ajo në të majtë, thotë unë jam zekati. Ajo që është në mes të duarve të njeriut, thotë unë jam agjërimi. Vepra që i qëndron pas thotë unë jam haxhi dhe umra. Vepra që i qëndron tek këmbët thotë unë jam mirësia dhe lidhja e mirë me vëllëzërit e tu. Të gjitha këto së bashku pyesin atë më të mirën se kush je ti që je më e mira ndër ne në paraqitje me një erë të mirë dhe kaq e pastër? Unë jam kujdesi (vilajeti) ndaj familjes së Profetit Muhammed (paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të gjithë ata.)”¹

Shejh Suduku për shpërblimet e agjërimin në muajin e Shabanit transmeton: *“Ai që agjëron nëntë ditë nga ky muaj, Munkeri dhe Nekiri do të sillen me mirësi me të gjatë kohës që do ta marrin në pyetje.”*²

Transmetohet se imam Bakir (paqja e qoftë mbi të!) i cili ka thënë: *“Shpërblim të madh do të ketë ai që përjeton (qëndron zgjuar) natën e njëzetë e tre të muajit të Ramazanit dhe fal në të njëqind rekat namaz. Nga shpërblimet e asaj nate është se All’llahu i Madhëruar do ta mbrojë nga frika e Munkirit dhe Nekirit si dhe nga varri i tij do të falë dritë që do të ndriçojë njerëzit në hasher (njerëzit e tubuar).”*

Tregim

Eruditi El Mexhlisij ka përcjellë tek librat “Et Tuhfetu” marrë nga “Irshadil Kulub” dhe “Rihletul Garij”:

Transmetohet nga gjykatësi Ibn Zejd El Hamdani El Kufi, që ishte njeri i devotshëm dhe adhurues, i cili ka thënë: “Një natë ndodhesha në xhaminë e Kufes. Atë natë binte shi dhe në derën e Muslimit (në Xhaminë e Muslim bin Akilit, Zoti qoftë i kënaqur me të!) trokitën një grup njerëzish që kishin me vete një xhenaze. Ua hapën derën dhe e vendosën xhenazen tek një vend i ngritur në drejtim të derës së vendit të shenjtë. Njërin nga ata personat e zuri gjumi dhe pa në ëndërr se po i thoshte në gjumë një shoku të vet: Pa shiko tek ai person a kemi llogari më për të apo jo? Ai ia zbulon fytyrën të vdekurit dhe i thotë shokut që e pyeti: “Po, kemi me këtë person përsëri llogari, prandaj duhet që t’ia shlyejmë para se të jepet gjykimi i tij, sepse nuk do të kemi rrugëzgjidhje.

Pas pak burri u zgjua dhe ua tregoi ëndrrën e tij të pranishmëve. Ata e mbartën xhenazen në atë çast dhe u drejtuan me të shpejtë për tek vendi i shenjtë në Nexhefin e pastër.³

Pas kësaj thashë: “Zoti e bekoftë atë që ka thënë”:

Nëse vdes më varros në anë të luanit babait kerahasues të bujarisë

Nuk e kam frikë zjarrin kur jam pranë tij dhe nuk shqetësohem nga Munkeri dhe Nekiri

Endem në atë që mban zjarrin duke qenë në zjarr kur do të isha përkobësisht në një ngërç të pashoq.

Transmetohet nga mësuesi i madh El Behbehani se ai ka thënë:

Autori thotë:

Në proverbat arabe: Filani është më mbrojtës se mbrojtësi i karkalecëve. Pra, Ai e mbron atë që strehohet te ai, më shumë se mbrojtësi i karkalecëve.

Historia është se një burrë nga fisi Taji me emrin Mudelixh Bin Suvejd. Një ditë ishte ulur nën çadrën e tij dhe pa një grup njerëzish nga fisi i vet që po vinin dhe në duar mbanin mjete për gjetinë e karkalecëve. Ai i pyeti se çfarë ka ndodhur? Ata i thanë se çadrën tënde e kanë rrethuar karkalecët, prandaj erdhëm që t’i kapim ato.

¹ Referenca e mëparshme; fq 234.

² “Theuabul A’ mal”; fq. 87.

³ “Irshadul Kulub”; fq. 439-440.

Ai u ngrit dhe i hipi kalit të tij dhe me heshtën në dorë tha: “Betohem në All’llahun se kush i prek këto karkalecë do ta vras. “Karkalecët të jenë pranë meje dhe doni t’i merrni?” Kjo s’ka për të ndodhur asnjëherë.

Vazhdoi t’i pengonte në kapjen e karkalecëve deri sa u ngrit temperatura e diellit dhe karkalecët filluan të fluturojnë. Atëherë ai tha: “Tani ata janë larguar nga unë dhe ju bëni çfarë të doni me to.

Tregim

Është marrë nga libri “Hablul Mutekin” se Meir Muajjen el Eshref, nga më të devotshmit e shërbyesve në vendet e shenjta ka thënë: Pashë në ëndërr se dola nga vendi i rojeve për të rimarrë abdesin dhe kur u ktheva pranë derës pashë një numër të madh njerëzish që po hynin për nga dera e vendit të shenjtë. Ata i printe një njeri me fytyrë të shndëritur dhe e hijshme. Kur arritën në qendër të varrezave të shenjta, duke u bërë me shenjë nga një varr i caktuar, ai u tha njerëzve: “Hapeni këtë varr dhe nxjerreni nga aty atë robin e keq. Kur filluan të hapin varrin, unë pyeta njërin nga ata njerëz se kush është ky prijës? Ai më tha se është prijësi i besimtarëve (paqja e Zotit qoftë mbi të!)

Gjithashtu, dhe tek ne kemi rastin kur Imami i tetë ka dalur nga kopështi dhe ka shkuar tek prijësi i besimtarëve dhe pas shkëmbimit të selameve i ka thënë: “O gjyshi im, të kërkoj ty që ta falësh atë njeri dhe gjnahet e tij mi jep mua.

Prijësi i besimtarëve u përgjigj duke thënë: “A e di ti se ai njeri i shturur ka pirë alkool?” Iu përgjigj: “Po, por para vdekjes së tij ka lënë porosi që të varroset pranë meje prandaj po të lutem që ta falësh.

Atëherë prijësi i besimtarëve tha: T’i kam dhuruar apo falur ty gabimet dhe krimet e atij njeriu. Pastaj imami është larguar.

I frikësuar, kam zgjuar disa nga shërbëtorët dhe kam shkuar me ta në vendin e përmendur ku pash një varr të ri që ishte hedhur pak dhe. Pyeta se kush është ai që është varrosur aty? Më thanë se ishte një burrë nga turqit që është varrosur dje.¹

Autori thotë:

Në një histori ku Haxhi Ali El Bagdadij u nderua me takimin e prijësit të kohës (Imamit të pritur), “shpirtat tonë u bëfshin flijim pqë të!” dhe se është transmetuar nga ai se e ka pyetur imamin: O zotëria ynë! A është e vërtetë ajo që thuhet se ai që viziton Imam Hysejnin do të jetë i mbrojtur nga zjarri?

Ai tha: Po për All’llahun, dhe filloi të qante deri sa i dolën lotët nga sytë e tij të shndëritur.

I thashë: O prijësi ynë dua të të bëj një pyetje. Pyet- më tha.

I thashë në vitin 1269 kemi vizituar Imam Rizain (paqja e Zotit qoftë mbi të!). Gjatë vizitës takuam një beduin arab që jetonte në pjesën lindore të Nexhefit të cilin e ftuam në mesin tonë dhe e pyetëm për kujdesjtarinë (vilajetin) e Imam Rizait. Ai na u përgjigj: “Ajo është Xhennet.” Kanë kaluar pesëmbëdhjetë ditë dhe unë akoma ha nga ushqimi i Imam Rizait (paqja e Zotit qoftë mbi të!). Si mund të guxojë Munkiri dhe Nekiri që të më afrohen në varr, ndërkohë që mishi dhe gjaku im janë ushqyer nga ushqimi i tij?” A është e vërtetë kjo? A do të shkojë Imam Rizai dhe do ta ruajë atë nga Munkeri dhe Nekiri?

Ai ka thënë: “Për All’llahun, po. Gjyshi im është, sigurisht.”²

¹ “Darus Selam”; vëll. 1, f. 267-268.

² “Mefatihul Xhenan”; fq. 486. Historia e takimit të Haxh Ali El Bagdadijut me Imamin e pritur është shumë më e gjatë dhe me një transmetim të saktë. Nga ata që e kanë dëgjuar atë direkt është En Nuri, autori i librit “El Mustedrek” sikurse e përshkruan këtë histori në librin “En Nexhmu Thakib”; f. 271.

Kapitulli i tretë

Jeta e Barzahut

Nga vendqëndrimet e frikshme është edhe Barzahu, të cilin All'llahu i Madhëruar e përmend në suren "Mu'minun" ku thotë: **".....ata kanë para tyre një perde (distancë periodike) deri në ditën kur ringjallen."**¹

Imam Sadiku (paqja e Zotit qoftë mbi të!) në një pjesë të një hadithi të transmetuar nga ai thotë: ".....por, betohem në All'llahun se unë ju frikësohem ju për Barzahun"

Transmetuesi ka pyetur: "Çfarë është barzahu?"

Imami është përgjigjur: "Varri nga vdekja gjer në Ditën e Kijametit."

Nga libri "Libbul Lebab" i Rauandijut është përcjellë: "Të vdekurit vijnë çdo ditë të xhuma nga muaji i Ramazanit dhe ashtu duke qëndruar çdo njëri thërret me zë dëshpërues dhe duke qarë: "O njerëzit e mi, o fëmija mi, o të afërmit e mi, kini dhembshuri për ne me ndonjë gjë Zoti t'iu mëshirojë. Na kujtoni dhe mos na harroni në lutje. Kërkoni mëshirë për dhe për vetminë tonë. Ne kemi kemi mbetur në një burg të ngushtë dhe në mërzi të gjatë. Kërkoni mëshirë për ne dhe mos u tregoni koprracë në lutje dhe në lëmoshë për ne, sepse, All'llahu i Madhëruar me dëshirën e Tij na mëshiron neve para se të jeni edhe ju si ne (të vdekur). Oh çmjerim, vërtet në ishim të mundshëm nësoj siç jeni ju tani. O robtë e Zotit, dëgjojeni fjalën tonë dhe mos na harroni. Do e mësoni nesër se mirësia që keni në duart tuaja, e kemi patur edhe ne dikur dhe nuk e shpenzonim në rrugën e All'llahut të Madhëruar. Nuk e kemi vepruar të drejtën dhe në është bërë uibalen ndaj nesh dobi për të tjerët, prandaj jini të dhembshur ndaj nesh qotë me një dirhem, apo me një kothere bukë apo për diçka tjetër. Më pas thërrasin: Sa keq është të qani vetat tuaja, por pa dobi, sikurse ne po vajtojmë vetat tona, por që nuk na bën dobi. Prandaj punoni (punë të dobishme) para se të jeni si ne."²

Është transmetuar në librin "Xhamial Ahbar" nga disa shokë të Profetit (paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të!) se ai ka thënë: **"Bëni dhurata të vdekurve tuaj"**. E kanë pyetur se çfarë mund t'u dhurohet të vdekurve? Ai është përgjigjur: **"Lëmoshë dhe lutje"**. Gjithashtu, ka thënë: "Shpirtat e të vdekurve vijnë çdo të xhuma në qiellin e dynjasë afër dyerve dhe shtëpive të tyre dhe çdo njeri thërret me zë dëshpërues dhe duke qarë: "O njerëzit e mi, o fëmija im, o babai dhe nëna ime, o të afërmit e mi, jini të dhembshur për ne që Zoti t'ju mëshirojë nëpërmjet asaj që kemi patur në dorë. Të mjerët ne, llogaria është për ne dhe ajo që na bën dobi është në duart e tjetërkujt."

Çdonjëri prej tyre u thërret të afërmëve të tij duke thënë: "Jini të dhembshur për ne qoftë me një derhem, apo me një kothere bukë, apo me një veshje, Zoti ju veshtë ju me rrobat e Xhennetit. Më pas, Profeti (paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të!) ka qarë, qamë

¹ El Mu'minun; ajeti 100.

² "Sefinetul Bihar"; Vdekja, vëll. 2, f. 556.

edhe ne. Nga të qarët Profeti (paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të) nuk mund të fliste. Pastaj tha: Ata janë vëllezërit tuaj në fe dhe tani janë bërë dhe e pluhur, pasi ishin të gëzuar e të mirësuar dhe tani thërrasin me mjerim dhe dhimbje duke thënë: “Të mjerët ne, sikur të shpenzonim për hir të All'llahut dhe për hir të kënaqësisë së Tij nga ato të mira që zotëronim, nuk do të kishim nevojë për ju. Ata do të kthehen të penduar duke thirrur: “Shpejtoni me lëmoshë për të vdekurit.”¹

Në librin e sipërpërmendur transmetohet gjithashtu, se Profeti (paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të!) ka thënë: “Çdo gjë që jepet sadaka për të vdekurin merret nga një melek në një tabaka prej drite, shkëlqimi i të cilës arrin shtatë qiejt. Pastaj ia vendos pranë varrit të tij dhe thërritet: “Paqja qoftë mbi ju o banorë të varreve. Njerëzit tuaj u kanë dërguar një dhuratë.” Ai e merr këtë dhuratë dhe hyn në varrin e tij dhe varri i zgjerohet atij.

Më pas Profeti (paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të!) thotë: “Kujdesja për të vdekurin me sadaka ka shpërblim të madh te All'llahu i Madhëruar dhe do të jetë në Ditën e Kijametit nën hijen e Arshit të All'llahut, ditë që nuk do të ketë hije vetëm nën Arshin e Tij. Përgëzime për të vdekurin sepse shpëtoi me këtë sadaka.”²

Tregohet se prijësi i Horasanit është parë në ëndërr duke thënë: “Më dërgoni mua ato çfarë i afroni qenëve se unë dhe për ata kam nevojë.” D.m.th. që shpirti i tij ka nevojë dhe për gjëra shumë të vogla.

Eruditi Mexhlisij në librin “Zadel Mead” ka thënë: “Duhet që të mos i harrojmë të vdekurit sepse, ata janë të paafte për të bërë vepra të mira. Ata shpresojnë që t'u arrijë ndonjë gjë nga fëmijët e tij, të afërmit e tij dhe nga vëllezërit besimtarë. Ata i presin me padurim këto, veçanërisht lutjet e namazit të natës dhe lutjet pas çdo namazi të detyruar si dhe në raste të veçanta e të bekuara. Duhet që babai dhe nëna të jenë të veçantë në lutje dhe në vepra të mira për hir të tyre. Për ta, të bëhen lutje më shumë se për këdo tjetër dhe të bëhen punë për mëshirim të tyre.”

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku (paqja e All'llahut qoftë mbi të!) thuhet: “Nëse një njeri nuk i respektonte prindërit e tij kur ishin të gjallë, pas vdekjes së tyre ai duhet të agjërojë dhe të falet për ta dhe të shlyejë fenë, borxhin e tyre. Nëse vazhdon në këtë mënyrë ai do të shkruhet i mirë për ta. Nëse njeriu tregohet i mirë për ta gjatë jetës së tyre dhe pas vdekjes nuk i shlyen borxhet e tyre dhe nuk bën asgjë të mirë për ta, nëse vazhdon kështu ai do të shkruhet si i parespektuar ndaj tyre.”³

Nga punët e mira për prindrit dhe të afërmit është shlyerja e borxhit të tyre dhe e detyrimeve ndaj All'llahut të Madhëruar dhe ndaj njerëzve; si p.sh., shkuarja në Haxh për ta dhe kryerja e të gjitha adhurimeve të tjera që atyre u kanë ikur pa kryer. Duhet t'i kushtohet rëndësi kësaj gjëje qoftë edhe duke paguar një njeri apo duke e kryer vetë apo duke dhënë sadaka.

Në një hadith të saktë tregohet se imam Sadiku (paqja e All'llahut qoftë mbi të!) ka falur dy rekate çdo natë për fëmijët e tij dhe çdo ditë për prindërit ku këndonte në rekatën e parë pas “Fatihasë” suren “Kadr” dhe në rekatën e dytë suren “Keuther”.⁴

Siç transmetohet në një rrëfim të saktë nga Imam Sadiku (paqja e All'llahut qoftë mbi të!) Rrëfyeni e ka pyetur Ebi Abdullahun: “A falet namaz për të vdekurin?” Ai i është përgjigjur: “Po, derisa ai është në vështirësi All'llahu i Madhëruar ia lehtëson ato. Atij i thuhet: “T'u lehtësuan vështirësitë me namazin që fali filani, vëllai yt për ty.”

¹ “Xhamiul Ahbar”; f. 78 dhe në një botim tjetër f. 176-177 dhe tek “Sefinetul Bihar”; vdekja, vëll.1, f. 149.

² “Xhamiul Ahbar”; f.177.

³ “Biharul Enuar”; fq. 74-84 në veçanti fq.81 dhe 59, si dhe kap.88 fq. 304-305.

⁴ “Mustedrikul Vesail”; vëll. 1 fq. 470. si dhe tek “Buharul Envar” kap. 88 fq. 314. “Sefinetul Bihar” vëll. 2, fq. 555.

E pyeta përsëri: “A mund të fal dy rekatë namaz për dy persona njëherazi?” Ebi Abadallahu ka thënë: “Po, dhe më pas ka shtuar: “I vdekuri gëzohet nëse i dërgojmë rahmet dhe kërkojmë falje për të, sikurse gëzohet i gjalli për dhuratën që i bëjmë.”¹

Ebi Abdallahu (paqja e All'llahut qoftë mbi të!) ka thënë gjithashtu: “Tek i vdekuri arrin në varrin e tij namazi, agjërimi, haxhi, sadakaja, mirësjija dhe lutja apo duaja, dhe shkruhet shpërblim për atë që i bën dhe për të vdekurin.”²

Imami ka thënë, gjithashtu, në një hadith tjetër: “Kush punon nga myslimanët për të vdekurit një punë të mirë i shumfishohet shpërblimi i tij dhe bëhet i dobishëm për të vdekurin, gjithashtu.”³

Në një transmetim tjetër thuhet: “Nëse dikush jep sadaka me qëllim për të vdekurin, All'llahu i Madhëruar do urdhërojë Xhebrailin që tek varri i këtij personi të zbresë shtatë dhjetë mijë melek ku çdo njëri do ketë në dorë një tabaka dhe i thonë: “Paqja e Zotit qoftë mbi ty o robi i All'llahut, kjo është dhurata e filani djalit të filanit për ty dhe do i shkëlqejë varri i tij....All'llahu i Madhëruar do t'i japë një mijë banesa në Xhenet dhe do e martojë me një mijë hyri, do ta veshë me njëmijë rroba të ndryshme dhe do t'i kryejë një mijë detyra apo nevoja.”⁴

Autori thotë:

E kam parë të arsyeshme që të sjell disa histori apo tregime të dobishme nga ëndrrat e vërteta. I mjeri ti, mos i përfytyro ato ëndrra si ëndrra të mërzitshme apo si legjenda që u tregohen fëmijëve, por mendohu thellë në to, sepse ky mendim të ushqen mendjen...

Të gjitha legjendat të vënë në gjumë, por legjenda apo fabula ime të largon sytë nga ëmbëlsia e gjumit. Me të vërtetë, ajo është e çuditshme.⁵

Tregimi i parë

Transmetuesi i shquar shejh En Nuri (Zoti ia ndriçoftë varrin!), në librin “Darus Selam” thotë: “Më kanë treguar dijetari i njohur Emiyr Sejjid Hasan El Husejnij El Esfehanej (Zoti e mëshiroftël): “Kur më ka vdekur babai në Esfehan, unë isha në Nexhef për të kërkuar diturinë; çështjet e babait i drejtonin disa nga vëllezërit e mi, kështu që nuk e kisha dije për detajet e atyre çështjeve. Pasi kaluan shtatë muaj nga vdekja e babait, më vdiq dhe nëna, xhenazja e së cilës u soll në Nexhef.

Një ditë pashë në ëndërr sikur unë isha ulur në shtëpinë ku jetoja dhe erdhi babai im. Unë u ngrita dhe e mirëprita atë. Ai u ul në krue të qoshes dhe filloi të më pyeste për gjendjen time. Por, edhe pse isha në ëndërr, e dija që ai ka vdekur dhe i thashë; ti ke vdekur në Esfehan dhe të shikoj këtu në Nexhef?! Ai më tha: “Po, na kanë sjellë këtu në Nexhef pas vdekjes sonë dhe këtu po qëndrojmë.”

E pyeta po nëna ime është me ju?

Ai më tha: Jo

Unë u mërzita nga kjo. Atëherë ai më tha: Ajo, gjithashtu është në Nexhef, por në një vend tjetër.

E mësova se për këtë ka një shkak. Dijetari është në pozitë më të ngritur se jo dijetari. Pastaj e pyeta atë për gjendjen e tij. Ai më tha: Kam qenë shumë keq dhe në vështirësi por falënderimi i takon All'llahut të Madhëruar. Jam mirë, jam larguar nga ajo ngushtësi dhe vështirësi që isha.

I habitur nga kjo, e pyeta: Ti ke qenë në vështirësi?

¹ “Men La Jehderuhul Fakih”; vëll. 1, fq. 183.

² “Men La Jehderuhul Fakih”; vëll. 1, fq. 185.

³ Referenca e mëparshme.

⁴ “Sefinetul Bihar”; vdekja, vëll. 2, fq. 555. Transmetimi është nga i Dërguari i All'llahut të Madhëruar.

⁵ Kuptimi i poezisë

Ai më tha: Po, i kam pasur një borxh Haxhi Rizait i njohur me epitelin “Nalbined” dhe për këtë borxh kam qenë në vështirsi.

U habita shumë dhe u zgjova nga gjumi i shokuar dhe i çuditur.

I shkrova një letër vëllait tim që ka qenë kujdestari i babait dhe i tregova në letër se çfarë kisha parë në ëndërr dhe i kërkova që të lidhet me personin e përmendur dhe ta pyesë nëse i ka pasur babai ndonjë borxh?

Ai më ktheu përgjigje dhe më thoshte: Unë shikova në shënimet e borxheve të babait dhe nuk e gjeta emrin e këtij burri në mesin e borxhlinjve.

I dërgova letër tjetër dhe i kërkova që të pyeste vetë personin dhe më erdhi përgjigja nga vëllai:

Vëllai im, e pyeta atë burrin dhe më tha: po, ai më ka pasur tetëmbëdhjetë Tuman (shumë e madhe në atë kohë), të pyeta kur ai vdiq se a e ke gjetur emrin tim në bllokun e borxhlinjve dhe më the jo. I thashë vetes time që të hesht më mirë se po të flas nuk kam argument për ta vërtetuar atë gjë. U mërzhita shumë sepse unë i dhashë borxh pa patur argument për ta vërtetuar këtë duke menduar se ai do ta shënojë në bllokun e tij, por ai duket e ka nënvlerësuar këtë gjë dhe u keqinterpretua shuma e marrë.

Vëllai im kërkoi që t’i paguante borxhin personit të përmendur por ai tha: “Ja kam falur atij atë sepse, iu ka treguar për borxhin.”¹

Tregimi i dytë

Në librin “Darus Selam” gjithashtu, shejh En Nuri, (Zoti ia ndriçoftë varrin!), thotë se më ka treguar shejh Ebul Hasan El Mazenderani dhe më ka thënë: “Kam patur një shok të nderuar, të devotshëm dhe të ditur, shejh Xhafer bin Husejn Et Tabarij, nga një fshat që quhej Tilk ku dhe ai jetonte. Kur ra murtaja (sëmundje e rëndë) e madhe e shkretoi vendin dhe sulmoi njerëzit. Një numër i madh njerëzish vdiqën dhe lanë si trashëgimtar të pasurisë së tyre shejh Xhaferin. Te ai u grumbullua një pasuri e madhe. Më pas, edhe ai vdiq nga murtaja para se të shpenzonte pasurinë në vendin e duhur. Kështu, shkoi dëm e gjithë kjo pasuri.

Kur mu krijua mundësia për të vizituar varret e shenjta dhe ato që ishin afër varrit të Ebi Abdallah El Husejnit (paqja qoftë mbi të të!), atë natë pashë në ëndërr sikur një burrë në qafën e tij kishte ca zingjirë prej zjarri që nga ana tjetër ishin në duart e dy burrave. Gjuha e këtij personi ishte shumë e gjatë sa që i varej në gjoks. Posa më pa nga larg u drejtua nga unë. Kur mu afrua, e dallova që ishte shejh Xhaferi, i sipërpërmenduri.

U çudita nga kjo gjë. Pasi që filloi të më fliste mua, por me zingjirët që i vinin nga pas që i ktheheshin dhe ripërtëriheshin nuk mund të fliste. Më pas, mu afrua përsëri, por dy burrat në duart e të cilëve ishin zingjirët, e tërhoqën përsëri. Të njëjtën gjë bënë dhe për herë të tretë që mu afrua.

U frikësova nga pamja e tij aq shumë sa që lëshova një britmë të madhe dhe u zgjova nga gjumi. Po ashtu u zgjua nga gjumi njëri nga dijetarët që po flinte pranë meje dhe ia tregova atij ëndrrën. Ishte koha e Ezanit, kohë që hapeshin dyert e vendit të shenjtë të mbretit të dëshmorëve, imam Hysejni (paqja qoftë mbi të të!).

I thashë shokut tim: Duhet të shkojmë tek varri i imanit ta vizitojmë atë dhe t’i kërkojmë falje All’lahut për të, do Zoti e mëshiron, nëse është ëndërr e vërtetë. U ngritëm dhe kështu vepruam.

Kaloi një kohë e gjatë dhe nuk mu shfaq më gjendja e shejh Xhaferit.

Mendoja se kjo gjë ishte për shkak të neglignencës, apo moskushtimit rëndësi nga ana e tij (shejh Xhaferit) ndaj pasurisë së njerëzve gjatë kohës së sëmundjes së rëndë (Murtajës).

¹ “Darus Selam”; vëll. 3, fq. 164-165.

Kur All'llahu i Madhëruar më bëri të mundur vizitën e Qabes dhe kryerjen e Haxhit ku pastaj, u drejtova për të vizituar Medinen e Ndritur, u sëmura me një sëmundje të rëndë para se të arrija në Medinë sa që nuk arrija të lëvizja e të ecja.

Porsa hymë në Medinë u thashë shokëve të mi që të më lanin, të më ndërronin rrobat dhe të më mbanin për tek varri i Profetit të zgjedhur (paqja dhe bekimi Zotit qofshin mbi të!). Kisha frikë se mos më vinte vdekja para se të arrija atje.

Pasi më futën tek Reudeti i pastër më ra të fikët. Më vendosën në anë derisa të vija në vete. Më pas, më morën dhe më vendosën pranë varrit të Profetit (paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të të!) ku unë lexova duanë e vizitorit. Më pas, më bartën dhe më dërguan tek vendi ku ka qenë shtëpia e të nderuarës Fatime Zahrasë (paqja qoftë mbi të të!), që është një nga vendet që duhet të vizitohen. Më pas iu drejtova Profetit (paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të të!) duke i përmendur atij nevojat e mia dhe nga mesi i tyre dhe ndërmjetësimin e tij për një pjesë të shokëve të mi të cilët janë të gradave të ndryshme. Dhe, rëndita emrat e tyre deri sa arrita tek emri i shejh Xhaferit të përmendur më lart. Aty kujtova ëndrrën dhe në moment më ndryshoi gjendja. Menjëherë shpejtova për t'i kërkuar falje All'llahut dhe ndërmjetësim nga Profeti (paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të të!) për atë person dhe thashë: “Unë e kam parë këtë person para njëzet vjetëve në ëndërr në një gjendje shumë të vështirë; nuk e di a ka qenë ëndërra ime e vërtetë apo ka qenë një ëndërr e zakonshme në gjumë? Çfarë lutjesh më vinin në mendje në ato çaste i kam kujtuar për atë person.

Pashë se shëndeti po më përmirësohej; u ngrita dhe shkova në vendqëndrimin tonë duke ecur. Sëmundja po më largohej. Gjatë qëndrimit tonë në Medinë, një ditë vizituam edhe Uhudin. Pasi që vizituam varret e dëshmorëve unë rashë në gjumë. Pashë në ëndërr shejh Xhaferin në një gjendje të mirë; rrobat e tij ishin të bardha si bora, në kokë kishte një kapele (fes) dhe në dorë një bastun.

Sapo mu afrua, më dha selam dhe mirëseardhje për vëllezërit dhe shokët. Kështu duhet të bëjë shoku për shokun e tij. Gjatë gjithë kësaj kohe isha në ngushtësi, vështirësi, vuajtje dhe ndëshkim. Sapo ke arritur te varri i Profetit a.s dhe të gjitha ato kanë marrë fund për mua. Prej dy apo tre ditësh më kanë dërguar në hamam dhe më kanë pastruar nga papastërtitë dhe fëlliqsirat. Kështu, puna ime, falënderimi i takon All'llahut xh.sh, ka ndryshuar për mirë. Erdha tek ju për tu uruar udhëtimin dhe për tju përgëzuar. Qetësoje veten tënde. Do të kthehesh tek familja jote shëndosh e mirë dhe ata do t'i gjesh mirë. U zgjova nga gjumi i gëzuar duke falënderuar All'llahun e Madhëruar.

Shejhu (Zoti e mëshiroftë!) ka thënë:

Për njeriun e zgjuar është rasti që të meditojnë në këtë ëndërr vetëm pak çaste sepse me të vërtetë aty ka çfarë i duhet një zemre të mbyllur dhe syve të verbuar.¹

Tregimi i tretë

Autori i librit “Mustedrek” ka thënë se i ka treguar i pari i dijetarëve shejh Ali Tahraniq nga babai i tij shejh Halil Tahraniq që ka thënë: “Isha tek vendi ku ka rënë dëshmor Imam Husejni (paqja qoftë mbi të!). Gjatë kësaj kohe nëna ime ishte në Taheran. Një natë pashë një ëndërr në gjumë se nëna ime erdhi tek unë dhe më tha: “O biri im unë kam vdekur. Më sollën mua këtu tek ti dhe më kanë thyer hundën.”

U zgjova nga gjumi i trembur dhe i hidhëruar. Isha kështu për një kohë sa më erdhi një letër nga njëra nga motrat e mia ku më thoshte: Nëna ka vdekur dhe xhenazen e kemi dërguar atje me ata që transportojnë xhenazet.

Kur erdhën ata që transportojnë xhenazet më thanë: Xhenazen e nënës time e lamë në një vend afër Dhil Kefel, sepse menduam që ti je në Nexhef.

Vazhdoja të isha i hutuar nga kuptimi i fjalëve “Më kanë thyer hundën”

¹ “Darus Selam”; vëll.2, fq. 153-155.

Kur erdhën me arkivolin e nënës sime unë i zbulova fytyrën dhe pashë hundën e saj të thyer. Pyeta për këtë gjë dhe më thanë: Ky arkivol ka qenë i vendosur mbi të gjithë arkivolet në mjetin transportues të tyre, kuajt u përplasën dhe arkivoli i saj rënë në tokë dhe për më shumë neve nuk dimë gjë.

E mora xhenazen dhe e dërgova tek vendprehja i Ebul Fadl Abasit, djali i prijësit të besimtarëve, imam Aliut (paqja qoftë mbi ta!) dhe i thashë: “O Ebul Fadl, nëna ime nuk e ka kryer rregullisht namazin dhe agjërimin, tani ajo është pranë teje prandaj mbroje atë nga dënimi dhe unë siguroj pesëdhjetë vjet agjërim dhe namaz në vend të saj. Pas kësaj e varrosa (Zoti e mëshiroftë!)

Kaloi një farë kohe dhe një natë pashë në ëndërr sikur po dëgjoja një ulërimë shumë të madhe pranë derës së shtëpisë sime. Kur dola nga shtëpia, pashë nënën time të lidhur me litar te një pemë dhe e goditnin me kamzhik.

Thashë: “Çfarë ka bërë? Çfarë gabimi ka bërë që po e godisni?”

Thanë: “Na ka urdhëruar Ebul Fadl që ta rrahim gjerë sa të paguajë të gjithë shumën.

Hyra në shtëpi dhe u solla shumën dhe ua pagova. Ata e lanë nënën time të lirë, e solla brenda në shtëpi dhe fillova t’i shërbej.

Kur u zgjova nga gjumi llogarita shumën që më morën ata në ëndërr dhe ajo ishte sa paga apo shpërblimi i pesëdhjetë vjetëve adhurim.

E mora këtë shumë dhe shkova tek shërbyesi i Darus Selamit, (Zoti qoftë i kënaqur me të!) dhe i thashë: “Kjo shumë është për pesëdhjetë vjetë adhurim për nënën time dhe i tregova se çfarë më kishte ndodhur.”

Shejh i madh (Zoti e nderoftë me Xhennet!), autori i librit “Darus Selam” ka thënë: “Kjo ëndërr, për atë që e sheh me syrin e ndërjegjes dhe të konsideratës, përmban; çështje të rëndësishme, përfundim të rrezikshëm, të mosnënçmuarit e premtimit të All’lauhut dhe pozitën e eulijave të Tij të zgjedhur.¹

Tregimi i katërt

Sipas të njëjtit transmetues, i ndjeri shejh Halil Tahranij ka thënë:

“Në Taheran ishte një burrë që punonte në hamamin publik dhe nuk falte namaz dhe as nuk agjëronte Ramazanin. Një ditë ai shkoi tek një arkitekt dhe i tha të më ndërtosh një hamam.

Arkitekti e pyeti: “Nga do e marrësh pasurinë?”

I tha: “Merr sa të duash, po më ndërto një të tillë.

Arkitekti i ndërtoi një hamam me emrin e tij që ishte Ali Talib.

Kur isha në Nexhef, tregon shejh Halili, pashë në ëndërr se Ali Talib erdhi në Nexhef në Vadin Selam dhe unë u habita. I thashë: “Çfarë të ka sjellë këtu kur ti nuk falesh as nuk agjëron ?!”

Ja, që kur vdiqa më vunë në pranga që të më dënojnë, por Zoti e shpërbleftë shejh Muhamed Kemanshahi me të mira, i cili më pagoi filanin për Haxh në vendim tim si dhe filanin për agjërim dhe namaz sikurse pagoi për mua zekatin dhe ato të padrejtat që i kam bërë filanit dhe filanit. Nuk ka lënë gjë për mua pa paguar. Të gjitha këto më shpëtuan nga dënimet, Zoti e shpërbleftë me të mirat e bamirësve.”

U zgjova i habitur nga kjo ëndërr. Pas një kohe, erdhën disa udhëtarë nga Tehrani dhe i pyeta për Ali Talibin. Ata më informuan të njëjtat gjëra sikurse i pashë në ëndërr. Më përmendën emrat e atyre personave të cilët kishin kryer adhurimet në vendin e tij apo kishin marrë për sipër për t’i kryer detyrimet e tjera. U habita nga vërtetësia e kësaj ëndrre dhe përputhshmëria e saj me realitetin.

Autori i librit “El Mustedrek” në komentimin e këtij tregimi thotë:

¹ “Darus Selam”; vëll. 2, fq. 245-246.

“Në këtë ëndërr tregohet vërtetësia e thënieve të të pamëkatëve për mbërritjen e shpërblimit të agjërimit, namazit, haxhit dhe e të gjitha veprave të mira të tyre tek i vdekurit, sepse ai mund të jetë në vështirësi dhe shpëton. Në këtë ëndërr, gjithashtu, tregohet vërtetësia se, kur vdes besimtari në lindje apo në perëndim qoftë, All’llahu i Madhëruar, ia dërgon shpirtin e tij pas vdekjes në Vadi Selam. Në disa transmetime: “I shikoj të ulur rretheqark dhe po bisedojnë.”

Shejh Muhamed Kermanshahi i përmendur më lart, është një nga dijetarët e njohur dhe besimtarët e devotshëm. Në duart e tij ka qenë drejtimi i qytetit të Taheranit për një kohë të gjatë dhe nuk ka parë dikush gabime apo gjynahe.¹

Tregimi i pestë

Tregohet në librin “Errbainat” të të njohurit gjykatësi Said el Kummij (Zoti e mëshiroftë!) se ka thënë:

Nga një burim i sigurt na është treguar se mësuesi i mësuesit tanë dhe bukuria e fesë, shejh Behai el Amilij (Zoti e mëshiroftë!), ka shkuar një ditë të vizitonte disa njerëz besimtar dhe kujdesës të disa varreve në Esfehian, ku dhe ai banonte.

Një person nga këta kujdestarët e varreve i ka thënë shejh Behait: “Në këtë varr kam parë diçka të çuditshme para disa ditësh. Pashë se një grup njerëzish sollën një xhenaze dhe e varrosën diku në një vend të këtyre varrezave dhe u larguan.

Pas një ore nga varrimi i tij, nuhata një erë të mirë e cila nuk ishte nga erërat e kësaj bote. U habita dhe po shikoja sa majtas dhe sa djathtas për të mësuar se nga vjen kjo erë.

Pa pritur pashë një djalë të ri, të pashëm në fytyrë dhe me veshje si të mbretërve, i cili po shkonte drejt varrit të atij personit që ishte varrosur më parë. Eci e eci derisa arriti tek varri. Më çuditë ardhja e tij tek ky varr. E pashë se u ul pranë varrit dhe në atë çast u zhduk sikur të kishte hyrë në varr.

Pas një kohe shumë të shkurtër nuhata një erë shumë të keqe, me e keqe se çdo aromë e qelbur.

Hodha një vështrim dhe pashë një qen që po ndiqte gjurmët e atij djali të ri derisa arriti tek varri dhe pastaj u zhduk.

Habia ime u shtua më shumë. Duke qenë në këtë gjendje, pashë atë djalin që erdhi më parë në një gjendje të keqe, me paraqitje të keqe, i mbushur me plagë dhe u largua andej nga erdhi. Unë shkova pas tij. Doja të dija nga ai për të vërtetën e kësaj ndodhie. Ai më tha: “Unë jam puna e mira të këtij njeriu të vdekur. Isha i urdhëruar që të isha me të në varr. Por, pa pritur erdhi ai qeni që shikove më parë, ai është puna e keqe e të vdekurit. Desha që ta largoja nga varri i tij por, ai më sulmoi dhe më kafshoi dhe më plagosi sikurse po më shikon. Ai më ndaloi që të qëndroja me të në varr. U detyrova ta lë varrin, kështu dola dhe e lashë të vdekurin vetëm.

Shejh Behai tha: “Të vërtetën the. Ne themi se veprat personifikohen apo shndërrohen në forma të ndryshme sipas gjendjes apo kushteve.”²

Autori i librit thotë:

Kjo histori mbështetet tek një hadith të transmetuar nga shejh Sudduk në fillim të “El Amalij” ku përmbledhja e tij është se Kajs bin Asim El Munkerij, përfaqësues i një grupi nga fisi Beni Temim, erdhi tek Profeti dhe i kërkoi atij një këshillë të dobishme dhe Profeti (paqja dhe bekimi i All’llahut qoshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e këshilloi atë me disa këshilla ndër të cilat ato ishin: “O Kajs, duhet që një shok i yti të varrosset me ty,

¹ “Darus Selam”; vëll. 2, fq. 244-245.

² Këtë tregim e kam dëgjuar, gjithashtu, dhe nga dijetari i njohur Muhamedij Gijlanij i cili e ka treguar para namazit të xhumasë në Taheran dhe ka thënë: “Imam Homejni (Zoti qoftë i kënaqur me të!), ia tregonte këtë histori nxënësve të tij në Kum, marrë libri i Kadiut, Shejh Said Kummij...do e gjesh mendimin e Shejh Behait tek personifikimi i punëve në librin “El Errbainat”; fq 94 dhe 256.

ai duke qenë i gjallë dhe ti duke qenë i vdekur. Nëse do jetë bujar do të të mirëpresë ty dhe nëse do jetë i lig do të të lërë. Por nuk do të ringjallet vetëm se me ty dhe do të ringjallet vetëm me të dhe nuk do pyetesh vetëm se për të. Prandaj zgjidhe që të jetë i mirë se nëse është i tillë do të nderohesh me të dhe nëse është i keq do të shohësh vetëm vështirësi, sepse ai është punë apo vepër e jotja.

Atëherë Kajsi ka thënë: “O i Dërguari i All’llahut dua që këto fjalë t’i shpreh në poezi që të krenohemi me to para atyre që do vinë pas nesh nga arabët.”

Profeti urdhëroi që Hassan (poeti i profetit) Silsal bin El Delhemesi të ishte prezent dhe duke menduar në kuptimin e këtyre fjalëve dhe i hodhi në poezi para se të mbërrinte Hassan ku tha:

Zgjidh shoqërues nga punët e tua por

Shoku një djalë në varr çfarë do bënte

Dhe duhet që pas vdekjes ta llogarisësh atë

Për një ditë që ai thirret dhe pranohet

Nëse do jesh i angazhuar me ndonjë gjë

Përveç se asaj që kënaqet All’llahu me të mos u angazho

Dhe nuk do ta shoqërojë askush njeriun pas vdekjes

dhe para saj përveç se puna e tij

Sigurisht, njeriu është mysafir tek njerëzit e tij

Do të qëndroj për pak kohë në mes tyre dhe do largohet¹

Transmeton, gjithashtu, shejh Suduku (Zoti e mëshiroftë!), nga imam Sadiku, nga Profeti Muhammed (paqja dhe bekimi i All’llahut qoshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), i cili ka thënë: “Një ditë, Isai (paqja e All’llahut qoftë mbi të!) po kalonte pranë një varri ku i vdekuri po dënohej.” Pas një viti, ai kaloi përsëri aty dhe ai nuk po dënohej. Isai tha: “O Zot, para një viti kalova këtu pranë këtij varri dhe personi po dënohej. Tani kalova përsëri pranë tij dhe ai nuk po dënohej?” All’llahu i Madhëruar i shpalli Isait (paqja e All’llahut qoftë mbi të!) dhe i tha: “O shpirti i All’llahut, ai kishte lënë një djalë të mirë, i cili e përmirsoi besimin e tij, përkrahte jetimin dhe ia fala gabimet për hir të punëve të mira të djalit të tij.”²

¹ “Reudatul Uaidhin”; fq. 487, ky hadith është i njohur, por në këtë referencë kuptohet se poezinë e ka thurur Kajs bin Asim dhe unë e konstatoj atë që ka thënë autori (Zoti e mëshiroftë!).

² “Biharul Enuar”; vëll.6, f.220.

Kapitulli i katërt

Kijameti

Nga vendqëndrimet e vështira të Botës Tjetër është dhe Kijameti, tmerri i tij i madh, mbase më i madhi i tmerreve. Ai është frika shumë e madhe, të cilën All'llahu i Madhëruar e përshkruan kështu në Kura'n:

“Çështja e tij (se kur do të ndodhë) është preokupim i rëndë (për krijesat) në qiej e në tokë. Ai (kijameti) nuk ju vjen ndryshe, vetëm befasi.” (Sure “El Araf”, 187)

Pra, Kijameti është një gjë shumë e vështirë dhe e rëndë për banorët e qiellit dhe të tokës, si për melekët, xhindët dhe njerëzit dhe se do të vijë në befasi apo pa pritur.

“Kutbi Rauendi” transmeton nga Imam Aliu se Isai djali Merjemes (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur është Kijameti?”. Xhibraili pësoi një tronditje shumë të madhe sa që i ra të fiktë për një kohë dhe pasi u zgjua tha: “O shpirti i All'llahut i pyeturi nuk është në dijeni më shumë se ai që pyet dhe lexoi ajetin e sipërpërmendur.”¹

Shejh Ali bin Ibrahim El Kummij transmeton nga imam Bakiri: “Një ditë Profeti i Zotit ishte i ulur dhe tek ai kishte ardhur Xhebraili i cili sapo deshi të largohej shikoi lart nga qielli dhe i ndryshoi ngjyra e fytyrës sa që iu bë shumë e verdhë, pastaj erdhi në vete dhe iu drejtua Profetit. Të njëjtën gjë bëri dhe Profeti. Ai shikoi nga qielli nga shikoi Xhibraili, dhe u duk diçka që po mbulonte Lindjen dhe Perëndimin, sikur të ishte diçka shumë e vogël nga toka. Më pas ai tha: “O Muhammed unë jam i dërguar i All'llahut tek ty dhe ke të drejtë të zgjedhësh: Të jesh melek i dërguar më i dashur për ty ose të jesh njeri i dërguar. Profeti e pa Xhibrailin që ishte kthyer ngjyra e fytyrës. Xhibraili tha: “më mirë të jesh njeri i dërguar.”

Profeti tha: Do jem njeri i dërguar. Meleku ngriti këmbën e tij të djathtë dhe e vendosi në mes të qiellit të parë të dynjasë, pastaj ngriti këmbën tjetër dhe e vendosi në mes të qiellit të dytë të dynjasë. Kështu vazhdoi deri sa arriti në qiellin e shtatë dhe në çdo qiell që ngjitej zvogëlohej sa u bë si një shpend i vogël. Profeti u kthye nga Xhibraili dhe i tha: Të pashë shumë të frikësuar dhe nuk kam parë dikë më të frikësuar se ty me ndryshimin e ngjyrës. Ai tha: “O i Dërguari i All'llahut mos më lëndo, a e di se kush ishte ai?” Profeti iu përgjigj: “Jo.”

Xhebraili tha: Ai ishte Israfilu e ka penguar All'llahu që të zbresë² nga vendi i tij që kur ka krijuar Zoti qiejt dhe Tokën. Kur e pashë se po zbriste mendova se do të ndodhë Dita e Kijametit, prandaj më ndryshoi ngjyra e fytyrës. Kur pashë se me çfarë të ka përzgjedhur All'llahu mu rikthye ngjyra dhe vetja ime përsëri.”³

¹ “Biharul Enuar”; vëll. 7 f. 61-62.

² Autori thotë në përmbledhje: me fjalën “Zbritur” ka për qëllim se nuk ka zbritur i vetëm dhe pa lajmëruar sikurse ka zbritur në këtë rast. Kjo për të mos rënë në kundërshtim me atë që thuhet për zbritjen e tij me Xhibrailin dhe Mekailin për shkatërrimin e popullit të Lutit apo në raste të tjera sikurse transmetohen. Zoti e di më së miri.

³ “Biharul Enuar”; vëll. 59, f. 250-251. nga tefsiri i Kumejit dhe atje transmetimi thuhet se është nga imam Sadik dhe jo nga imam Bakiri sikur e sjell autori (Zoti e mëshiroftë!)

Në një transmetim tjetër thuhet: **“Melekët e afërt, qielli, toka, era, malet, detet apo diçka tjetër frikësohen nga dita e Xhuma se mos ndodhë Kijameti në këtë ditë.”**¹

Autori thotë: “Frika e qiejve dhe Tokës dhe çdo gjëje që përmendet është frika e banorëve të tyre sikurse e thonë edhe komentatorët në kuptimin e ajetit: **“Çështja e tij (se kur do të ndodhë) është preokupim i rëndë (për krijesat) në qiej e në tokë.”**

Transmetohet se Profeti kur përmendte Kijametin e forconte zërin dhe i skuqeshin faqet e tij.²

Shejh El Mufidi në librin “Irshad” thotë: “Kur u kthye Profeti nga Tebuku në Medine, erdhi tek ai Amru bin Muadh i pikëlluar. Profeti i tha: bëhu mysliman o Amru që të të ruajë All’llahu i Madhëruar nga frika e madhe, (frikë që është më e madhe se çdo frikë tjetër). Ai tha: “O Muhammed, kush është frika e madhe sepse, unë nuk frikësohem?. Profeti (paqja dhe bekimi i All’llahut qoshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) iu drejtua duke i thënë: “O Amru, nuk është ashtu sikurse e mendon dhe e llogarit ti, sepse një thirrje e vetme u bëhet njerëzve dhe të gjithë të vdekurit do të ringjallen dhe të gjallët të gjithë do të vdesin. Pastaj ata thirren përsëri me një thirrje tjetër dhe të gjithë ringjallen dhe vendosen në rreshta. Qielli do të çahet, toka do të shkatërrohet, do të bien malet pjesë-pjesë dhe do ngrihet zjarri si malet ku nuk do ngelë asgjë që ka shpirt që nuk do t’i preket zemra e tij dhe do të kujtojë gabimet e veta, do të mendojë për veten e vet, përveç asaj që do All’llahu i Madhëruar. Po ti ku je nga kjo o Amru?”

Amru tha: “Me të vërtetë, unë po dëgjoj për një gjë të madhe. Ai besoi në All’llahun dhe në të Dërguarin e Tij. Me të besuan të gjithë që ishin nga populli dhe u kthyen tek fisi i tyre.”³

Autori thotë: “Nga kjo ngjarje tregohet zemra dhe trimëria e Amru. Thuhet se ai ka qenë një nga trimat e njohur dhe ka udhëhequr hapjen e shumë vendeve joislame...”⁴

Transmetimet në këtë aspekt janë të shumta, nga të cilat përfitohet dhe nxirret konkluzioni se vështirësitë e Ditës së Kijametit (Ringjalljes) janë shumë të mëdha. Vështirësia e kësaj Dite është aq e madhe sa që të vdekurit në Berzah dhe në varr gjithashtu do të frikësohen, sepse disa të vdekur që janë kthyer në jetën e kësaj bote me lutjet e të zgjedhurve të All’llahut të Madhëruar për shkak se ndjesia e tyre ka qenë shumë e bardhë dhe kur janë pyetur për arsyet e kësaj kanë thënë: “Kur u urdhëruam për në jetë menduam se erdhi Dita e Ringjalljes. Prandaj, u zymtësua ndiesia jonë nga frika e vështirësisë dhe e frikës në Ditën e Kijametit (Ringjalljes).

Tani do përmendim disa nga veprat dhe punët që do të na shpëtojnë nga vështirësitë e Kijametit dhe do të na ruajnë nga “frika e madhe”.

Çfarë na shpëton nga vështirësitë e Kijametit dhe nga frika e madhe?

E para: Leximi i ndonjë sureje të posaçme nga Kur’ani famëlartë

Transmetohet se kush lexon suren “Jusuf” çdo ditë ose çdo natë do të ringjallet nga All’llahu i Madhëruar në Ditën e Kijametit me bukurinë e Jusufit (paqja qoftë mbi të!) dhe nuk do të preket nga frika”⁵

Transmetohet nga imam Bakiri (paqja qoftë mbi të!), i cili ka thënë: “Kush lexon suren “Duhan” në namazet farze dhe në ato nafile, do të ringjallet nga All’llahu i Madhëruar i mbrojtur Ditën e Kijametit.”⁶

¹ “Sefinetul Bihar”; vëll.2 f. 455, (Kavm).

² “Sefinetul Bihar”; vëll.1, f. 673, (Sevea).

³ “El Irshad”; f. 84.

⁴ “Sefinetul Bihar”; vëll .1, f. 690, (Shexhea).

⁵ “Theuabul A’ mal” f. 133 trasmetimi nga imam Sadiku

⁶ “Thevabul A’ mal”; f. 141.

Transmetohet nga imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!), i cili ka thënë: “Kush lexon çdo natë ose çdo ditë të xhuma suren “El Ahkaḥ” nuk All’llahu do t’i caktojë vështirsi në këtë botë si dhe do të jetë i siguar nga frika e Ditës së Kijametit nëse do All’llahu.”¹

Transmetohet nga imami (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: “Ai që lexon suren “Asr” në namazet nafile do të ringjallet nga All’llahu i Madhëruar në Ditën e Kijametit me fytyrë shkëlqyese, të qeshur dhe me sy të gëzuar deri sa të hyjë në Xhennet.”²

E dyta: Respektimi i të moshuarve mysliman

Transmeton shejh El Kulejni nga imam Xhafer Sadiku se i Dërguari i All’llahut ka thënë: “Kush respekton të moshuarit në Islam, All’llahu i Madhëruar do ta ruajë atë nga frika e madhe e Ditës së Kijametit.”³

E treta: Vdekja gjatë rrugës së shkuarjes për në Mekë apo në dy vendet e shenjta

Transmeton El Kulejni nga imam Sadiku, i cili ka thënë: “Kush vdes rrugës duke shkuar apo duke u kthyer nga Meka do të jetë i sigurt nga frika e madhe e Ditës së Kijametit”⁴

Shejh Suduku transmeton, gjithashtu, nga imam Sadiku se Profeti (paqja dhe bekimi i All’llahut qoshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Kush vdes në njërin nga dy vendet e shenjta (Mekë apo Medine që i ka nderuar All’llahu) do të ringjallet i sigurtë Ditën e Kijametit nga All’llahu i Madhëruar”⁵

E katërta: Varrimi në Mekë

Transmeton Kulejni nga imam Sadiku, i cili ka thënë: “Kush varroset në Mekë është i siguar apo i mbrojtur nga frika e madhe e Ditës së Kijametit.”⁶

E pesta: Largimi nga imoraliteti

Transmeton shejh Suduku nga Profeti (paqja dhe bekimi i All’llahut qoshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), i cili ka thënë: “Atij që i bëhet thirrje për imoralitet dhe refuzon, duke patur frikë All’llahun e Madhëruar, këtij personi All’llahu ia ka ndaluar zjarrin e Xhehenemit dhe e ka mbrojtur nga frika e madhe.”⁷

E gjashta: Shuarja e zemërimit

Shejh Ali bin Ibrahim El Kummij transmeton nga imam Bakir se ka thënë: “Kush shuan një zemërim, duke qenë i aftë për ta shfryrë atë, All’llahu i Madhëruar do t’ia mbushë atij zemrën dhe do të jetë i sigurt dhe i mbrojtur Ditën e Kijametit.”⁸

E shtata: Kujdesja për familjen e Profetit (paqja dhe bekimi i All’llahut qoshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)

All’llahu i Madhëruar në suren “Neml”, ajeti 89 thotë:

“Kush ka bërë vepër të mirë, atij do t’i takojë (shpërblim) edhe më i mirë se ajo dhe ata do të jenë të siguar prej tmerrit të asaj dite.”

Transmetohet nga imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: “Vepër e mirë” është gjithashtu, kujdesi dhe dashuria e familjes së Profetit.”⁹

¹ Referenca e mëparshme

² Referenca e mëparshme f.153.

³ “Usulul Kafij” kap. “respekti ndaj të moshuarve mysliman”; vëll.2 f. 658.

⁴ “Biharul Enuar”; vëll. 7, f.302, nga “Fur’ul Kafi”; vëll.1, f.239.

⁵ Referenca e mëparshme. Hadithi është i sigurt, të cilin e ka përmendur autori dhe se ajo që është në mes të kllapave nuk është pjesë e hadithit. “El Bihar” 99/ 387.

⁶ “El Bihar”; 99/ 387 dhe 7/ 302.

⁷ “El Buhar”; 7/ 302.

⁸ Referenca e mëparshme

⁹ Referenca e mëparshme.

E teta: Ai që ndihmon të dëshpëruarit

Transmeton shejh Suduku (paqja qoftë mbi tël) nga imam Sadiku se ka thënë: “Kush e ndihmon vëllain e tij besimtar të dëshpëruar në rast të vështirësisë së tij dhe e përkrah atë për të kaluar nevojat, për ky person do të ketë tek All’llahu i Madhëruar shtatëdhjetë e dy mëshirime apo shpërblime nga të cilat njëra do të jetë e shpejtë për përmirsimin e jetës së tij ndërsa shtatëdhjetë e një të tjerat do t’i ruhen atij për kalimin e frikës dhe vështirësive të Ditës së Kijametit.”¹

Autori thotë: “Kanë ardhur transmetime të shumta që flasin për plotësimin e nevojave të vëllezërve në fe dhe nga këto transmetime janë edhe nga imam Bakir (paqja qoftë mbi tël):

“Kush ecën për plotësimin e nevojës së vëllait mysliman, All’llahu i Madhëruar do ta mbulojë me shtatëdhjetë e pesë mijë melekë dhe çdo për çdo hap që bën All’llahu do t’i shkruajë atij një të mirë, do t’i fshijë një të keqe dhe do e ngrejë një gradë më lart. Kur t’i plotësojë nevojën e vëllait mysliman, All’llahu i Madhëruar do ta shpërblejë njësoj sikurse të kishte bërë Haxhin dhe Umren.”²

Transmetohet nga imam Sadiku: “Plotësimi i nevojës së një besimtari është më mirë se kryerja e haxhit dhe ka numëruar dhjetë herë kryerjen e Haxhit.”³

Tregohet se një adhurues nga bijtë e Izraelit pasi arriti një gradë në adhurim ka marrë rrugën për plotësimin e nevojave të njerëzve.⁴

Kuptimi i kësaj është se kur ka arritur kulmin e adhurimit, ai – në mes adhurimesh, zgjidhte adhurimin e plotësimin të nevojave të njerëzve.

Transmeton shejhul Xhelil Shadhani bin Xhibril El Kummij nga Profeti Muhammed, se ai ka parë natën e Miraxhit në derën e dytë nga dyert e Xhennetit këto fjalë: “S’ka Zot tjetër përveç All’llahut, Muhammedi është i Dërguari i All’llahut, Aliu mëkëmbës i Zotit, për çdo gjë ka një shpërblim dhe se shpërblimi i gëzimit në Botën Tjetër ka katër arsye: Ledhatimi i kokës së jetimit, sjellja mirë me të vejat, pëmbushja e nevojave të myslimanëve dhe shpenzimi i pasurisë për të varfrit dhe për të mjerët.”⁵

E nënta: Leximi i sures “Kadr” shtatë herë tek varri i besimtarit

Shejh Kulejni transmeton nga imam Rizai se ka thënë: “Ai që shkon tek varri i vëllait të tij dhe vendos dorën e tij mbi varr duke lexuar suren “Kadr” shtatë herë, mbrohet nga frika e madhe apo dita e frikës së madhe.”⁶

Kjo mbrojtje në Ditën e frikës së madhe mund të jetë për atë që lexon suren sikurse duket në transmetim, por mund të jetë dhe për të vdekurin që i lexohet ajo sure sikurse vërtetohet nga disa transmetime të tjera.

Në librin “Mexhmuat” kam lexuar se shejh Ebu Abdilah Muhamed bin Mekki el Amilij i njohur me epitelin shejhu martir ka shkuar të vizitojë varrin e mësuesit të tij dijetari Hil-lij (Zoti i mëshiroftë!) i cili ka thënë: “Është transmetuar nga njeriu i këtij varri i cili ka transmetuar nga babai i tij “el Maxhid” me zinxhirin e prejardhjes nga imam Rizai që ka thënë: “Kush viziton varrin e vëllait të tij besimtar dhe lexon suren “Kadr” dhe pastaj thotë: “O Zot lehtësoje tokën përreth tyre, ngriji shpirtërat e tyre, jepu atyre nga mirësia Jote, merri ata nën Mëshirën Tënde mos i lër në vetmi që t’i prekë vetmia e varrit, për Ty është çdo gjë e mundur, mbroje lexuesin dhe të vdekurin nga frika e Madhe.”⁷

¹ “Theuabul A’ mal”; f.179.

² “Sefinetul Buhar”; vëll. 1, f. 353.

³ Referenca e mëparshme; f.351.

⁴ Referenca e mëparshme.

⁵ “Meadi Xhismanij Jasirul Menazil” (persisht); f.81.

⁶ “Furu’ul Kafi”; vëll. 3, f. 229.

⁷ Duaja e përmendur është e përkthyer nga origjinali persisht në arabisht.

Kapitulli i pestë

Dalja nga varri

Nga etapat e vështira në Ditën e Kijametit është dalja e njeriut nga varri i tij. Kjo është një nga tre orët më të vështira dhe më të rënda që kalon i biri i Ademit (njeriu).¹

All'llahu i Madhëruar në suren "Mearixh" në ajetet 42-44 thotë:

"Po ti lëri ata të zhyten edhe më thellë në të kota dhe të dëfrehen deri që të ballafaqohen në ditën e tyre që po u premtohet. Ditën kur duke u ngutur dalin prej varreve, sikur nguteshin të idhujt. Me shikimet e tyre të përlulura i ka kapluar poshtërimi. Ajo është dita që ka qenë premtuar."

Ajeti ka kuptimin se ata dalin nga varret e tyre me shpejtësi sikur shikojnë diçka të paparë dhe drejtohen drejt saj me shpejtësi. Por, kur sytë e tyre do të jenë shumë të dobët në shikim sa që, kur shikojnë tek këmbët e tyre nuk shohin vetëm lartë, kjo, nga vështirësia e dënimit të tyre ku mbi ta ka mbizotëruar errësira.

Transmetohet se Ibn Mesudi (paqja qoftë mbi tël) ka thënë: Isha i ulur tek prijësi i besimtarëve (Imam Aliu) dhe më tha: "Në ringjallje ka pesëdhjetë vendqëndrime, çdo vendqëndrim është një mijë vite, vendqëndrimi i parë është dalja nga varri. Do të shpëtojë nga uria dhe etja ai që do të dalë nga varri duke qenë se ka besuar në Zoti, në Xhenetin dhe dhe në xhehenemit, në ringjalljen dhe në llogarinë. Ka besuar në të Dërguarin e All'llahut të Madhëruar dhe në atë që iu shpall atij nga Zoti i Gjithësisë."²

Në librin "Nehxhul Belaga", prijësi i besimtarëve, imam Aliu ka thënë: "Kjo është dita kur All'llahu i Madhëruar i bashkon të parët dhe të fundit që të diskutojnë llogaritë dhe të shpërblehen për punët, në ulje dhe në këmbë. Ata i kanë mbuluar djersët ku dhe toka dridhet prej frikës që ata kanë. Në gjendje më të mirë prej tyre do të jetë ai që do të gjejë pozicion për këmbët e tij dhe hapsirë për veten e tij.

Shejh Kulejni transmeton nga imam Sadik (paqja qoftë mbi tël) se ka thënë: "Shembulli i njerëzve në Ditën e Ringjalljes që do të dalin para Zotit të botëve është si shembulli i shigjetave në këllëf që nuk ka nga të shkojë as këtej as andej."³

Ky vendqëndrim është shumë i rëndësishëm, prandaj është e dobishme të përmendim disa raste se si do jetë gjendja e disa njerëzve kur të dalin nga varret e tyre.

E para: Dyshimi në virtytet e Aliut

Shejh Suduku (Zoti e mëshiroftël) transmeton nga ibn Abasi se Profeti (paqja qoftë mbi tël) ka thënë: "Ai që ka dyshim në virtytet e Ali bin Ebi Talib, Ditën e Ringjalljes do të dalë nga varri i tij dhe në qafë do të ketë një rrip prej zjarri i ndarë në treqind pjesë ku në çdo pjesë do jetë nga një shejtan të cilët ia nxijnë fytyrën dhe i pështynë në fytyrë."⁴

E dyta: Ata që nuk japin nga pasuria e tyre për hir të All'llahut

Shejh Kulejni transmeton nga imam Muhamed Bakir (paqja qoftë mbi tël) se ka thënë: "Ditën e Kijametit, All'llahu i Madhëruar do t'i ringjallë disa njerëz nga varret e tyre me duar të shtrënguara fort nga gryka e tyre sa që nuk mund të ushqehen me to as edhe një

¹ Kjo duke u bazuar në disa transmetime, prej tyre nga imam Sexhadi që ka thënë: "Orët e vështira për njeriun janë tri: Ora kur i vjen meleku i vdekjes, ora kur del njeriu nga varri i tij dhe ora kur ai qëndron para gjyqimit të All'llahut të Madhëruar. "El Bihar"; vëll. 6, f. 159, ndërsa në disa transmetime: në tre raste njeriu është në vështirsi shumë të madhe..... "El Biahar"; vëll.6, f. 158.

² "El Buhar" Vëll.7 fq. 111

³ Referenca e mëparshme.

⁴ "Buharul Envar" Vëll. 7 fq. 192

diçka të vogël. Me ata janë melekët, të cilët i tallin në një mënyrë shumë të rëndë duke u thënë: “Këta jana ata të cilët ndalën të mirën e vogël që t’u vinte e mira e madhe. Këtyre njerëzve All’llahu i Madhëruar u dha pasuri dhe nuk e dhanë atë që është e drejta e All’llahut nga kjo pasuri e tyre.”¹

E treta: Ai që merret me thashetheme

Shejh Suduku (Zoti qoftë i kënaqur me të!) transmeton një thënie të Profetit (paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhembti familjen e tij!) ku thuhet: “Atij që merret me thashetheme, All’llahu do t’i zbresë zjarr në varrin e tij që të digjet deri në Ditën e Kijametit dhe kur të dalë nga varri do t’i hedhë All’llahu i Madhëruar bojë të zezë në mishin e tij derisa të hyjë në Xhehenem.”²

E katërta: Transmetohet nga Profeti (paqja e Zotit qoftë mbi të!) se ka thënë: “...Ai që e kënaq syrin e tij në një grua haram, të ndaluar, do ta nxjerrë All’llahu Ditën e Kijametit të gozhduar me gozhda prej zjarri derisa të Gjykojë All’llahu të gjithë njerëzit pastaj do të urdhërojë të hidhet në zjarr.”³

E pesta: Transmetohet, gjithashtu, nga Profeti se ka thënë: “Ai që pi alkool do të dalë Ditën e Ringjalljes me fytyrë të zezë dhe sy të zinj, nofullën e shtrembëruar, i përjargur, gjuhën e tij të varur nga pas shpine.”⁴

Në librin “Ilmul Jekin” i dijetarit të hadithit “El Fajdi” gjendet një transmetim i saktë që thotë: “Ai që pi alkool do të dalë në Ditën e Kijametit dhe shishja e varur në qafë, gota në dorën e tij që është e mbushur me të gjitha kalbësirat që ekzistojnë në tokë dhe e mallkojnë të gjithë që kalojnë andej nga krijesat.”⁵

Shejh Suduku transmeton se Profeti ka thënë: “Në Ditën e Ringjalljes do të vijë një njeri me dy fytyra, me gjuhë të nxjerrë nga pas dhe në fund të këmbëve të tij valon zjarri derisa i digjet edhe trupi i tij. Pastaj i thuhet atij: “Ai që ka qenë me dy fytyra dhe me dy gjuhë në këtë botë, kështu do të dalë edhe në Ditën e Ringjalljes.”⁶

Çfarë na shpëton nga vështirësitë e Ditës së Kijametit?

Punët e dobishme për këtë vendqëndrim janë të shumta por ne do të hedhim dritë mbi to.

E para: Shoqërimi i të vdekurve (Xhenazeve)

Në një hadith thuhet: “Atij personi që shoqëron xhenazen, All’llahu i Madhëruar do t’i japë me vete melekë që do ta ruajnë dhe do të jetojnë me të nga varri gjerë në Ditën e llogarisë.”⁷

E dyta: Lehtësimi i dhimbjeve të besimtarit

Shejh Suduku transmeton nga imam Sadiku se ka thënë: “Kush ja lehtëson besimtarit dhimbjet, All’llahu i Madhëruar do t’ia lehtësojë atij Botën Tjetër dhe do të dalë nga varri i tij me zemër të gëzuar.”¹

¹ Referenca e mëparshme; f.197.

² Referenca e mëparshme; f.214.

³ Referenca e mëparshme.

⁴ Referenca e mëparshme; f. 218.

⁵ “Ilmul Jekin”; vëll. 2 f. 910.

⁶ “Biharul Envar”; vëll. 7 f. 218 marrë nga “Thavabul A’ mal” i Sudukut.

⁷ “Biharul Envar”; kap. 81 f. 263 si dhe “Mustedrik El Vesail”; vëll. 1 f. 119.

E treta: Futja e ndienjës së gëzimit tek besimtarët

Shejh Kulejni dhe shejh Suduku transmetojnë nga Sedir Sajrefiji në një hadith të gjatë nga imam Sadiku se ka thënë: “Kur të nxjerrë All’llahu besimtarin nga varri i tij do të nxjerrë edhe një person që të ecë para tij. Sa herë që të shohë besimtari një vështirësi nga vështirësitë e Ditës së Ringjalljes, ai person do t’i thotë mos u shqetëso dhe mos u frikëso, të paralajmëroj me gëzim dhe bujari nga All’llahu i Madhëruar deri sa të jesh në duart e Tij. Këtij besimtari do t’i bëhet llogari e lehtë dhe do të urdhërohen që ta dërgojnë në Xhennet dhe personi do të jetë përsëri para tij. Besimtari do t’i thotë atij: “Zoti të mëshiroftë o më i miri udhërrëfyes sepse ishe me mua nga varri dhe vetëm më paralajmëroje me gëzim dhe bujari derisa e pashë këtë gëzim dhe bujari, por kush je ti? Ai do të thotë: “Unë jam gëzimi që isha në shpirtin e vëllait tënd besimtar, më ka krijuar All’llahu Fuqplotë nga ai që të të përgëzoj ty.”²

E katërta: Veshja e besimtarit

Shejh Kulejni transmeton gjithashtu nga imam Sadik (paqja qoftë mbi të!): Kush vesh vëllain e tij me rroba dimri dhe vere do të jetë në të drejtën e Zotit që ta veshi këtë person me rrobat e xhenetit dhe ti largojë atij dhimbjet e vdekjes, zgjeroj varrin dhe të takojë melekët kur të dali nga varri përgëzim për të. Kjo është dhe fjala e All’llahut të Madhëruar në Kura’nin Famëlartë ku thotë:

“...dhe do t’i presin melekët (duke i uruar): “Kjo është dita juaj që ju premtohet.” (El Enbija, 103)³

E pesta: Kjo lutje

Sejid ibn Tausi në librin “El Ukba” transmeton nga Profeti se kush thotë në muajin Sha’ban njëmijë herë këtë lutje: “La Ilaha Il-la Allah ve la nabudu ila Ijahu muhlisine lehud dine ve lev kerihel mushrikun”, “S’ka Zot tjetër veç All’llahut dhe se nuk adhurojmë tjetër veç Atij, do qëndrojmë besnik në fenë e Tij dhe pse e urrejnë idhujtarët.”, All’llahu i Madhëruar do e shkruaj sikur ka bërë adhurim një mijë vjet dhe do t’ia fshijë atij gabimet e një mijë viteve, do të dalë nga varri Ditën e Ringjalljes dhe fytitra e tij do të jetë e ngjashme me dritën e hënës në natën e katërmëdhjetë të saj dhe do të shkruhet me besnikët dhe të devotshmit.”⁴

E gjashta: Leximi i lutjes së Parzmores së madhe në fillim të muajit të Ramazanit.⁵

E pamë të arsyeshme që në këtë pjesë të sjellim një hadith të Profetit (paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Shejh Tabarsi (Zoti e mëshiroftë!), transmeton në tefsijrin “Mexhma ul Bejan” nga El Berae bin Azib se ka thënë: “Muadh ibn Xhebel ishte ulur pranë Profetit në shtëpinë e Ebi Ejub El Ensariut dhe ka thënë: “O i Dërguari i All’llahut! A e ke parë fjalën e Zotit që thotë:

“Është dita që i fryhet surit, e ju vini grupe-grupe.” (En Nebe, 18)

¹ “Thevabul A’ mal”; f.179 si dhe tek “El Kafi” kapitulli “Besimi dhe mohimi” tema e lehtësimit të vuajtjeve të besimtarit, vëll. 3.

² Referenca e mëparshme f. 180.

³ “Usulul Kafi” “Besimi dhe Mohimi” tema kush veshën besimtarin, kjo është përmendur dhe më parë por nga referenca të tjera tek tema “Dhimbjet e vdekjes”

⁴ Thënja këtu është me nënkuptim.

⁵ Autori është mjaftuar vetëm me përmendjen e lutjes së “Parzmores së madhe”, por ai e ka përmendur atë tek libri i tij “Mefatihul Xhinan” nga imam Sexhadi (paqja qoftë mbi të!) dhe ka folur rreth rëndësisë së kësaj lutjeje ku ka thënë se kjo duhet të lexohet në disa kohë nga të cilat ka përmendur dhe fillimin e muajit të Ramazanit. “Mefatihul Xhinan” f. 86. Kuptimi i lutjes “Parzmorja e madhe” është së është emëruar lutja që e ka mësuar Profeti nga Xhibraili duke qenë i veshur me parzmoren e luftës.

Profeti i ka thënë: “O Muadh ke pyetur për një çështje shumë të madhe dhe më pas ka thënë: “Do të ringjallet populli im në ditën e mahsherit në dhjetë grupe të ndryshme, ku i ka dalluar All’llahu nga myslimanët dhe u ka ndryshuar fytyrat e tyre. Disa prej tyre do të jenë në formën e majmunit, disa në formën e derrit, disa do t’i kenë këmbët e tyre të vendosura lart dhe fytyrat e tyre poshtë me të cilat zvarriten në tokë. Disa nga ata do të jenë të verbër, disa memecë dhe nuk logjikojnë. Disa nga ata kafshojnë vetat e tyre nga ku u rrjedh qelb nëpër trup saqë ua shpifin dhe njerëzve përreth. Disa prej tyre kanë këmbët dhe duart e prera. Disa të tjerë janë të kryqëzuar në shtylla prej zjarri. Disa të tjerë janë të tejmbushur me kalbërsira. Disa të tjerë veshin xhybe (pardesy) të lyer më zift i cili ngjitet për lëkurat e tyre.

Ata të cilët janë në formën e majmunit, kanë ngrënë në kurrizin e njerëzve të tjerë.

Ata që janë në formën e derrit, janë njerëzit e pandershëm.

Ata që qëndrojnë në kokat e tyre, janë ata njerëz që kanë ngrënë kamatën.

Ata që janë të verbër, janë të padrejtët në pushtet.

Mëmecët dhe të palogjikët, janë ata njerëz që u ka pëlqyer gjithmonë vetëm puna e tyre.

Ata që kafshojnë vetat e tyre nga ku u rrjedh qelb nëpër trup saqë ua shpifin dhe njerëzve përreth, janë dijetarët dhe gjykatësit që punët e tyre nuk përputhen me fjalët e tyre.

Ata që kanë duart dhe këmbët e prera, janë ata që kanë munduar komshiun.

Ata të kryqëzuarit në shtylla prej zjarri, janë njerëzit që spiunojnë tek pushtetari.

Ata që janë të tejmbushur me kalbërsira, jana ata njerëz që kanë shumë të mira në këtë botë dhe nuk japin nga pasuria e tyre për hir të All’llahut.

Ata që veshin xhybe (pardesy) të lyer me zift, i cili ngjitet për lëkurat e tyre, janë njerëzit mendjemëdhenj dhe arrogantë.¹

¹ “Biharul Envar”; vëll. 7 f. 89.

Kapitulli i gjashtë

Peshorja

Nga etapat e vështira të Kijametit është peshorja dhe të peshuarit e veprave.

All'llahu i Madhëruar në Kur'an thotë: **“Atë ditë peshimi (masa) është i drejtë. Atij që i rëndohen peshat, ata janë të shpëtuar. Kujt i vijnë lehtë peshojat, ata e humbën vetveten, ngase i refuzuan argumentet Tona me të padrejtë.”** (Sure “A'raf”, ajetet 8-10)

Apo mohojnë në vend që të besojnë argumentet tona thotë All'llahu i Madhëruar.

Ndërsa, në Suren El Karia All'llahu thotë: **“Krisma e Kijametit. Çka është krisma? Dhe, ç'të mësoi ty se ç'është krisma? Ajo është ditë kur njerëzit bëhen si insekte të shpërndara. Dhe kodrat bëhen si leshi i shprishur. E sa i përket atij që i rëndohet pesha e veprave të tij, ai është në një jetë të këndshme. Ndërsa, atij që ka peshën e lehtë të veprave të tij, vendi i tij do të jetë në Havije. E ç'është ajo që të njoftoi se ç'është ai (Havije)? Është zjarri me nxehtësi shumë të lartë.”**

Kuptimi i kësaj sureje të ndritur është: “Kijameti quhet krisëm sepse ajo kris në zemra nga frika dhe e papritura, një ditë ku njerëzit bëhen si insektet që shpëndahen nëpër male sikur të ishin leshi i prishur. Atij që do t'i peshojnë më shumë veprat e mira do të kalojë një jetë të këndshme ndërsa atij që veprat e mira i peshojnë shumë pak, do të jetë nga banorët e zjarrit.

Dije o njeri se nuk ka as edhe një vepër që të rëndojë më shumë në peshoren e veprave të mira se sa përshëndetja apo salavati mbi Profetin dhe mbi familjen e tij të pastër si dhe shembulli në moralin e mirë.

Unë do ta zbukuroj librin tim duke përmendur disa hadithe që flasin për vlerën e salavatit për Profetin dhe do të përmend tre tregime për moralin e mirë.

I pari: Shejh Kulejni transmeton me një transmetim të konsiderueshëm nga imam Bakir apo nga imam Sadiku: “Nuk ka gjë më të rëndë në peshore se sa salavati mbi Profetin Muhammed (paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të!) dhe mbi familjen e tij. Një njeriu i vihen veprat e tij në peshore dhe nuk dallohen por kur të vendosen salavatet mbi Profetin atëherë peshorja do të mbushet dhe do të rëndojë me to.”¹

E dyta: Transmetohet nga Profeti se ka thënë: “Në Ditën e Kijametit unë do të jem tek peshorja dhe kujt t'i rëndojnë më shumë veprat e këqija do të vendos në peshore salavatet që ka rënë mbi mua dhe do t'i rëndohen veprat e mira.”²

E treta: Shejh Suduku transmeton nga imam Rizai (paqja qoftë mbi të!): “Ai që nuk mundet t'i shlyejë gjynahet e tij le të bie në salavatë mbi Profetin dhe mbi familjen e tij sepse me këto do i mposhtë apo zhdukë të gjitha gabimet e tij.”³

¹ “Usulul Kafi”; kap. “Salavatet mbi Profetin dhe familjen e tij” f. 15.

² “Buharul Envar”; vëll. 94 f. 57.

³ “Buharul Envar”; vëll. 94 f. 47.

E katërta: Është transmetuar nga libri “Davatu Ravidin” se Profeti ka thënë: “Ai që bie salavatë mbi mua tre herë në ditë dhe tre herë në natë si dashuri ndaj meje është nga e drejta e All’llahut që t’ia falë këtij personi gabimet e kësaj nate dhe asaj dite.”¹

E pesta: Transmetohet, gjithashtu, nga Profeti se ka thënë: “Kam parë në ëndërr xhaxhain tim Hamza bin Abdul Mutalib dhe vëllain tim Xhafer ibn Ebi Talib ku në duart e tyre kishin një enë **hur** me ushqim. Ata hëngrën për një orë dhe ushqimi u kthye në rrush dhe kështu pas një ore ai u kthye në hurma. U habita nga këta të dy dhe i pyeta se cila nga punët e mira të tyre kanë qënë më të vlefshme? Ata mu përgjigjën: Të jemi përkushtuar vetëm ty për nënë dhe për baba, kemi gjetur se salavati mbi ty o i Dërguari i All’llahut është puna më e mirë si dhe kujdesi dhe dashuria për Ali bin Ebi Talib.”²

E gjashta: Transmetohet nga Profeti gjithashtu se ai ka thënë: “Ai që bie salavat mbi mua në libër, vazhdojnë melekët të kërkojnë falje për këtë person derisa të jetë emri im në libër.”³

E shtata: Shejh Kulejni transmeton nga imam Sadiku se ka thënë: “Kur të përmendet emri i të Dërguarit të All’llahut shtojini salavatet mbi të, sepse ai që bie një herë në salavat mbi Profetin, All’llahu bie salavat për të një mijë herë si dhe një mijë rreshta me melekë bien salavatë mbi të. Gjithashtu, çdo krijesë e All’llahut bie në salavat mbi këtë person që bie salavat mbi Profetin e All’llahut, sikurse All’llahu dhe melekët e Tij. Ai që nuk e dëshiron diçka të tillë, është injorant i hapur dhe s’ka lidhje me All’llahun, as me Profetin dhe as me familjen e tij.

Autori thotë:

Për kuptimin e ajetit kur’anor: “Me të vërtetë, All’llahu dhe Melekët e Tij Bien salavat mbi të Dërguarin...”, Shejh Suduku transmeton në “Meanil Ahbar” nga imam Sadik se ka thënë: “Salavatet apo përshëndetjet nga All’llahu janë mëshirë, salavatet nga melekët janë kujtesë ndërsa nga njerëzit konsiderohen si lutje apo dua.” Transmetuesi ka thënë: “Si të biem në salavat mbi Muhammedin dhe familjen e tij?” Ai ka thënë: “Thoni: **“Salavatu Allahi Alejhi ve salatu Melaiketihî ve Enbijaihi ve Rusulihî ve xhemii Halkihî ala Muhamed ve Ali Muhamed Ve Salatu Alejhi ve Alejhim Rahmetu Allahi ve Berekatuhu”** d.m.th “Salavatet e All’llahut, melekëve të Tij, të Dërguarve të Tij, Profetëve të Tij si dhe të të gjitha krijesave të Tij janë për Muhammedin dhe familjen e Muhammedit (pajja, mirësia dhe mëshira e All’llahut qoftë mbi të!)”

Ai ka pyetur se kush është shpërblimi për atë që bie në salavat mbi Profetin në këtë mënyrë.

Imam Sadiku është përgjigjur: “All’llahu e pastron trupin e tij nga gabimet dhe nga gjynahet e bën si ditën që ka lindur nga barku i nënës, të pastër pa gabime.”⁴

E teta: Shejh Ebul Futuh Er Razi transmeton nga Profeti se ka thënë: “Natën e Miraxhit kur kam mbërritur në qiell kam parë një melek që kishte një mijë duar ku në secilën dorë kishte një mijë gishtërinj me të cilët mbante llogaritë dhe numrat. E pyeta Xhebrailin se kush ishte ky melek dhe se çfarë llogariste? Xhebraili më tha: “Ky melek është caktuar që të llogarisë se sa pika shiu bien nga qielli në tokë.”

I thashë këtij melekut: “Ju e dini se sa pika shiu kanë rënë nga qielli në tokë që kur ka krijuar All’llahu botën?”

Ai më tha: “O i Dërguari i All’llahut, për Atë që të ka dërguar ty me të vërtetën tek njerëzit, unë di më shumë se kaq, di se sa pika shiu kanë rënë në shkretëtirë, sa pika shiu kanë rënë në tokën e banuar dhe sa kanë rënë në kopshte, në tokën e kripur dhe në varreza.”

¹ Referenca e mëparshme f. 70.

² Referenca e mëparshme.

³ Referenca e mëparshme; f. 71.

⁴ “Meanil Ahbar”; f. 350.

Profeti tha: “U habita nga memorja e fortë e tij në ruajtjen e llogarive.”

Ai i ka thënë: “O i Dërguar i All’llahut, unë me forcën e kujtesës time, me duart dhe gishtërinjtë e mi nuk jam i aftë të llogaris vetëm një gjë të vetme. Profeti e ka pyetur se çfarë është ajo gjë?”

Ka thënë: “Populli nga umeti yt, të cilët mblidhen në një vend dhe kur përmendet emri yt bien në salavatë për ty, unë më të vërtetë nuk mund t’i llogaris shpërblimet për ta.”¹

E nënta: Shejh Kulejni ka transmetuar një salavat që të lexohet në Ikindinë e ditës së Xhuma: **“All’llahume sal-li ala Muhamedin ve ali Muhamed el evsijail merdiin bi afdali salavatike ve barik alejhim bi efdali berekatike ves selim alejhi ve alejhim ve rahmetullahi ve berekatuhu.”** “O Zot! Salavatet tua mbi Muhammedin dhe familjen e tij dhe për të gjithë ata që porosisin për ndjekje të tij. Nga më të mirat përshëndetje dhe nderoi ata me më të mirat mirësi dhe përshëndet atë dhe ata, mëshira e All’llahut dhe mirësia e Tij qoftë mbi ta.”

Dhe pas kësaj ai ka thënë: “Transmetohet se ai që e thotë shtatë herë këtë salavat, All’llahu ia kthen me të mira atij. Veprat e këtij njeriu do të jenë të pranuar dhe në Ditën e Kijametit ky njeri do të ketë në mes të syve të tij një dritë.”²

E dhjeta: Transmetohet se ai që thotë pas namazit të sabahut dhe namazit të drekës këtë salavat: **“All’llahume sali ala Muhamedin ve ala ali Muhamed ve axh-xhil ferexhehum”** **“O Zot! Salavatet Tua qofshin mbi Profetin Muhammed dhe mbi familjen e tij dhe përshpejto triumfin e tyre”**, nuk do të vdesë deri sa të shohë kaimin (imam Mehdiun).

Transmetimet që flasin për moralin e mirë janë:

Transmetimi i parë

Transmetohet nga Enes ibn Malik se ka thënë: “Isha me të Dërguarin e All’llahut i cili kishte një rrobë të lehtë me cepa dhe vrima që ja kishte bërë një beduin nëpërmjet së cilës depërtonte i ftohti gjithandej në shpatullat e tij. Beduini tha: “O Muhammed! Më ngarko në këto dy devetë e mia pasuri nga pasuria e Zotit që ti ke, sepse nuk po më jep nga pasuria jote e as nga pasuria e babait tënd.”

Për një moment Profeti heshti dhe më pas tha: “Pasuria është e Zotit, ndërsa unë jam robi i Zotit.” Më pas tha: “Do të llogaritet dhe do të kthehet haku yt o beduin se çfarë ke bërë për mua.” Beduini tha: “Përse?”

Profeti i tha: “Sepse ti nuk e shpërblen të keqen me të keqe dhe në këtë rast Profeti ka qeshur dhe më pas ka urdhëruar që në njëra deve t’i ngarkohet me elb dhe tjetra me hurma.”³

Autori thotë:

Këto transmetime i sjell këtu në këto faqe të librit për mirësi dhe mbështetje dhe jo për të treguar moralin e lartë të të Dërguarit të All’llahut apo të imamëve (paqja e Zotit qoftë mbi ta!), sepse atë e ka përshkruar All’llahu në Kur’an me “Moralin e Lartë” dhe se dijetarët e mëdhenj kanë shkruar libra mbi historinë dhe moralin e tij të përkryer dhe se kjo nuk arrihet as dhe me dhjetra volume, prandaj, përmendja e këtyre pjesëve nga unë nuk ka për qëllim tregimin e moralit të Profetit, sepse do të ishte një shëmtim i vërtetë. Të vërtetën ka thënë poeti:

Muhammedi, i pari i dy botëve të mëdha dhe dy pjesëve nga arabët dhe joarabët

Superior i të dërguarve në krijim dhe moral dhe se arrijnë atë ne dije dhe bujari.....

¹ Thënija këtu është me kuptim.

² “Mir’atul Ukul”; vëll. 15 f. 369-370.

³ “Sefinetul Bihar”; vëll. 1 f.412

Transmetimi i dytë

Është transmetuar nga Usam bin El Mustalak të ketë thënë: “Kur hyra në Medine pashë Husejn bin Aliun u habita nga pamja dhe paraqitja e tij të cilat më prekën thellë në ndjenjat e urrejtjes që kisha brenda vetes sime për babain e tij. E pyeta se a je ti djali i Ebu Turabit?” (epitet i imam Aliut)?” Ai është përgjigjur duke thënë: “Po.” Unë vazhdova të ekzagjeroj më tepër në sharjen e tij dhe të babait të tij. Ai më shikoi mua me një shikim të ëmbël dhe të butë dhe më tha: “Kërkoj mbrojtjen e All’llahut të më ruajë nga shejtani i mallkuar, me emrin e All’llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, ji falës, urdhëro për të mirë dhe largohu nga injorantët. Më shumë se të fusin në dyshime janë dyshimet e shejtanit. Kërko mbështetje tek All’llahu Fuqplotë. Ai është Dëgjuesi dhe më i Ditur, ata të cilët kanë frikë kur i prek ndonjë dyshim nga shejtani përmendin All’llahun, sepse kur ata shikojnë vëllezërit e tyre i dërgojnë ata në gjynahe dhe më pas i braktisin. Më pas më tha: “Ki vëmendjen dhe kërko falje nga All’llahu për mua dhe për vete; nëse ju kërkon mbështetjen tonë do e keni atë, nëse na refuzoni neve dhe ne do t’ju refuzojmë juve, nëse kërkon që të t’ju udhëheqim do t’ju udhëheqim juve.

Atëherë Usama ka thënë: “Pasi mendova u pendova për ato që kisha thënë më parë, por ai më tha: “Për ju nuk ka qortim sot, Zoti ju fal ju, sepse Ai është më i miri i Mëshiruesve.” Pastaj më pyeti: “Nga populli i Shamit jeni ju?” Po- i thashë. Ai më tha: “Unë e di që më të afërmit tanë që na ka dhënë All’llahu i Madhëruar jeni ju dhe se do jem i gëzuar nëse mund të të ndihmoj dhe do të jem në krahun tuaj dhe do të jem më i miri në mendimin tënd nëse do All’llahu i Madhëruar.

Usama ka thënë: “Sikur më tronditi toka me atë mikpritje dhe mirësjellje dhe mu shtua më shumë se çdo gjë mbi tokë dashuria për të dhe për babain e tij.”¹

Autori i librit thotë:

Autori i librit “Keshaf” në komentimin e ajetit “S’ka qortim për ju sot”, të cilin e sollti si argument zotëria i dëshmorëve imam Husejni, e ka përmendur si transmetim për moralin e mirë dhe se është e rastit të përmendet këtu:

Tregohet se vëllezërit e Jusufit kur e njohën vëllain e tyre, ai i ftonte ata në ushqim në mëngjes dhe në darkë, por ata iu përgjigjën duke i thënë: “Ti na fton në ushqim në mëngjes dhe në darkë, por neve jemi të turpëruar para teje, për shkak të asaj që vepruam më parë.

Jusufi ju tha: “Madhërimi i takon Atij që rriti një njeri dhe u shit për njëzet derhem e më vonë ku arriti! Dhe tani unë jam i nderuar me ju tani dhe shikohem sikurse duhet, sepse njerëzit e kanë marrë vesh se unë dhe vëllezërit e mi jemi nipat e Ibrahimit.”²

Tregohet, gjithashtu, se kur janë takuar Ja’kubi dhe Jusufi, Jakubi ka thënë: “Më trego mua o biri im për atë që të ndodhi.”

Jusufi ka thënë: “O babai im, mos më pyet për çfarë kanë bërë vëllezërit e mi me mua, por më pyet se çfarë bëri All’llahu Fuqplotë ndaj meje.”

Transmetimi i tretë

Këtë transmetim e ka rrëfyer shejh El Mufidi si dhe të tjerë.

Një burrë nga brezi i Omer ibnul Hatabit që jetonte në Medine, fyente Ebu Hasanin, (imam Musa El Kadhim) dhe e shante sa herë që e shihte atë. Një ditë, disa persona që ishin të pranishëm i thanë: “Na lër neve që ta vrasim këtë të dalë nga feja”. Por, ai ua ka ndaluar këtë gjë rreptësisht. Më pas, Ebu Hasani i ka pyetur për Umrijiun se ku mund ta gjente. I thanë se ai po punonte jashtë Medines në bujqësi. Ai i hipi gomari të tij dhe u nis drejt Umrijiut, të cilin e gjeti duke punuar tokën dhe hyri në tokën e punuar. Umriji i

¹ “Sefinetul Bihar”; vëll. 1 f.421.

² “El Keshaf”; vëll. 2 f. 503.

thirri dhe i tha që të mos ia dëmtojë tokën e punuar por, ai nuk u ndal dhe ia dëmtoi tokën e punuar derisa arriti me gomarin e tij tek Umriju. Zbriti nga gomari dhe u ul. Duke e parë Umrijiun me buzëqeshje i tha: “Sa të kam shkaktuar dëm në tokën tënde?” Ai i tha: “Njëqind dinarë.”

Ebu Hasani i tha: “Sa shpreson që të fitosh?” Umriju tha: “Nuk e di të fshehtën (gajbin)”.

Ebu Hasani i tha: “Unë të thashë se sa fitim shpreson që të vijë ty?” Ai tha: “Shpresoj që të marr dyqind dinarë.”

Umriju thotë: “Ebu Hasani (imam Kadhimi) nxorri një qese në cilën ndodheshin treqind dinarë dhe i tha: “Toka jote është ashtu si ishte dhe All’llahu Fuqiptotë të dhëntë atë që shpreson.”

Transmetuesi thotë: Umriju u ngrit dhe ia puthi kokën e tij dhe i kërkoi që t’ia falte ato që kishte thënë më parë për të. Ebu Hasani buzëqeshi dhe u largua.

Transmetuesi thotë: “Po këtë ditë imam Kadhimi shkoi në xhami dhe e gjeti Umrijiun ulur në xhami. Kur e pa imamin, Umriju tha: “Zoti e di se ku e vendos mesazhin e Tij.”

Atë e rrethuan shokët e tij dhe i thanë: “Çfarë ndodhi me ty?” Më parë thojë fjalë të tjera. Ne tani dëgjuam se po lutesh për ebu Hasanin. Ata u bënë armiq të tij dhe ai u bë armik i tyre. Kur imam ebu Hasani u kthye në shtëpinë e tij, u tha atyre të cilët patën kërkuar që të vrisnin Umrijiun: “Kush ishte më e mira, ajo që deshët ju apo ajo që desha unë. Unë e rregullova çështjen sikurse e morët vesh dhe e largova të keqen e tij.”¹

Ndërsa tregimet për moralin e mirë janë si vijojnë:

Tregimi i parë

Malik El Eshteri (Zoti e mëshiroftë!), ishte duke kaluar në tregun e Kufes dhe kishte veshur një këmishë basme dhe çallmën prej basme, gjithashtu. Një person, i cili i kushtonte shumë rëndësi veshjes kur e pa e përçmoi për shkak të rrobave të tij të thjeshta dhe e goditi atë me një gur të vogël balte, por El Eshteri nuk e vuri re dhe kaloi.

Këtij personit iu tha: “A e di se kë gjuajta? Ai tha: “Jo.” I thanë: “Ai ishte Malik El Eshteri shoku i prijësit të besimtarëve.”

Përshëndetja dhe takimi i El Eshteri me njerëzit ka qenë i hapur dhe i ngadaltë.

Kur dëgjoji se çfarë i thanë atij iu drodh trupi dhe u nis të ndiqte El Eshteriun që t’i kërkonte falje. E arriti atë në xhami dhe falej.

Pasi që El Eshteri mbaroi namazin e tij, burri u afrua dhe filloi t’i puthte këmbët. El Eshteri i habitur i tha: “Çfarë është kjo!?”

Burri i tha: “Të kërkoi falje për atë se çfarë të bëra në treg.”

El Eshteriu i tha: “Nuk ka gjë. Betohem në All’llahun, se në xhami kam hyrë vetëm që t’i kërkoi falje Zotit për ty.”²

Autori thotë:

Mendo se si ky burrë i madh u ndikua nga morali i lartë i prijësit të besimtarëve dhe se si u soll me mëkëmbësin e prijësit të besimtarëve El Eshterin, që ishte i njohur për trimëri dhe forcë të madhe. Forca e tij arrinte deri atje sa që Ibn Ebil Hadidi ka thënë: “Për Zotin, s’ka njeri që del në dyluftim me El Eshterijun dhe nuk ndahet në pjesë ai njeri, sepse All’llahu Fuqiptotë nuk ka krijuar nga arabët dhe joarabët njeri më të fortë se atë përveç mësuesit të tij Ali bin Ebi Talib dhe se ai ec në gjurmët e tij. Zoti e mëshiroftë atë që ka thënë kur e kanë pyetur për El Eshterijun: “Çfarë të them për një burrë që ka sjellë

¹ “El Irshad”; f. 297.

² “Sefinetul Bihar”; vëll. 1 f. 686.

dëshpërim në jetën e tij për banorët e Shamit dhe vdekja e tij dëshpërim për banorët e Irakut. Me të drejtë ka thënë prijësi i besimtarëve Aliu (paqja qoftë mbi të): “El Eshteriju ishte për mua sikurse isha unë për të Dërguarin e All’llahut.” Prijësi i besimtarëve u ka thënë shokëve të tij: “Ah sikur të ishin në mesin tuaj dy veta sikurse ai, apo dhe një si ai që të shikonte tek armiqtë e mi sikurse shikonte ai.”¹

Forca dhe trimëria e El Eshterijut duket në shumë vargje të thurura për të.

Përveçse forca dhe trimëria e tij kanë arritur një gradë të lartë, gjithashtu, edhe morali i tij ka qenë në këtë gradë saqë në njeri i thjeshtë e fyen dhe e godet në mes të tregut dhe ai nuk kundërpërgjigjet, por shkon në xhami dhe i lutet Zotit që ta falë atë njeri.

Nëse e analizon siç duhet, do të mësosh se trimëria, morali dhe ndjenjat shpirtërore të tij, janë më të rëndësishme për të se forca dhe trimëria trupore sikurse ka thënë edhe prijësi i besimtarëve, imam Aliu (paqja qoftë mbi të!): “Më i fortë është ai që mposht egon.”

Tregimi i dytë

Në fund të librit “El Mustedrek”, kur autori përmend biografinë e më të mirit të gjykatësve dhe dijetarëve, filozofit të madh, mësuesin e përsosur, shejh Nasirudin Et Tusij, thotë:

Thuhet se një person i ka dërguar një letër në të cilën e shante në një fjali kur i thoshte: “O qen ...”

Përgjigja e tij (zoti e mëshiroftël) ka qenë shumë e qetë. Ajo ishte: “Ajo çfarë thua o filan nuk është e vërtetë, sepse qeni është katërkëmbësh, ai leh dhe ka thonj të mëdhenj, ndërsa unë rri në dy këmbë, kam thonj të vegjël, flas dhe qesh dhe se këto cilësi janë të ndryshme me ato cilësi dhe veçori që përmende.”²

Të njëjtat përgjigje i shkroi edhe për paragrafet e tjera të letrës, pa përdorur ofendim.

Autori thotë:

Nuk është habi për këtë njeri të nderuar, sepse eruditi El Hil-liji (Zoti e mëshiroftël) për të thotë: “Ky shejh ka qenë më i miri i kohës së tij në dituritë logjike dhe transmetuese dhe ka shkruar shumë në fushën e drejtësisë dhe të jurisprudentës, sipas shkollës Imamijetu. Ka qenë ndër më të nderuarit nga çfarë kemi parë ne (Zoti ia ndriçoftë varrin e tij).”³

I nderuari thotë: Është rasti që ta personifikojmë me dy vargje:

Në çdo erë të mirë që kam shijuar nga misku dhe karafil,

Era e tij është më e mira dhe qëndron e para.⁴

Shejh Tusij e ka përsosur moralin e tij duke ndjekur porosinë e prijësit të besimtarëve, nga i cili ka dëgjuar: “Një burrë po shante Kamberin dhe peshkatori deshi t’i përgjigjej por, prijësi i besimtarëve i thirri dhe i tha: “Me ngadalë Kamber, lëre atë që të shan dhe të ofendon ty në punën e tij se kështu është i kënaqur Zoti, shejtani i hidhëruar dhe armiku yt i dënuar. Beto hem në Atë që çan arën dhe jep ajrin se besimtari e kënaq Zotin kur hesht dhe nuk përgjigjet, e hidhëron shejtanin dhe dënimi më i madh se sa heshtja ndaj të paditurit.”⁵

¹ Referenca e mëparshme. Është e qartë se së pari Muhammedi (paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të!) është njeriu më i fortë që ka krijuar All’llahu Fuqiplotë. Prijësi i besimtarëve, imam Aliu e ka thënë se Muhammedi (paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të!) është më i fortë se unë.

² “Mustedrekul Vesail”; vëll. 3 f.464.

³ Referenca e mëparshme; f. 465.

⁴ E para nga erërat e mira dhe se qëllimi këtu është se çdo krijesë me moral të pastër do të jetë në mesin e historisë së dijetarëve, sepse janë frymëzuar në moralin e lartë të të Dërguarit të All’llahut të Madhëruar dhe të familjes së tij të pastër, (Zoti qoftë i kënaqur me to!).

⁵ “Sefinetul Bihar”; (Hilm) vëll. 1 f. 300.

Shejh Tusijin e kanë lavdëruar pasardhësit dhe ndjekësit e tij dhe shkrimtarë të ndryshëm. Xherxhij Zijdan në letërsinë e gjuhës arabe, në biografinë e tij për shejh Tusin ka thënë: “Ka hapur një bibliotekë dhe e ka pajisur me më shumë se katërqind mijë libra.” Në këtë bibliotekë kanë ardhur studiues dhe filozofë dhe kanë studiuar shumë kohë, kështu është përhapur dituria në vende të ndryshme nga dora e këtij persi si të ishte një pishtar drite në errësirën e zezë.”

Biografia e tij është paraqitur dhe tek libri “Fevaid Er Redvijetu”, i cili është një libër që flet për dijetarët e shkollës Imamijetu, ku përmendet se ai është nga vendi “Uishare” pjesë e “Xhehrudit, 10 ferasih nga qyteti i Kummit, mirëpo, ai ka lindur në Tus me 11 Xhemadil Evel të vitit 597 të hixhrit dhe ka vdekur nga fundi i ditës së hënë të 28 Dhul Hixhe të vitit 672 h dhe është varrosur në Kadhimijen e ndritur. Ndërsa disa të tjerë e kanë përshkruar historinë e vdekjes së tij me poezi.

Tregimi i tretë

Shejh Xhaferi i pari i dijetarëve të mëdhenj dhe autori i librit “Keshful Gita” (Zoti e mëshiroftë!), një ditë ishte në Esfehan dhe para se të fillonte namazin me xhemat ndau një shumë parash për të varfërit. Më pas, ai filloi namazin dhe pasi që mbaroi namazin e parë në mes të dy namazeve erdhi një sejjid¹ i varfër që nuk kishte qenë aty në çastin që kishte ndarë paratë. I ka thënë shejh Xhaferit: “Më jep mua nga pasuria e gjyshit tim.”

Shejh Xhaferi i ka thënë: “Ke ardhur me vonesë dhe nuk më kanë ngelur para që të të jap.”

Sejjidi i varfër u zemërua dhe e pështyu shejhun në fytyrë. Shejhu u ngrit në këmbë dhe doli tek vendi i imamit ku mori një cep të xhybes së tij në dorë dhe u soll përreth rreshtave të njerëzve që faleshin dhe më pas tha: “Kush e do mjekrën e shejhut le ta ndihmojë këtë të varfër.” Njerëzit e mbushën xhyben e shejhut me para dhe ia dha këtij të varfëri dhe më pas vazhdoi të falej.”²

Medito dhe përfito nga morali i lartë e i nderuar i këtij personi dhe i të gjithë atyre që kanë arritur gradën e udhëheqjes së myslimanëve, argumenti i Islamit dhe jurist sipas familjes së Profetit (paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Dituria e tij kishte arritur deri aty sa ai e ka shkruar librin e tij “Keshful Gita” gjatë udhëtimit ku tregohet se për këtë ai ka thënë: “Sikur të fshihen të gjithë librat e jurisprudencës, do të kisha shkruar disa vëllime duke filluar nga pastërtia e deri te njollat mbi zemër. Të gjithë fëmijët e tij kanë qenë juristë islamë dhe dijetarë të njohur.

E shikoj të arsyeshme që të sjell këtu thënien e një murgu të njohur sikurse transmetohet nga Kethm Zahid se ka thënë:

Kam parë një murg tek dera e Shtëpisë së Shenjtë (Bejtul Makdis) si shërbyes dhe i thashë që të më këshillojë për diçka. Ai më tha: “Ji si njeriu që frikësohet nga kafshët e egra, i alarmuar nga frika harron të ruhet dhe kështu e kafshojnë dhe e hanë. Nata e tij është e frikshme nëse e sigurojnë të pangopurit dhe dita e tij është e dëshpëruar nëse gëzohen ata që vetëquhen triumfatorë. Më pas, ai më përshëndeti dhe filloi të largohet por unë i thashë më këshillo më shumë. Ai më tha: “I eturi ngopet me pak ujë.”

Tregimi i katërt

Transmetohet se Sahib ibn Ibad një ditë ka kërkuar të pijë dhe njëri nga shërbëtorët e tij i sollti një gotë.

¹ Sejjid është personi, i cili vishet me çallmë të zezë të medh’hebi imamit

² Autori e ka përmendur tek “Sefinetul Buhar” se shejh Xhaferi është nga gjeneza e mbretit El Eshteri (Zoti qoftë i kënaqur me të!)

Kur ka dashur Sahibi të pijë, njëri nga të afërmit e tij që ishte i pranishëm i ka thënë: “Mos e pi sepse është pije e keqe dhe në të ka helm.” Djali që ia kishte sjellë pijen ishte akoma i pranishëm.

Sahibi i tha: “Kush është argumeti yt për këtë që thua?”

“Provoje atë tek njeriu që ta shërbeu ty këtë pije”, - ia ktheu i pranishmi.

“Nuk e lejoj këtë dhe është e pamundur” - tha Sahibi.

“Provoje në një pulë”, - i tha sërish i pranishmi.

Sahibi tha: “Prova me kafshët nuk është e lejuar.”

Sahibi e ktheu gotën dhe urdhëroi që t’ia ndërronin, ndërsa atij djalit që i shërbeu i tha: “Largohu dhe mos hyr më në shtëpinë time. Urdhëroi që t’i jepnin pagën e tij dhe u pagua. Më pas, Sahibi tha: “Nuk hiqet bindja me dyshim dhe dënimi me ndërprerjen e riskut është gjë e ulët”.¹

Autori thotë:

Sahib bin Ibade ka qenë nga ministrat e fisit Buvejh dhe ka qenë strehë për të afërmit dhe për mbarë njerëzit, si dhe nga ai merrnin mendime masa dhe qeveria, paria. Ka qenë nga një familje e nderuar dhe fisnike. Ka qenë ndër të vetmit në kohën e tij në moral, mirësi, bujari dhe në gjuhën arabe. Tregohet se kur ai dilte për të mbajtur fjalim, mblidheshin një numër i madh njerëzish të cilët kërkonin të përfitonin nga ai, sepse ai kishte gjashtë veta të cilët e shkruanin fjalët e tij tek të pranishmit. Librat e gjuhës që ai ka shkruar kanë qenë aq të shumtë sa që për mbajtjen e tyre do të duheshin gjashtëdhjetë deve. Për të parët, të diturit dhe të vlerësuarit ai kishte një pozitë të madhe dhe të lartë. Ai ishte bujar me dijetarët dhe u jepte kurajo për të punuar, për të shkruar libra dhe lexuar sa më shumë. Shejh Hasan bin Muhamed El Kummij ka shkruar për të histori. Shejh Suduku për të ka shkruar librin “Ujunul Ahbaru Rida”. Eth Thalebiji ka shkruar për të librin “Jetimetu Deher”. Mirësia e tij e madhe dhe respekti për dijetarët, juristët dhe poetët e mëdhenj kanë qenë të pakufishme. Thuhet se ai dërgonte çdo vit në Bagdat pesë mijë dinar për të gjithë juristët e tij.

Ka qenë bërë traditë që në shtëpinë e tij në muajin e Ramazanit njerëzit fillonin të hynin që në kohën e Ikindisë për iftar. Në shtëpinë e tij çdo natë të muajit të Ramazanit për iftar mblidheshin shumë njerëz.

Lëmosha dhe zekati i tij në muajin e Ramazanit ishte i barabartë me atë se çfarë jepte për bamirësi dhe zekat për njerëzit gjatë gjithë vitit. Ai ka shumë rreth virtyteve të prijësit të besimtarëve, imam Aliut dhe shkrime kritike ndaj armiqve të tij.

Ai ka vdekur në Raj me 24 të muajit Sefer të vitit 385 të hixhrit. Trupi i tij prehet në Esfehan.

¹ “Sefinetul Bihar”; vëll. 2 f. 14.

Kapitulli i shtatë

Llogaria

Nga vendqëndrimet apo etapat e vështira të Botës Tjetër është dhënia e llogarisë. Në suren “Enbija”, në ajetin e parë, All’llahu i Madhëruar thotë: **“Njerëzve u është afruar koha e llogarisë së tyre, e ata të hutuar në pakujdesi, nuk përgatiten fare për të.”**

Dhe, në suren “Talak”, ajetet 8-10 thotë: **“Sa shumë banorë të fshatrave, që ishin kryeneçë ndaj urdhrit të Zotit të vet dhe ndaj të dërguarve të Tij, Ne i kemi shpërblyer me një llogari të ashpër, i kemi ndëshkuar me një dënim të papërshtueshëm. Dhe ata e përjetuan barrën e rëndë të punës së vet, kështu që fundi i çështjes së tyre ishte dështimi; All-llahu u ka përgatitur dënim të rëndë atyre, pra, kini frikë All-llahun o ju të zotët e mendjes. E ju që keni besuar, All-llahu ua zbriti juve shpalljen (Kur’anin).”**

Ka shumë ajete të tjera që flasin për këtë temë por ne po mjaftohemi me këto të përmendurat dhe më poshtë do të përmendim disa hadithe.

I pari:

Shejh Suduku transmeton nga rrugë të ndryshme nga anëtarët e familjes së Profetit (paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të!) se ai (Profeti) ka thënë: **“Në Ditën e Kijametit njeriu do vazhdojë të qëndrojë në këmbë derisa të pyetet për katër gjëra: ‘Për jetën se ku e ka kaluar, për rininë se ku e ka shfrytëzuar, për pasurinë se ku e ka fituar dhe ku e ka shpenzuar dhe për dashurinë e familjes së Profetit.’”**¹

I dyti:

Shejh Tusij transmeton nga imam Bakir se ka thënë: **“Për gjënë e parë që do të pyetet njeriu në Ditën e Kijametit është namazi. Nëse ai është i pranuar, janë pranuar edhe punët e tjera.”**²

I treti:

Shejh Suduku ka transmetuar nga një i besueshëm se ka thënë: **“Ditën e Kijametit sillet borxhliu, i cili ankohet nga vetmia. Nëse ka të mira, i merren dhe i kalojnë atij që i është marrë boxhi dhe nëse nuk ka të mira i merren të këqijat e borxhdhënësit dhe i kalojnë atij.”**³

I katërti:

Shejh Kulejni transmeton nga imam Sexhadi se ka thënë: **“...Dijeni o robtë e All’llahut se për politeistët nuk do të ketë llogari dhe nuk do tu jepen librat por, do të hidhen në zjarrin e Xhehenemit, ndërsa llogaria dhe dhënia e librit është vetëm për monoteistët...”**⁴

¹ “El Bihar”; vëll. 7 f. 258.

² Referenca e mëparshme; f. 267.

³ Referenca e mëparshme; f. 274.

⁴ Referenca e mëparshme; f. 250.

I pesti:

Shejh Suduku transmeton nga imam Sadiku se ka thënë: “Ditën e Kijametit do të qëndrojnë dy njerëz në llogari dhe të dy këta do të jenë banorë të Xhennetit: I varfri në dunja dhe i pasuri në dunja.

I varfri do të thotë: “O Zot përse po qëndroj këtu? Pasha Madhërinë Tënde, Ti e di se nuk më ke bërë mëkëmbës që të jem i drejtë apo të bëj padrejtësi, nuk më ke dhënë pasuri që të jap nga ajo sa duhet apo jo dhe se risku im ka qenë i pakët aq sa Ti e di atë që më kishe caktuar mua. All’llahu i Madhëruar thotë: “Të vërtetën tha robi im prandaj merreni për në Xhennet.”

I pasuri do të qëndrojë derisa të djersitet aq sa do tu mjaftonte për të pirë dyzet deveve dhe më pas do të hyjë në Xhennet. I varfri do t’i thotë: “Kush ishte dënimi yt? I pasuri thotë: “Gjatë gjithë kohës së llogarisë më sillnin diçka më të cilën më falnin mua, pastaj pyes për diçka tjetër derisa All’llahu Fuqplotë më mbuloi me mëshirën e Tij dhe më bëri me të penduarit. Po ti, kush je - e pyet i pasuri? Ai thotë: Unë jam ai i varfri që isha me ty më parë. I pasuri i thotë: “Të paska ndryshuar mirësia pas meje.”¹

I gjashti:

Shejh Kulejni transmeton nga imam Rizai (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: **“Ditën e Kijametit All’llahu i Madhëruar do t’u kërkojë llogari robve të Tij sipas aftësive mendore që i ka dhënë në botë (dunja).”**²

Tregim

Është transmetuar me shkrimin e “shehidul evel”, dëshmorit të parë (Zoti e mëshiroftë!), se Ahmed bin Ebi El Havari ka thënë: “Kam shpresuar që të shikoj Ebu Sulejman Ed Daranijun³ derisa e pashë atë në ëndërr pas një viti dhe i thashë: “O mësues, çfarë të ka përgatitur All’llahu i Madhëruar?

Ai më tha: “O Ahmed një herë hyra te “babu sagjir” (vendprehje që ndodhet në Damask) dhe pashë një deve të ngarkuar me një lloj bime me emrin “esh-shijh” nga e cila mora vetëm një dhe nuk e di a i kam kruajtur me të dhëmbët apo jo dhe e kam hedhur. Unë që prej një viti jam këtu dhe po jap llogari për atë bimë.

Autori thotë:

Nuk ka diçka të largët dhe të pabesueshme nga kjo ndodhi, sepse këtë e vërteton edhe ajeti i nderuar ku All’llahu i Madhëruar thotë: **“O djali im, s’ka dyshim se edhe nëse ajo (vepra) peshon sa kokrra e lirit, e të jetë e fshehur në rrasë guri, ose në qiej apo në tokë, All-llahu do ta sjellë atë, se All-llahu është i Butë dhe hollësisht i informuar.”**⁴ (sure “Lukman”, ajeti 16)

Prijësi i besimtarëve në një nga fjalimet e tij ka thënë: **“A nuk janë shpirtat tanë përgjegjës për veprat, qofshin ato edhe sa kokrra e lirit.”?!**

Në një letër që i ka shkruar Muhamed ibn Ebu Bekrit thotë: **“Dijeni o robtë e Zotit se All’llahu i Madhëruar do t’ju pyesë ju për të voglat dhe të mëdhatë e punëve tuaja.”**

Në letrën dërguar ibn Abasit ai i thotë: **“A nuk ke frikë nga diskutimi i llogarisë?”**

¹ Referenca e mëparshme; f. 259.

² Referenca e mëparshme; f. 267, Nga imam Bakiri.

³ Ebu Sulejman Ed Daranij Abdu Rrahman Bin Ahmed Atijetu, i njohur, ka vdekur në Darja, një nga fshatrat e Damaskut në vitin 235, varri i tij është i njohur. Ahmet Ibn Ebi El Hivari është nga shokët e tij. Autori

⁴ Komentuesit thonë: O Biri im nëse është vepra e njeriut e keqe apo e mirë sado e vogël të jetë qoftë dhe sa një grimce mustardi në mendjen e njeriut do të vijë me të All’llahu i Madhëruar Ditën e Llogarisë dhe do të llogaritet dhe ajo grimcë. (Autori)

Fjala diskutim këtu ka të bëjë me mundimin për të dalë nga dënimi, sikurse për të dalë nga një vështirësi bëhet diskutim, po ashtu edhe në ditën e llogarisë na mundon ankthi i gjykimit. Disa dijetarë kanë thënë: ‘Nuk do të shpëtojë asnjë njeri nga vështirësia e peshores dhe e llogarisë, përveç atij që i ka bërë llogari vetes së tij që në këtë botë dhe i ka peshuar veprat, fjalët, vështirësitë dhe momentet e tij sikurse thuhet në hadithin e njohur: “Llogaritini vetet tuaja para se t’ju llogaritin, peshojini punët tuaja para se t’ua peshojnë ato.”

Tregim

Tregohet se një person i quajtur Tevbetu bin Es Samet i bënte llogari vetes së tij në shumicën e kohës, natën dhe ditën. Një ditë ai llogariti ditët e jetës së tij dhe i dolën se kishte kaluar 21500 ditë dhe tha: “O i mjeri unë! Do të takoj melekun me 21500 ditë.

Ka thënë këto fjalë dhe i ka rënë të fikët dhe ka vdekur.”¹

Dijetari thotë:

Transmetohet se i Dërguari i All’llahut të Madhëruar kur ka shkuar në një fshat në shkretëtirë në të cilin nuk kishte pemë, u ka thënë shokëve të tij: “Më sillni dru zjarri.” Ata i thanë: “Jemi në tokë të shkretë o i Dërguari i All’llahut dhe këtu nuk ka dru zjarri.” Profeti ka thënë që çdo njëri të sjellë çfarë të mundet. Ata erdhën dhe në duart e tyre mbanin nga disa dru të cilat i mblodhën në një vend. Profeti u ka thënë: “Kështu mblidhen gjynahet.”²

Nga këtu bëhet e qartë se qëllimi i Profetit me urdhrin për mbledhjen e drurëve të zjarrit ka qenë që t’u shpjegojë shokëve të tij se sikurse mblidhen drurët e zjarrit në një shkretëtirë pa pemë, ku ata nuk e imagjinojnë mbledhjen e të gjitha atyre drurëve që u bashkuan së bashku; po ashtu mblidhen gjynahet dhe gabimet kur të bëhet llogaria, ku nuk e imagjinojnë se sa do të mblidhen, siç është shembulli i llogarisë së Tevbetu bin Samet sikur dhe nga një gabim i vetëm në ditë të bëhet.

¹ Ky tregim ka ardhur në një transmetim tjetër me një ndryshim të vogël ku është përmendur se koha ka qenë 21600 dhe se ai ka thënë i mjeri unë që do takoj Zotin tim me 21600 gabime apo gjynahe. Kjo, nëse në jetën time çdo ditë kam bërë nga një gabim të vetëm, por unë kam bërë me dhjetra gabime. Më pas, i ka rënë të fikët dhe kur e kanë prekur e kanë parë se ka vdekur dhe është dëgjuar të thuhet: “O çfarë vendi në Firdevsin e ngritur”.

² “Usulul Kafi” vëll. 2 fq. 288

Kapitulli i tetë

Librat e veprave

Nga vendqëndrimet e vështira të Kijametit është dhe momenti i dhënies së librave ku janë shënuar veprat e njeriut, sikurse thotë All'llahu i Madhëruar në përshkrimin e Kijametit në suren "Tekvir" ajeti 10: **"Dhe kur fletushkat të jenë shpalosur."**

Ali ibn Ibrahim El Kummij ka thënë: "Fjala *fletushkat* ka qëllimin e veprave të njerëzve". Përsa i përket atij, që libri i vet i jepet nga e djathta, ai do të llogaritet me një llogari të lehtë. Do të kthehet te familja e tij i gëzuar. E përsa i përket atij që libri i jepet pas shpinës, ai do të ketë vetëm shkatërrim dhe do të hyjë në zjarr.

Ajashi trasmeton nga imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: **"Në Ditën e Kijametit i jepet njeriut libri i tij dhe i thuhet; lexo."** I thashë: **"A e di ai se çfarë ka të shkruar në të?" Ai mu përgjigj: "All'llahu Fuqplotë çdo moment, fjalë, çdo lëvizje apo diçka që ka bërë, ia kujton atij sikur ta kishte bërë në atë çast. Për këtë kanë thënë: "Të mjerët ne nga ky libër i cili i ka shënuar të gjitha, qoftë e vogël apo e madhe."**

Eruditi Mexhlisij (Zoti e mëshiroftë!) në librin "Et Tehfetu" është marrë sipas dy transmetimeve nga imam Rizai (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: **"Ai që më viziton mua pas vdekjes sime, do të jem me të në Ditën e Kijametit në tre çaste të rëndësishme dhe do e shpëtoj nga ato vështirësi: "Kur t'i hidhen librat në të djathtë dhe të majtë, tek ura e Siratit dhe tek Peshorja."**

Thuhet në librin "Hakul Jekin" se Husejn bin Said ka transmetuar nga imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "All'llahu Fuqplotë kur do të llogarisë veprat e njeriut do t'i japë librin e tij në të djathtë dhe llogaria do të jetë mbi çfarë përmban ky libër dhe thotë: "O krijesa Ime, ti ke bërë këtë dhe këtë dhe ke punuar këtë dhe këtë. Njeriu do të thotë: "Po o Zoti im me të vërtetë kam bërë këtë. All'llahu do t'i thotë: "Ti kam falur gabimet dhe t'i kam zëvendësuar me të mira." Njerëzit do të thonë: "Madhërimi i përket All'llahut, a nuk ka pasur ky njeri as edhe një gabim?! Më pas vjen fjala e All'llahut të Madhëruar: **"Përsa i përket atij që libri i vet i jepet nga e djathta, ai do të llogaritet me një llogari të lehtë, do të kthehet te familja e tij i gëzuar."** (sure "Inshikak", ajetet 7-9)

I thashë: "Cila familje?" Ai më tha: "Familja e tij në këtë botë. Nëse kanë qenë besimtarë do të jenë edhe familja e tij në Xhennet."

Ai tha: "Ndërsa njeriun e keq, do ta nxjerrë për llogari para njerëzve dhe do t'ia japë librin e tij në krahun e majtë, siç është fjala e All'llahut që thotë: **"E përsa i përket atij që libri i vet i jepet pas shpinës, ai do të ketë vetes shkatërrim dhe do të hyjë në zjarr të ndezur fort, ai ka qenë i gëzuar në familjen e vet"** (sure "Inshikak", ajetet 10-13)

E pyeta përsëri: "Cila familje?" Ai më tha: "Familja e tij në këtë botë." I përmenda fjalën e All'llahut të Madhëruar: **"Dhe ka menduar se nuk ka për t'u kthyer."** (sure "Inshikak", ajeti 14) Ai më tha: "Ai mendoi se nuk do të ringjallet."³

Kjo tregon se mohuesit dhe dyfytarakët do të lidhen nga qafat e tyre dhe do t'u jepen librat nga pas shpine dhe nga e majta e tyre."⁴

¹ "El Buhar" Vëll. 7 fq. 315

² "El Hisal" fq.168 dhe "Ujunu Ahbaru Rrida" Vëll. 2 fq. 258

³ "El Bihar"; vëll. 7 f. 324-325.

⁴ "Hakul Jekin"; f. 328-329.

Për këto dy gjendje të njeriut bën fjalë edhe duaaja e abdesit kur lajmë duart e themi: “O Zot më jep librin në dorën e djathtë dhe më mundëso llogari të lehtë. O Zot mos ma jep librin në krahun e majtë dhe mos më prangos nga qafa ime”. Ty të kërkoj mbrojte prej dënimit të zjarrit.”¹

Autori thotë:

E kam parë të arsyeshme që të përmend një transmetim nga Sejjid ibn Tausit (Zoti e mëshiroftë!) ku thuhet: “Kur fillonte muaji i Ramazanit Ali bin Husejni shkruante se në këtë ditë bëri gabim filani ose filania dhe nuk është ndëshkuar. I mblidheshin atij rastet deri në natën e fundit të Ramazanit ku ai i thërriste dhe u tregonte librin e tyre (Çfarë kishte shkruar). Më pas ai thoshte: “O filan, ke bërë këtë dhe këtë dhe nuk të kam qortuar, a e kujton këtë? Thotë: “Po.”

Kështu vepronte me të gjithë deri sa përfundon dhe në fund qëndron në mes të tyre dhe u thotë: “Ngrijini zërat tuaj dhe thoni: O Ali bin Husejn, me të vërtetë, Zoti yt të ka shënuar çdo gjë që ke punuar sikurse i ke shënuar çdo gjë që kemi punuar. Me të vërtetë, Zoti ka librin e saktë ku nuk humbet as e vogla as e madhja, por llogaritet çdo gjë dhe çdo gjë që ke vepruar do ta gësh sikurse ne gjetëm çdo gjë që kemi punuar tek ti. Na fal neve sikurse dëshiron që Sunduesi i Gjithësisë të të falë ty ... Vërtet, Zoti nuk i bën padrejtësi askujt.

Përkujto o Ali bin Husejn vendin tënd të nderuar në duart e Zotit të Drejtë, i Cili nuk bën padrejtësinë më të vogël qoftë edhe sa kokrra e lirit. Fal dhe lehtëso, të të falë ty Zoti, sepse Ai thotë: “Falni dhe lehtësoni, a nuk dëshironi që Zoti t’ju falë ju.”

Ai i thërret vetes së tij dhe u kujton atyre, të cilët përsërisin pas tij dhe duke qarë thotë: “O Zoti ynë, na ke urdhëruar që të falim ata që na bëjnë padrejtësi dhe neve u kemi bërë padrejtësi vetave tona dhe i kemi falur sikurse na ke urdhëruar, na fal neve, sepse Ti je më Falës se ne. Na ke urdhëruar që të mos e kthejmë lypësin me duar bosh kur vjen tek dyert tona, ne të kemi ardhur si lypës dhe të varfër para Teje dhe para Tënde. O Zot, të kërkojmë mirësinë, njohjen dhe dhënien Tënde, na e siguro këtë dhe mos na zhgënje, me të vërtetë, Ti je më i afti për këtë nga ne dhe nga ata që ke urdhëruar për këtë. O Zoti im, unë kam mëshiruar, më mëshiro mua dhe kur kam qenë i paaftë për ndihmë, u jam përgjigjur me mirësjellje, më bashko mua me banorët që Ti i ke nderuar o Bujar.”

Pastaj kthehet nga ata dhe u thotë: “Unë ju kam falur juve, a më keni falur ju mua për atë që unë mund të kem bërë ndaj jush... Sunduesi i çdo gjëje është i Drejtë, Bujar dhe i Mirë.

Ata thonë: “Të kemi falur o zotëria jonë për çfarë ti ke bërë.” Ai u thotë atyre: Thoni: “O Zot fale Ali bin Husejn sikurse ai na fali neve dhe largoje atë nga zjarri sikurse na largoi ai neve nga dënimi.” Ata e thonë këtë lutje dhe ai thotë: *Amin asbtu qoftë o Zoti i botëve*. Pastaj u thotë: “Shkoni se jeni të falur sikurse më falët mua dhe më liruat nga prangat e zjarrit, prandaj shkoni.”

Kur vinte dita e Bajramit ai u jepte shpërblime që t’i gëzonte dhe t’i pasuronte që të mos kishin nevojë për njerëzit. Çdo vit, natën e fundit të muajit të Ramazanit ai lironte rreth njëzet robër.

Ai thoshte: “Çdo natë të muajit të Ramazanit All’llahu Fuqplotë largon nga zjarri i Xhehennemit shtatëdhjetë mijë njerëz, ndërsa në natën e fundit të Ramazanit largon nga zjarri i Xhehennemit dhe aq sa ka larguar gjatë gjithë këtij muaji.”

Gjithashtu, thoshte: “Unë gëzohem që All’llahu i Madhëruar më shikon kur i heq dënimin dhe i jap lirinë ndonjë robi në këtë botë, me shpërsën që të më largojë nga dënimi i zjarrit.”²

¹ “Hakul Jekin” f. 329 në persisht, si dhe tek Lutjet e Abdesit në librin “Men La Jehdurhu El Fekih”; vëll. 1 f. 42.

² “El Murakibat”; f. 158-160.

Kapitulli i nëntë

Ura e Siratit

Një nga vendqëndrimet e vështira të Botës Tjetër është dhe Ura e Siratit.

Kjo urë është e vendosur mbi Xhehenemin dhe askush nuk mund të hyjë në Xhennet pa kaluar këtë urë. Në disa transmetime thuhet se ajo është më e hollë se fija e flokut, se tehu i shpatës dhe më djegëse se zjarri.

Besimtarët e sinqertë e kalojnë shumë lehtë këtë urë si rrufeja. Disa e kalojnë këtë me vështirësi por ia arrijnë. Disa të tjerë, nga dënimi do të bien në xhehenem.

Sirati në Botën Tjetër është konkretizimi i rrugës së drejtë në këtë botë (Dunja), që është feja e vërtetë, rruga e mëkëmbjes, ndjekja e prijësit të besimtarëve dhe të imamëve të pastër nga pasardhësit e tij (pagja qoftë mbi ta!)

Çdo njeri që nuk ka ndjekur këtë rrugë dhe është prirur nga e keqja me fjalë dhe me vepra, do të goditet nga ky dënim dhe do të bjerë në Xhehenem.

Rruga e drejtë në suren **Fatiha** tregon për këto dy grupe.

Eruditi Mexhlisij (Zoti e mëshiroftë!), në librin “Hakul Jekin” tregon nga libri “Akaid” i shejh Sudikut ku thotë: “Besojmë në ndalesat që janë mbi urën e Siratit rrugës për në jetën e përhershme. Çdo ndalesë ka një shkak apo emër si detyrim, urdhërim dhe ndalim.

Kur të arrijë njeriu tek ndalesa që mban emri Farz (detyrim) dhe ky njeri ka lënë apo nuk i ka kryer Farzet do të ndalohet dhe do bllokohet këtu. I kërkohet e drejta e Zotit në këtë farz, dhe nëse me vete ai njeri ka vepra të tjera të mira, apo e kap mëshira e Tij, ai kalon nga kjo ndalesë te tjetra. Kështu ai do të kalojë nga një ndalesë te tjetra duke u pyetur se përse ka neglizhuar me farze, sipas kuptimit të parë dhe kur t’i përshkruajë të gjitha ndalesat ai do të përfundojë në shtëpinë e përheshme ku do të kalojë jetën që nuk do të ketë vdekje kurrë, do të arrijë gëzimin dhe kënaqësinë që nuk krahasohen asnjëherë. Do të jetë nga të afërmit e All’llahut, me Profetët, besnikët, të devotshmit, dëshmorët dhe me ata që kanë bërë vepra të mira nga robtë e All’llahut.

Nëse bllokohet në ndalesat e tij dhe i thuhet përse ka qenë neglizhuar në farze dhe nuk e ndihmojnë dot veprat e tij të mira, apo nuk do e meriton mëshirën e All’llahut të Madhëruar, ai do të ngelet aty, do t’i rrëshkasin këmbët dhe do të bjerë në Xhehenem, (Zoti na ruajtë nga ai dënim!)

Këto ndëshkime apo dënime të gjitha do të jenë në Sirat dhe do t’i kalojë çdo krijesë dhe do të pyeten për ndjekjen e prijësit të besimtarëve dhe të imamëve. Ai që i ka ndjekur do të ndihmohet dhe do të kalojë ndërsa ata që nuk i kanë ndjekur nuk do të ndihmohen dhe do të hidhen. Për këtë është dhe fjala e Zotit që thotë: **“Ndalini ata, sepse do të merren në përgjegjësi.”** (sure “Saffat”, ajeti 24)

Ndër ndëshkimet më të rëndësishme është “mirsadi” sikurse e përmend All’llahu në ajetin 14 të sures “Fexhr” ku thotë: **“Sepse Zoti yt është që u rri në pritë.”**

All’llahu, gjithashtu, thotë: *“Për Madhështinë dhe Pushtetin Tim, nuk më lejohet t’i bëj padrejtësi të padrejtë”*

Emrat e ndalesave janë të shumta si; siguria, mëshira, salati (namazi), urdhërimi, ndalimi ku në çdo ndalesë njeriu qëndron dhe pyetet.”¹

Transmetohet nga imam Bakir: “Kur ka zbritur ajeti 23 i sures “Fexher” ku All’llahu i Madhëruar thotë: **“Dhe atë ditë sillet Xhehenemi”**. Profeti për këtë ka thënë: “Më ka lajmëruar Xhebraili se All’llahu që është Një kur t’i kalojë njerëzit nga Berzehu dhe do

¹ “Hakul Jekin”; vëll. 2 f. 215.

t'i mbledhë të parët dhe të fundit, do të vijë Xhehenemi. Nga forca e madhe që ka atë e drejtojnë njëqind mijë melekë me një mijë frerë. Ai është i zhurmshëm, i zemëruar, nxjerr tym dhe britmë. Tym i që nxjerr, sikur All'llahu t'i vonojë në llogari, do të përpinte të gjithë njerëzit që do të jenë aty. Më pas, ai do të nxjerrë gjuhën e tij prej zjarri, ku do të shkaktojë kaos dhe frikë tek besimtarët dhe jobesimtarët. Çdo gjë që ka krijuar All'llahu Fuqiplotë nga robtë, melekët, profetët dhe ata që i janë nënshtruar Atij, të gjithë do të thërrasin: vetja ime, vetja ime, ndërsa ti o i Dërguari i All'llahut do të thërrasësh: populli im, populli im. Pastaj mbi urën e Siratit që është më e hollë se fija e flokut dhe se tehu i shpatës do të vendosen tre pragje. E para është amaneti dhe mëshira, e dyta është namazi dhe tek e treta është drejtësia e All'llahut të Madhëruar sikurse thotë: **“Sepse Zoti yt është që u rri në pritë.”** Në Sirat njerëzit do të kapen pas këtyre pragjeve me duart e tyre dhe këmbët do t'i kenë në urë. Kur t'i rrëshkasë këmba, ai do të ngrihet ngaqë është i kapur me duar dhe do t'i thërrasin melekët: “O i Duruari! Fale, lehtësoja dhe kaloje me Mirësinë Tënde, shpëtoje shpëtoje.” Njerëzit hidhen në zjarr si insekte. Nëse kalojnë, kalojnë me mëshirën e Zotit të Gjithësisë që i shpëton. Ata thonë: “Falënderimi i takon Zotit se me Mirësinë e Tij plotësohen veprat e mira e të dobishme. Falënderimi i takon Zotit që më shpëtoi nga ura, pas shpresës në Mirësinë e Tij. Vërtet, Zoti ynë është Falës dhe e meriton falënderimin.”¹

Husejn ibn Said El Ehvazij, njeri i besuar, ka transmetuar nga imam Bakir se ka thënë: “Ebu Dherit i erdhi një burrë që ta përgëzonte se i ka lindur delja dhe i tha: “O Ebu Dherit të ka lindur delja dhe është shumë tufa.” Ai i tha: “Nuk më lehtëson shumimi i tyre dhe nuk dua të kem shumë, sa më pak më mirë për mua. Kam dëgjuar të Dërguarin e All'llahut të Madhëruar se ka thënë: Nga dy gjëra kam frikë në Ditën e Kijametit në Sirat, amanetin dhe mëshirimin, sepse një njeri që ka qenë i mëshirshëm dhe e ka ruajtur amanetin, këto dy gjëra do ta ndihmojnë dhe nuk do ta lënë të hidhet në zjarr.” Në një transmetim tjetër janë shtuar fjalët: kur të kalojë ai që se ka mbajtur amanetin dhe nuk ka qenë i mëshirshëm me njerëzit, nuk do t'i bëjnë dobi veprat tjera dhe nga ura e Siratit do të hidhet në zjarr.”²

Tregim

Sejid Behaudin Sejjid Ali bin Sejjid Abdul Kerim En Nejlî En Nexhefij, nxënësi i shejhut të rënë dëshmorë dhe nderit të dijetarëve, trasmeton në librin “Envarul Muzijetu”, kur flet për mirësitë e prijësit të besimtarëve, ka treguar një histori që lidhet me babain e vet i cili ka thënë: “Në fshatin tonë “Nijleh” ishte një burrë që shërbente në xhami. Mirëpo, një ditë ai nuk kishte dalë nga shtëpia për të shërbyer në xhami. Kur i është kërkuar që të vijë për të ndihmuar nuk ka pranuar dhe ka kërkuar falje dhe ka thënë se nuk mund të vij. Më pas, u tha se trupi i tij ishte djegur nga zjarri në mes të kofshëve dhe gjunjëve dhe kishte dhimbje të forta sa që nuk kishte qetësi. Kur u pyet për shkakun, ai tha: “Pashë në ëndërr se u bë Kijameti dhe se shumë njerëz shkonin në Xhehenem ndërsa pak në Xhennet. Unë isha nga ata njerëz që u dërguan për në Xhennet. Rrugës për në Xhennet arrita tek një urë e madhe e gjërë dhe e gjatë dhe na u tha se kjo është ura e Siratit. Filluam të ecnim mbi të. Sa më shumë që ecnim, gjerësia e saj zvogëlohej dhe gjatësia rritej sa që arriti të bëhej e hollë sa tehu i shpatës. Shikuam poshtë dhe pamë një luginë shumë të madhe në të cilën kishte zjarr të zi që vëlonte. Në këtë zjarr kishte shumë shkrepë si shkrepë e maleve.

Disa njerëz kalonin dhe disa të tjerë binin në zjarr. Unë lëkundesha gjithmonë herë në një anë dhe herë në anën tjetër si ai që është gati për të rënë, deri sa arrita në fund të urës së

¹ “Hakul Jekin”; vëll. 2 f. 213.

² “Sefinetul Bihar”; vëll. 1 f. 483.

Siratit dhe nuk arrita të mbaja ekuilibrin e trupit dhe rashë në zjarr dhe hyra në mes të tij. Por duke u zvarritur u mundova që të kapem pas diçkaje dhe arrita të dal në anë të luginës. Zjarri më digjte dhe më tërhoqe shumë. Po kërkoja ndihmë. Inkurajova veten dhe thashë: “O Ali bin Ebi Talib.” Më pas në anë të luginës pashë një burrë që ëndërronte në këmbë. Në zemrën time mu krijua besimi se ishte Ali ibn Ebi Talib dhe i thashë: “O zotëria im, o Prijësi i besimtarëve.” Ai më tha: “Më jep dorën.” Zgjata dorën time nga ai dhe më kapi e më tërhoqi dhe më hodhi në anë të luginës. Ai largoi nga trupi im zjarrin me dorën e tij të nderuar. U zgjova nga gjumi nga tmërri dhe vështirësia që pashë dhe e gjeta veten sikurse jam tani i djegur dhe nuk do të kisha shpëtuar nga zjarri sikur të mos ishte tërheqja e Imamit me dorën e tij.

Ai vazhdoi të mjekojë trupin e tij me ilaçe për rreth tre muaj deri sa u shërua. Pas kësaj, ai ishte shumë i kujdesshëm çfarë u thoshte tjerëve, që të mos prekej nga djegia.

Çfarë e lehtëson kalimin e Siratit

Dije se këtu ka disa punë që e lehtësojnë kalimin e Siratit, ndër to lidhjet farefisnore dhe mbajtja e amanetit, të cilat i përmendëm më parë.

E para:

Sejjid ibn Tausi në librin “El Ikbali” transmeton në punët e mira natën e parë të muajit Rexheb: “Ai njeri që pas namazit të Akshamit fal njëzet rekatë namaz dhe lexon nga një herë në çdo rekat suret Fatiha dhe Ihlas dhe jep selam në çdo dy rekatë, ka të ruajtur familjen, pasurinë dhe fëmijët e tij si dhe është i mbrojtur nga dënimet e varrit dhe do të kalojë Urën e Siratit si rrufeja me shpejtësi pa llogari.”¹

E dyta:

Transmetohet se *“Ai që agjëron gjashtë ditë të muajit Rexheb do të ringjallet me besimtarët Ditën e Kijametit dhe do të kalojë Urën e Siratit pa llogari.”*²

E treta:

Sejjid ibn Tausi, gjithashtu, transmeton se ai që në natën e njëzetë e nëntë të muajit Sha’ban, fal njëzet rekat namaz ku lexon në çdo rekat lexon **Fatihane** një herë, suret **Tekathur**, **Felek** dhe **Nas** nga dhjetë herë dhe suren **Ihlas** njëmbëdhjetë herë, do shpërblehet nga All’lahu i Madhëruar me shpërblimin e dy dëshmorëve, do t’i rëndohet peshorja e tij me vepra të mira, i lehtësohet llogaria dhe do të kalojë Urën e Siratit me shpejtësi si rrufeja.”³

E katërta:

Është thënë dhe në kapitullin e kaluar se kush viziton imam Rizain (paqja qoftë mbi tël) pra vendprehjen e tij, imami do ta ndihmojë këtë njeri në tre raste dhe njëri nga këto është edhe Sirati.

¹ “Mefatihul Xhinan”; f. 140.

² “Thevabul A’mal”; f. 79.

³ “Xhevamia Dua”; marrë nga libri “Mefatihul Xhinan” nga Ikbali.

Mbyllja

Rreth vuajtjeve të Xhehenemit

Histori të frikshme, shembuj edukues

Do të përmend këtu disa hadithe mbi vështirësitë e dënimit në Xhehenem, disa histori apo tregime nga ndodhitë e frikshme si dhe disa shembuj nga njerëz të ndryshëm si Bluher dhe Juzasef, nga të cilët duhet të përfitojnë besimtarët.

Hadithet

I pari:

Transmetohet me një zinxhir transmetimi të saktë nga Ebi Basir, ky nga Ebi Abdullahi [(imam Sadiku), paqja qoftë mbi të!] se ka thënë: “I thashë o nipi i të Dërguarit të All’llahut, më frikëso mua se zemra ime është e ngurtësuar.” Ai më tha: “O Ebu Muhammed, përgatitu për një jetë të gjatë, sepse një ditë Xhebraili ka ardhur tek Profeti (paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) i vrenjtur dhe i shqetësuar, ndërkohë që, ai i vinte atij gjithmonë i buzëqeshur. Profeti e ka pyetur: “O Xhebrail më ke ardhur sot i vrenjtur dhe i mërzitur.” Ai ka thënë: “O Muhammed është hapur zjarri.” Profeti Muhammed e ka pyetur: “Ç’është hapja e zjarrit o Xhebrail?” Ai është përgjigjur: “O Muhammed! Zoti ka urdhëruar hapjen e zjarrit për një mijë vjet derisa është zbardhur pastaj është hapur një mijë vjet të tjera sa është bërë i kuq, pastaj është hapur përsëri një mijë vjet sa është bërë i zi dhe ai është tani i errët dhe i zi. Sikur një pikë e vogël nga ai të bjerë në ujën e banorëve të botës do të vdesin të gjithë nga era e keqe që ka. Nëse një nga hallkat e tij, që është e gjatë shtatëdhjetë “Dhiraa” do të vendoset në tokë, do të shkrihet e gjithë toka nga nxehtësia e tij. Sikur një rrobë nga rrobat e banorëve të zjarrit të varej në mes të qiellit dhe tokës do të vdisnin të gjithë njerëzit e botës nga era e keqe e saj. Profeti qau dhe me të qau edhe Xhebraili ku në këtë kohë All’llahu dërgoi një melek tek ata të dy dhe u tha: “Zoti i juaj ju dërgon selame dhe u thotë do t’ua ndaloj atë dënim që u bën juve të vuani në këtë mënyrë.”

Ebu Abdullah ka thënë: “Profeti Muhammed nuk e ka parë më Xhibrailin të buzëqeshë pas kësaj.” Më pas ka thënë: “Banorët e zjarrit e vlerësojnë zjarrin dhe banorët e Xhennetit e vlerësojnë atë dhe të mirat e tij. Nëse do hyjnë në Xhehenem do të kalojnë në të për rreth shtatëdhjetë vite dhe kur të arrijnë në lartësinë e tij do të hidhen përsëri nga fillimi në fund të tij sikurse thotë All’llahu në Kur’an: **“Sa herë që përpiqen të dalin prej tij nga vuajtjet e padurueshme, kthehen me dhunë në të përsëri (u thuhet): Vuajeni dënimin me djegie!”** (sure “Haxh”, ajeti 22) Më pas u ndërrohen lëkurat ndryshe nga të parat.

Ebu Abdullah ka thënë: “Gjendja jote?”

Unë thashë: “Gjendja ime, gjendja ime.”¹

I dyti:

Në një hadith të imam Sadikut thuhet se Profeti ka thënë: “...Kam hyrë (natën e Mi’raxhit) në qiellin e kësaj bote dhe çdo melek që takoja ishte i qeshur dhe i gëzuar

¹ “Biharul Envar”; vëll. 8 f. 280.

derisa më takoi një melek nga melekët e Zotit, që nuk kisha parë ndonjëherë krijesë më të madhe. Kishte shikim të neveritshëm, zemërim i qartë dhe nuk ishte i qeshur e nuk kishte shenjë gëzimi sikurse melekët e tjerë që i pashë të qeshur. I thashë: “Kush është ky o Xhebrail sepse unë u frikësova nga ai?” Ai më tha: “Pranohet të frikësohesh nga ai sepse të gjithë ne frikësohemi nga ai. Ky është meleku i ruajtjes së zjarrit, nuk qesh asnjëherë, vazhdon t’i shtohet zemërimi që kur e ka krijuar All’llahu si shërbëtor në Xhehenem dhe i shtohet zemërimi si urrejtje ndaj armiqve dhe atyre që nuk i binden Zotit. Sikur të të qeshte do t’u qeshte dhe të tjerëve para dhe pas teje, por ai nuk qesh. I dhashë selam dhe ma ktheu selamin dhe më përgëzoi me Xhennet. I thashë Xhebrailit (i cili është në vendin që e ka përshkruar All’llahu): **“Që është i respektuar atje (në mesin e melekëve) dhe besnik.”** (sure “Tekvir”, ajeti 21). A nuk po e urdhëron që të më tregojë zjarrin? Xhebraili i tha: “O melek tregojë Muhammedit zjarrin.” Ai zbuloi një mburojë dhe hap një derë dhe doli nga aty një flakë zjarri që u hap në qiell dhe u ngrit aq shumë sa mendova se do na përpijë nga ajo që pashë dhe prandaj thashë: “O Xhebrail, thuaj që të kthejë mburojën atje ku ishte dhe e urdhëroi duke i thënë: “Kthehu dhe u kthye në vendin e vet atje ku ishte më parë nga ku doli.”¹

I treti:

Me një zinxhir transmetimi të pranueshëm është transmetuar nga imam Sadiku se ka thënë: “Nuk ka krijuar All’llahu asnjë krijesë që të mos i ketë përgatitur një shtëpi në Xhennet dhe një në Xhehenem. Ata të Xhennetit do të banojnë në Xhennet dhe të Xhehenemit në Xhehenem dhe thirrësi do thërrasë: “O banorët e Xhennetit kujdesuni dhe do të kujdesen nga banorët e zjarrit, të cilëve do t’u ngrihen banesat në zjarr dhe do t’u thuhet: “Këto janë banesat tuaja në zjarr. Nëse nuk i bindeni All’llahut do të hyni në to. Nëse dikush vdes i gëzuar do jetë banor i Xhennetit dhe në këtë ditë të gëzuar do të largohen nga ai dënimet. Përsëri thirrësi do thërrasë: “O banorët e zjarrit, ngrijini kokat tuaja dhe do të ngrejë kokat e veta ku do të shikojnë nga banesat e tyre në Xhennet dhe të mirat që ka në ato banesa. Pastaj u thuhet: Këto janë banesat tuaja, sikur ju t’ju bindeshit All’llahut të Madhëruar do të hynit në këto banesa. Nëse dikush vdes i hidhëruar do jetë banor i zjarrit, banorët e zjarrit do të jenë të hidhëruar. Kështu këta trashëgojnë banesat e njëri-tjetrit sikurse thotë All’llahu në Kur’an: **“Të tillë janë ata trashëgimtarët, të cilët e trashëgojnë Firdevsin dhe aty ata janë përgjithmonë.”** (sure “Mu’minun”, ajeti 10-11)²

I katërti:

Transmetohet nga imami se ka thënë:

“Një thirrës me urdhrin e All’llahut, pasi që banorët e Xhennetit kanë hyrë në Xhennet dhe banorët e Xhehenemit kanë hyrë në Xhehenem, thërret: “O Banorët e Xhennetit dhe të Xhehenemit a e njihni vdekjen me një shembull nga shembujt? Ata thonë: “Jo”.

E sjellin vdekjen në formën e një dashi laraman (bardhë e zi) dhe qëndron në mes të Xhennetit dhe Xhehenemit. Pastaj u thuhet të gjithëve: ‘Afrohuni dhe shikoni.’ Më pas, All’llahu urdhëron për therjen e tij. Më pas, u thuhet: “O banorët e Xhennetit do të jeni të përhershëm se nuk do ketë vdekje për ju, o banorët e Xhehenemit do të jeni të përhershëm se nuk ka vdekje për ju asnjëherë.” Këtë e vërteton fjala e All’llahut të Madhëruar ku thotë: **“Paralajmëroji ata (o Muhammed) për Ditën e Pikëllimit, kur do të japin llogari, ndonëse tani ata janë të shkujdesur dhe nuk besojnë.** (sure “Merjem”, ajeti 39)

¹ “Biharul Envar”; vëll. 8 f. 291.

² Tefsir “Nuru Thaklijin”; vëll. 3 f. 531-532.

Apo për banorët e Xhennetit që do të jenë të përhershëm dhe banorët e zjarrit që do të jenë aty përgjithmonë.¹

I pesti:

Nga prijësi i besimtarëve transmetohet se ka thënë: “Ata që nuk kanë qenë të bindur dhe kanë thyer urdhrat e All’llahut Fuqiplotë që do të jenë përgjithmonë në zjarr, do të jenë të lidhur fort nga këmbët dhe duart u janë lidhur për qafe, ndërsa trupat e tyre janë veshur me rroba prej katrani (zifti) që janë pjesë nga zjarri. Ata do të jenë në dënim të ashpër, zjarri i të cilit ka nxehtësi të madhe e të vazhdueshme. Në atë vend nuk hyn as era, nuk u largohet kurrë hidhërimi. Dënimi është gjithmonë i fortë, ndëshkimi është çdo herë i ri. Nuk është një banesë e paqëndrueshme që mbaron dhe as si jeta e një populli që kalon.”²

I gjashti:

Me një transmetim të pranueshëm nga imam Sadik (paqja qoftë mbi të!) thuhet se ai ka thënë: “Në Xhehenem ka një zjarr me të cilin dënohen banorët e tij. Ky është krijuar vetëm për mendjemëdhenjtë kokëfortë, për shejtanin e pabindur për çdo mendjemadh që mohon Ditën e Llogarisë dhe për të gjithë ata që janë armiq ndaj familjes së profetit Muhammedit. Dhe ka thënë: “Njeriu që do të ketë dënimin më të rëndë në Ditën e Kijametit do të jetë ai i mbuluar nga zjarri, do të ketë dy shapka nga zjarri si dhe dy lidhëse nga zjarri, me të cilën valon truri i tij njësoj siç valon uji në zjarr. Nuk shihet njeri tjetër të dënohet më ashpër në zjarr sesa ky dhe nuk ka në zjarr dënim më të madh sesa i këtij.”³

Ndodhitë e frikshme

Tregimi i parë

Djali i ri i shthurur që iu frikësua All’llahut të Madhëruar

Shejh Kulejni transmeton me një sened të pranueshëm nga imam Sexhadi (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: “Një burrë së bashku me familjen e tij kishin hipur në një anije në det dhe anija u mbyt. U mbytën të gjithë udhëtarët e anijes, me përjashtim të gruas së këtij burri. Ajo shpëtoi duke u kapur pas një dërrase të anijes deri sa arriti në një ishull. Në këtë ishull ishte një djalë kusar në rrugë dhe grabiste. Sa herë që takonte ndonjë grua ai e përdhunonte. Në ato çaste ai pa një grua dhe e pyeti: “A je nga njerëzit apo Xhindet?” Ajo iu përgjigj se jam nga njerëzit. E mori dhe gjatë gjithë rrugës nuk i foli deri sa arriti me të në vendin ku banonte me njerëzit e tij. Kur gruaja u shqetësua, ai e pyeti: Çfarë ke, pse je e frikësuar? Ajo iu përgjigj: “Frikësohem nga Ai dhe bëri me shenjë nga Qielli. Përsëri ai e pyeti: “A ke bërë diçka që frikësohesh nga Ai?” Ajo iu përgjigj: “Jo pasha Madhërinë e Tij.” Ai tha: “Ti, edhe pse nuk ke bërë diçka për të pasur frikë, i frikësohesh kaq shumë Atij, unë ndjej neveri për ty, sepse për All’llahun unë jam më primar për ta patur frikë Atë se sa ti.”

Transmetuesi thotë: Pa ndodhur asgjë mes tij dhe asaj, djali u ngrit dhe shkoi te njerëzit e tij, ku ai filloi të mos shqetësohej për gjë tjetër përveçse pendesës dhe kthimit në rrugën e drejtë. Një ditë kur ai ishte duke ecur u bashkua me të një murg. Dielli ishte i nxehtë. Murgu i tha djalit: “Lutju Zotit që të na dërgojë një re se na lodhi dielli.”

Djali i tha: “Nuk e di a kam te Zoti të mira, prandaj më vjen turp të kërkoj diçka nga Ai.

¹ “Biharul Envar”; vëll.8 f.346.

² Ka një ndryshim në mes të këtij teksti dhe asaj çfarë ka dashur të sjellë autori (Zoti e mëshiroftë!), por ajo çfarë ka vërtetuar këtu përputhet në përgjithësi me tefsirin e Kumiit; vëll. 2 f. 288-289 nga ku e ka marrë. “El Bihar”; vëll. 8 f. 292 dhe tefsijri “Nurul Thekulejn”; vëll 4 f. 614 me ndryshim të vogël.

³ “Biharul Envar”; vëll. 8 f. 295. Autori e ka përmendur këtë hadith të parin në komentimin e tij.

Ai i tha: “A të të lutem unë dhe ti të thuash *amin*?”

Djali tha: “Po.”

Murgu filloi të lutej dhe djali thoshte *amin*. Nuk zgjati shumë dhe u erdhi një hije reje që i mbuloi ata sa ecën nën të gjatë ditës derisa rrugët e tyre u ndanë. Kur u ndanë, reja i bënte hije djalit. Murgu, kur pa këtë gjë u kthye dhe i tha: “Ti je më i mirë se unë, të është pranuar lutja ty dhe jo mua, prandaj më trego se çfarë është historia jote?”

Djali i tregoi ndodhinë me gruan. Murgu i tha: “Të është falur çfarë ka kaluar, sepse të ka hyrë frika ndaj Zotit dhe shiko se çfarë të ndodh në të ardhmen.”¹

Tregimi i dytë

Behlul Nebashi

Shejh Suduku transmeton: “Një ditë Muadh ibn Xhebel ka shkuar te Profeti duke qarë. I hodhi selam dhe profeti ia ktheu. Pastaj profeti i ka thënë: “Çfarë të bën të qash kështu o Muadh?” Ai është përgjigjur: “O i Dërguari i All’llahut! Tek dera është një i ri me një trup të dobët, ngjyrë të varfëri, por me fytyrë të mirë që qanë për rininë e tij që i ka humbur shpresat dhe kërkon që të takohet me ty.” Profeti i tha: Fute brenda atë djalin dhe Muadhi ashtu vepro. Djali hyri brenda dhe e përshëndeti Profetin me selam dhe e mori selamin. Profeti e pyeti: “Përse qan?” Ai iu përgjigj: “E si të mos qaj kur jam ngarkuar me gjynahe. Sikur All’llahu i Madhëruar të më gjykojë vetëm për disa nga ato, do të më dënojë duke më futur në zjarrin e Xhehenemit dhe nuk do të më falë asnjëherë.” Profeti i tha: “A i ke bërë shok All’llahut në adhurim?” Ai tha: “Kërkoj mbrojtje nga Zoti që të mos i bëj shok Atij. (d.m.th jo) Profeti i tha: “A ke vrarë njeri, gjë që është e ndaluar rreptësisht nga All’llahu?”

Ai tha: “Jo” Atëherë Profeti i ka thënë: “All’llahu Fuqiptotë t’i fal gabimet tuaja qofshin dhe sa malet e larta.” Djali tha: “Por, ato janë më të mëdha se malet e larta.”

Profeti i tha: “All’llahu t’i fal gabimet qofshin më të mëdha se shtatë tokat, se detrat dhe rëra e tyre, pemët dhe çfarë ka mbi tokë nga krijesat.”

Djali tha: “Gabimet e mia janë më të mëdha se shtatë tokat dhe detrat e rëra e tyre, pemët dhe çfarë ka mbi të nga krijesat.”

Profeti i tha: “All’llahu t’i fal gabimet e tuaja qofshin ato edhe më të rënda se qiejt dhe yjet dhe se Arshi dhe Froni i All’llahut.”

Djali tha: “Gabimet e mia janë më të mëdha se kaq.”

Profeti e vështroi me syrin e një të zemëruari dhe i tha: “O djalë, gabimet tuaja janë më të mëdha se Zoti yt?” Djali me një fytyrë prekëse tha: “Madhërimi është për Zotin, s’ka gjë më të madhe se Zoti im. Zoti im është më i Madhi, o i Dërguari i All’llahut.”

Profeti i tha: “A i fal gabimet e mëdha tjetërkush përveç Zotit të Madhëruar?”

Djali tha: “Jo, për All’llahun o i Dërguari i Tij.”

Kështu, djali heshti deri sa Profeti iu drejtua dhe i tha: “A nuk po më tregon mua një nga gabimet e tua?” Ai i tha: “Po do të të tregoj dhe filloi: “Unë për shtatë vjet grabisja në varreza, ku pasi varroseshin i nxirrja dhe ua merrja qefinat. Një ditë vdiq një komshije e disa vajzave të Ensarëve. E varrosën dhe pastaj të afërmit e saj u larguan. Sapo erdhi nata unë shkova tek varri i saj. E hapa varrin dhe e nxora trupin e saj nga varri. Ia hoqa qefinin dhe e lashë të zhveshur buzë varrit të saj dhe fillova të largohem. Më erdhi shejtani i mallkuar dhe filloi të më përpëlente dhe më thoshte: “A nuk e shikon barkun dhe trupin e saj të bardhë dhe kofshët e saj a nuk i shikon? Vazhdoi të më thoshte këto fjalë derisa u ktheva tek varri i saj ku nuk e përmbajta veten dhe e përdora atë sikurse përdoret një femër (mardhënie intime) dhe pastaj e lashë në varrin e saj. Duke u larguar pas meje dëgjoj një zë që thoshte: “I mjeri ti o djalë për vendin tënd në Ditën e Gjykimit.

¹ “Usulul Kafi”; vëll. 2 Frika dhe shpresa, hadithi 8, me ndryshim të vogël.

Do të qëndrojmë së bashku të zhveshur sikurse më le mua të zhveshur në mesin e varrezave kur më nxorre nga varri im, më hoqe qefinin e më bëre atë që doje dhe më le të papastër deri në Ditën e Llogarisë. Mjerë rinia jote nga zjarri. Prandaj, tha djali, nuk mendoj se do të shijoj erën e Xhennetit. Çfarë duhet të bëj unë o i Dërguari i All'llahut?" Profeti i tha: "Largohu nga unë o i shturur, kam frikë se mos digjem nga zjarri yt sepse, nuk ka gjë më të afërt me ty se sa zjarri.

Vazhdoi duke e qortuar derisa u largua dhe i veshur me një rrobë të vjetër doli nga qyteti dhe shkoi në mal ku kërkoj falje me lutje. Duke shtrënguar fytyrën e tij duar thoshte: "O Zot ky është Behluli, robi Yt, të është dorëzuar Ty dhe Mëshirës Tënde sepse është i pafuqishëm. O Zot, Ti je Ai që më njeh mua me njohjen Tënde. O Zot, jam bërë gjynahqar dhe shkova te i Dërguari Yt i penduar dhe ai më përzuri dhe më shtoi mua frikën. Ty të lutem me Emrat e Tuaj të Mëdhenj dhe me Fuqinë Tënde që të mos e humb shpresën. O Zot mos ma kthe lutjen time dhe mos më largo nga Mëshira Jote." Këto fjalë ai vazhdoi t'i thoshte për dyzet ditë dhe netë duke qarë. Kur u plotësuan dyzet ditët dhe netët ai ngriti duart nga qielli dhe tha: "O Zot çfarë bëre me hallin tim?" Nëse e pranove lutjen time dhe më ke falur gabimet e mia, zbuloj këtë tek i Dërguari Yt. Nëse nuk i je përgjigjur lutjes time dhe nuk m'i ke falur gabimet e mia, më përshpejto për në zjarr që të më djegë mua, ose më jep dënim në këtë botë që të më shkatërrojë dhe të më shpëtojë nga turpi në Ditën e Kijametit."

Me këtë rast, All'llahu zbriti tek i Dërguari i Tij këto ajete, ku thotë: **"Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme,"** që ka për qëllim imoralitetin **"ose i bëjnë dëm vetes,"** duke bërë gabime apo gjynahe të mëdha sikurse është dhe imoraliteti, zhvarrosja e të vdekurve dhe marrja e qefinit etj. **"e kujtojnë All'llahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre"** dhe thotë: Kijeni frikë All'llahun dhe shpejtoni në pendim – **"e kush i fal gjynahet përveç All'llahut?"** All'llahu thotë: Të ka ardhur robi Im o Muhammed i penduar dhe e ke përzënë, por, nga do të shkojë ai dhe ku do të përballet? Kujt do t'i lutet dhe kujt t'i kërkojë falje përveç Meje. Më pas thotë All'llahu: **"dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë."** Thotë: Nuk bëjnë imoralitet dhe zhvarrosin dhe marrin qefinet. **"Pra, për këta do të ketë si shpërblim falje madhështore (të gjynaheve) nga ana e Zotit të tyre dhe kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Sa shpërblim i bukur është ky për ata që punojnë (vepra të bukura)!"** (sure "Ali Imran", ajetet 135-136)

Kur i ka zbritur ky ajet Profetit, ai ka dalë duke e lexuar dhe duke buzëqeshur u ka thënë shokëve të tij: "Kush më tregon se ku është ai djali i ri i penduar?"

Muadhi i ka thënë: "O i Dërguari i All'llahut, jemi njoftuar se ai është në filan vend." Profeti, së bashku me shokët e tij mori rrugën për tek ai mal dhe u ngjitën për të kërkuar djalin derisa e gjetën. Ai me duart e tij kishte kapur qafën dhe po qëndronte në këmbë mes të dy kodrave. I ishte nxirë fytyra dhe shterruar faqet nga të qarët dhe thoshte: "O Zoti im, e ke përsosur krijimin tim dhe fytyrën time, por mjerë ndjenjat se ku do të përfundojnë? A në zjarr do të më djegësh mua? A pranë Teje do më lejosh të banoj? O Zoti im, me të vërtetë, të mirat Tuaja janë të shumta për mua, por i mjeri unë se ku do të përfundoj në fundin tim? A për në Xhennet do të më dërgosh apo për në zjarr do më drejtosh? O Zoti im, gabimet e mia janë më të mëdha se qiejt dhe toka, Arshi dhe froni Yt i Madhërueshëm. Mjerë vetja ime! A do të më falësh mua apo do të turpërohem me këto gabime Ditën e Kijametit?"

Ai vazhdonte të thoshte këto fjalë dhe qante aq shumë sa që e dëgjuan disa zogj dhe po qanin prej të qarës së tij."

I Dërguari i All'llahut e thirri. Ia hoqi duart nga qafa dhe ia pastroi dheun që kishte në kokë duke i thënë: "O Behlul, gëzohu se Zoti yt të ka larguar nga zjarri. Pastaj Profeti u

tha shokëve të tij: “Kështu fshihen gjynahet sikurse i fshiu Behluli dhe pastaj i lexoi atij çfarë i kishte zbritur All’llahu nga Kur’ani dhe e përgëzoi atë me Xhennet.”¹

Autori thotë

Autori i librit “Ajnul Hajat” ka folur përreth këtij hadithi dhe përmbledhja e tij është: “Duhet të dimë se për pendesën ka disa kushte dhe motive:

Motivi i parë që e dërgon njeriun te pendesa është mendimi dhe hulumtimi në Madhërinë e All’llahut, të Cilit nuk i është bindur, në peshën e madhe të gabimeve dhe gjynaheve që ka bërë dhe në dënimet dhe përfundimet e këqija që do të ketë në këtë botë dhe në Botën Tjetër, të cilat janë përmendur në ajete dhe hadithe. Ky meditim të çon në keqardhje dhe kjo keqardhje e motivon njeriun në tri gjëra që përbëjnë apo përmbushin pendesën (Tevben):

E para: Lidhet me gjendjen e tij konkrete dhe të lënit e këtyre gabimeve që ka bërë deri tani.

E dyta: Lidhet me të ardhmen, ku njeriu t’i vërë qëllim të qartë vetes së tij dhe të mos kthehet përsëri në këto gabime në të ardhmen e deri në fund të jetës së tij.

E treta: Lidhet me të kaluarën ku ai të ndiejë keqardhje për të kaluarën e tij dhe ta ndreqë atë.

Duhet të dimë se gjynahet për të cilat kërkohet pendesë ndahen në disa pjesë:

E para: Gjynahu që nuk është i lidhur me një gjykim tjetër përveç dënimit në Botën Tjetër si veshja e mëndafshit dhe unaza e arit për burrat, për të cilat në pendesë është e mjaftueshme keqardhja dhe vënia qëllim vetes për të mos u kthyer përsëri tek ajo gjë. Kjo mjafton që të bjerë dënimi dhe i Botës Tjetër.

E dyta: Të jetë i lidhur me një gjykim tjetër dhe ai është i ndarë në disa pjesë: ose të jetë e drejta ndaj Zotit ose e drejta ndaj njerëzve.

Nëse është e lidhur me të drejtën ndaj Zotit, mund të jetë material ku ndokush që ka bërë një gabim duhet që të paguajë. Nëse ka mundësi për këtë dhe nuk e bën atëherë dënimi nuk do t’i fshihet derisa nuk ndien keqardhje, dhe gjithashtu, duhet të shlyejë këtë detyrim.

Detyrimi mund të jetë jomaterial, shpirtëror si p.sh. mosagjërimi i Ramazanit, lënia e namazit, etj. Ai duhet pajtëtar që ta shlyejë këtë detyrim.

Nëse dikush e bën diçka për të cilën ka caktuar dënim, si pirja e alkoolit, nëse nuk është vërtetuar para gjykatësit fetar se ai ka pirë alkool atëherë, ai mund të zgjedhë që të pendohet në mes tij dhe All’llahut pa e shfaqur gabimin apo gjynahin e tij, sikurse mund t’i drejtohet gjykatësit fetar dhe t’i caktojë atij kufirin, por mosshfaqja e gabimit është më mirë.

Në të drejtën e njeriut, nëse është e drejtë materiale, ai është i detyruar që t’ia kthejë atë vetë personit ose trashëgimtarit të tij.

Nëse është e drejtë jomateriale, pra shpirtërore, në qoftëse e ka humbur një njeri në rrugë të gabuar atëherë duhet që ta drejtojë atë.

Gjithashtu, nëse kjo e drejtë jomateriale, si p.sh., dikush është i ashpër me fjalët e tij ndaj dikujt tjetër dhe nëse personi i dytë është në dijeni se ai e ka ofenduar, atëherë ai është i detyruar që t’i tregojë të vërtetën, e nëse ai nuk është në dijeni të kësaj ashpërsie në të folur për të, ka ndryshime në mendimet e dijetarëve ku shumica e tyre mendojnë se nëse ai i tregon atëherë do të ketë revoltim dhe armiqësi mes tyre, prandaj, nuk duhet t’i tregojë. E njëjta gjë është edhe kur dikush merr ndonjë njeri për përgojim.

Tregimi i tretë

¹ “Buharul Envar” Vëll. 6 fq. 23-26

Te ekspozuarit në vapë për të kujtuar Xhehenemin

Transmetohet se shejh Suduku (Zoti e mëshiroftë!) ka treguar se: “Një ditë Profeti po qëndronte nën hijen e një peme nga që ishte vapë shumë e madhe. Tek ai erdhi një burrë, i cili hoqi rrobat e tij dhe filloi të rrotullohej në mes të vapës ku tregonte herë shpinë nga dielli herë barkun dhe herë ballin e tij dhe thoshte: “O vetja ime shijojë. S’ka gjë më të madhe para All’llahut se ajo që kam bërë me ty.”

Profeti shikonte veprimet e tij.

Më pas burri veshi rrobat e tij dhe u drejtua nga Profeti, i cili e përshëndeti dhe ia bëri me dorë që të ulet. Pastaj i tha: “O robi i Zotit, të shikova se çfarë po bëje më parë dhe nuk e kam parë këtë ta bënte dikush tjetër nga njerëzit. Çfarë të shtyu që ta bëje një gjë të tillë?”

Burri i tha: “Për të bërë këtë më nxiti frika nga All’llahu të Madhëruar dhe i thashë vetes time shijojë s’ka gjë më të madhe para All’llahut se ajo që kam bërë me ty.”

Profeti i tha: “E paske frikë All’llahun ashtu siç duhet. Zoti yt do krenohet me ty para banorëve të qiellit.”

Pastaj u tha shokëve të tij: “O ju të pranishëm, qëndroni afër këtij shokut tuaj që të lutet për ju. Ata u afruan dhe ai filloi të lutej për ta duke thënë: “O Zot njësoi çështjet tona në të drejtë, bëj që devotshmëria të na rritet dhe Xhenneti të jetë përfundimi ynë.”¹

Tregimi i katërt

Imoraliteti dhe djali i devotshëm

Tregohet se imam Bakir (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Një ditë, një grua imorale u drejtua për tek të rinjtë e bijve të Izraelit që t’i provokonte me bukurinë e saj. Disa nga ata thanë: “Sikur ta shikonte filani do të dorëzohej para saj.”

Ajo i dëgjoi fjalët e tyre dhe tha: Për Zotin nuk do të shkoj në shtëpinë time derisa ta bëj të më dorëzohet.”

Iu drejtua shtëpisë së tij dhe trokiti në derë. I tha atij djalit se dua ta kaloj natën tek ti, por djali nuk pranoi.

Atëherë ajo i tha: “Disa nga të rinjtë e bijve të Izraelit po më ndjekin nga pas për të më përdorur por nëse më lejon të futem brenda do të shpëtoj, në të kundërt ata do të më arrijnë dhe do të më turpërojnë.” Kur djali dëgjoi fjalët e saj ia hapi derën.

Sapo hyri brenda ajo hoqi rrobat e saj dhe i hodhi tutje. Djali, kur pa bukurinë e saj u çorodit. E goditi me dorën e tij dhe u kujtua se në zjarr kishte lënë një enë. U afrua derisa vendosi dorën e tij në zjarr: Ajo i tha djalit të devotshëm: “Çfarë bën?”

Ai u përgjigj duke thënë: “Po e djeg sepse ajo bëri çfarë bëri...”

Gruaja doli dhe shkoi tek grupi i të rinjve të Beni Israilëve dhe u tha: Shkoni shpejt te filani sepse ka vendosur dorën e tij në zjarr. Kur shkuan tek ai, panë se me të vërtetë dora e tij ishte djegur.”²

Tregimi i pestë

Mirësitë e prijësit të besimtarëve

Shejh Suduku trasmeton nga Urvetu bin Zubejri se ka ai thënë: “Ishim të mbledhur në xhaminë e Profetit (paqja dhe bekimi i All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe kujtuam momente dhe akte nga pjesëmarrësit e luftës së Bedrit dhe të marrëveshjes së Ridvanit kur Ebu Dardai tha: “O njerëz a t’ju tregoj juve për njeriun që ka më pak pasuri, më shumë devotshmëri dhe më shumë angazhim në adhurim?”

¹ “Biharul Envar”; kap.70, f. 378.

² “Buharul Envar”; kap. 70, f. 387.

Të gjithë i thanë: “Kush është ai?”

Ai u tha: “Prijësi i besimtarëve Ali bin Ebi Talibi (paqja qoftë mbi të).

Transmetuesi thotë: “Për All’llahun nuk kishte njeri në mbledhje që nuk ishte drejtuar me fytyrën e tij nga ai.”

Më pas iu drejtua një burrë nga ensarët dhe i tha: “O prijës, ke thënë fjalë të cilat nuk i ka besuar asnjë deri sa i ke thënë ti.”

Ebu Dardai ka thënë: “O popull unë them atë çfarë kam parë dhe le të thotë çdo njëri nga ju atë që ka parë. E kam parë Ali bin Ebi Talibin duke punuar si marangoz dhe në kopshtin me hurma. Ai nuk e kishte parë që prej kohësh Aliun. Thashë me vete: “Do ta gjesh te shtëpia e tij”. Kur arrita dëgjova një zë të pikëlluar dhe tingull të qetë që thoshte: “Zoti im, sa të këqija kam mbartur me vete që do të përballen me indinjatën Tënde, sa gabime kam bërë dhe m’i ke mbuluar falë Bujarisë Tënde. Zoti im, sikur jeta ime të zgjatet në gjynahet ndaj Teje dhe në librin tim të ketë shumë gabime, sa që nuk do të mund t’i mbartja, unë shpresoj vetëm në faljen dhe mëshirën Tënde dhe nuk kërkoj vetëm se kënaqësinë Tënde.”

Më bëri përshtypje zëri dhe u mundova ta gjeja se nga vinte dhe ja, ishte vetë Ali bin Ebi Talib. Iu fsheha dhe ndalova lëvizjen. Ai filloi të falej në mesin e natës së errët dhe më pas filloi të lutet, me qarje, hidhërim dhe keqardhje. Nga ajo që më mundësoi All’llahu të mbaj mend nga lutjet e tij është: “Zoti im, mendohem në faljen Tënde për gabimet e mia, pastaj kujtoj Madhësitinë kur do më marrësh, madhëroje Aliun me mjerimin e tij.”

Pastaj ka thënë: “Mjerë unë kur të lexoj në libër të këqijat që i kam harruar dhe Ti i ke shënuar dhe do të thuash: “Merreni.” Sa e vështirë që është ajo marrje prej së cilës nuk të shpëtojnë as të afërmit e tij dhe nuk sjell dobi as familja...”

Pastaj tha: “Oh, nga zjarri që do të djegë mushkëritë dhe veshkat, oh, nga zjarri që do të djegë mishin, Oh, nga vështirësia e zjarrit përvëlues.

Transmetuesi thotë: “Më pas, ai ra në gjendje të fikëti (të lehtë) nga të qarët sa nuk lëvizte. Thashë me vete: “E zuri gjumi nga të ndenjurit zgjuar gjithë natës dhe do ta zgjoj në namazin e sabahut”.

Ebu Dardai thotë: “Iu afrova por ai ishte si një dru i ngrirë. U mundova ta lëviz, por nuk lëvizte, e shkunda pak por nuk shkundej dhe më pas thashë: “Të Zotit jemi dhe tek Ai do të kthehem.” Vdiq Ali bin Ebi Talibi.

Shkova tek shtëpia e tij që t’u tregoj dhe Fatimeja më tha: “O Darda si ka qenë puna e tij dhe si ka ndodhur.” Kur unë e lajmërova me çfarë kishte ndodhur, ajo tha: “O Ebu Darda kjo është vdekje që të vjen nga të pasurit frikë All’llahun e Madhëruar. Më pas, morën pak ujë dhe e lagën derisa u zgjua. Ai më shikoi mua që po qaja dhe më pyeti: “Pse po qan o Ebu Darda?”

I thashë: “Po qaja për atë që i bëje ti vetes tënde.”

Ai tha: “O Ebu Darda si mos të bëja ashtu. Sikur të më kishe parë mua dhe gjendjen time në llogari në mes të banorëve që bëjnë krime dhe do dënohen, në mes të melekëve të egërsuar dhe rojeve të Xhehenemit. Isha në duart e një meleku të madh dhe të egër. Më përshëndetën të dashurit e mi dhe më mëshiruan banorët e kësaj bote, ishte mëshira më e madhe për mua nga ata që kanë frikë nga e fshehta.”

Ebu Dardai tha: “Betohem në Zotin se nuk kam parë diçka të tillë tek asnjë nga shokët e Profetit.”¹

Është e dobishme të përmendet i plotë përgjërimi që të lexohet në namazin e natës, sikurse e ka përmendur edhe shejhu ynë El Behai në librin e tij “Miftahul Felah.”

“Zoti im, sa të këqija kam mbartur me vete që do të përballen me indinjatën Tënde, sa gabime kam bërë dhe m’i ke mbuluar falë Bujarisë Tënde. Zoti im, sikur jeta ime të zgjatet në gjynahet ndaj Teje dhe në librin tim të ketë shumë gabime, sa që nuk do të

¹ “Biharul Envar”; kap.41, f. 11-12.

mund t'i mbartja, unë shpresoj vetëm në faljen dhe mëshirën Tënde dhe nuk kam kërkoj vetëm se kënaqësinë Tënde.” Zoti im mendohej në faljen Tënde për gabimet e mia, pastaj kujtoj Madhësitinë kur do më marrësh, madhëroje Aliun me mjerimin e tij. “Mjerë unë, kur të lexoj në libër të këqijat që i kam harruar dhe Ti i ke shënuar dhe do të thuash: “Merreni.” Sa e vështirë që është ajo marrje prej së cilës nuk të shpëtojnë as të afërmit e tij dhe nuk sjell dobi as familja...”. “Oh, nga zjarri që do të djegë mushkëritë dhe veshkat, oh, nga zjarri që do të djegë mishin, oh, nga vështirësia e zjarrit përvëlues.”

Tregimi i gjashtë

Shoku i Profetit, Harithetu bin Malik

Transmetohet nga imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: Një herë kur Profeti fali namazin e sabahut me xhemat, në xhami pa një djalë i cili po rrotullonte kokën e tij, i zverdhur në fytyrë, me trup të dobët dhe sytë e tij ishin të futur thellë. Profeti iu drejtua dhe i tha: “Si u gdhive...”

Ai tha: “Jam gdhirë i bindur o i Dërguari i All'llahut”

Profeti u habit nga fjala e tij dhe i tha: “Çdo bindje ka një të vërtetë; kush është e vërteta e bindjes tënde?”

Ai i tha: “O i Dërguari i All'llahut, bindja ime është nga hidhërimi dhe ajo që më ka lënë gjithë natës zgjuar dhe më ka errësuar atë që shikoja. E shkëputa veten time nga kjo botë dhe çfarë ka në të derisa mu duk sikur po shikoja Arshin e Zotit tim dhe më dërguan për llogari. U mblodhën të gjitha krijesat e Zotit ku dhe unë isha në mesin e tyre dhe sikur shikoja banorët e Xhennetit që shijonin Xhennetin dhe kënaqeshin në fronet e tyre të qëndrueshme. Sikur shikoja, gjithashtu, banorët e zjarrit në të cilin po dënoheshin pa mëshirë dhe sikur po dëgoja oshëtimën e zjarrit që po më vriste në veshë”.

Profeti u tha shokëve të tij: “Këtij njeriu ia ka ndriçuar All'llahu zemrën me besim.”

Më pas, tha: “Përkushtohu dhe mbaje atë që ke.”

Djali i tha: O i Dërguari i All'llahut, lute Zotin që të më bëjë dëshmor me ty.”

Profeti e luti Zotin për të dhe nuk kaloi shumë ai doli në disa luftra së bashku me Profetin ku u vranë nëntë veta dhe i dhjeti ishte ky i ri.”¹

Shembujt që edukojnë besimtarët

Shembulli i parë

Dynjaja

Bloher thotë²: “Na u tregua se një burrë e kishte sulmuar një elefant i tërbuar dhe ai kishte ikur me vrap, por elefanti e kishte ndjekur sa desh e kishte arritur dhe e detyroi burrin që të futej në një pus dhe të varet në dy degët e dy pemëve që ishin në anë të pusit. Këmbët i ranë mbi kokat e gjarpërinjve. Kur hodhi vështrimin nga dy degët, pa dy minj të varur në to ku njëri është i bardhë dhe tjetri i zi, të cilët po hanin degët. Kur shikoj në brendësi të pusit pa një dragua që ishte drejtuar drejt tij dhe donte ta hante. Kur ngriti kokën e tij më lart degëve shikoj se kishte mjaltë blete ku provoi pak nga ai. Ëmbëlsia e mjaltit e bëri të harronte të pickuarat e gjarpërinjve dhe dragoin. Ai nuk e dinte se ku do të përfundonte po të binte në gojën e tij.

Pusi është dynjaja (Bota) e mbushur me vështirësi, sprova dhe të këqija, ndërsa degët janë jeta. Dy minjtë janë nata dhe dita që shpejtojnë fundin. Ndërsa katër gjarpërinjtë janë

¹ “El Kafi”; Libri “Besimi dhe Mohimi”, kap. “Vërtetësia e besimit”.

² Bloher është një mjek indian që ka një histori të gjatë me një nga djemtë e mbretit të Indisë që quhej Judhasef. Kjo histori përmban shembuj dhe gjykime shumë të dobishme, të cilat transmetohen nga imam Askeriju sikurse dhe tek libri “Biharul Envar”; pjesa 78 f. 383-444, marrë nga “Kemalud Din” dhe “Temamu Ni’ meti” të shejh Sudukut (Zoti e mëshiroftë!).

katër pjesët e trupit nga të cilat vjen dhe helmi vdekjeprurës, nga tëmthi, gëlbaza, erërat dhe gjaku ku nuk e di njeriu se kur do të përballet me to.

Dragoi është vdekja sikur përgjuesi kërkues. Ndërsa mjalti që ai provoi, është shijimi i dynjasë dhe mirësitë e saj që nga ushqimet, pijet, shijimet, prekjet, dëgjimet dhe shikimet.

Autori thotë:

Nuk mund të gjendet një shembull më i mirë që t'i përshtatet më së miri mosnjohjes së njeriut për vdekjen dhe çfarë ndodh pas saj. Duhet ta kuptojmë siç duhet këtë shembull që të jetë shkak për zgjimin nga gjumi i mosnjohjes.

Në një hadith thuhet se prijësi i besimtarëve ka hyrë në tregun e Basras ku shikoi njerëzit që blinin dhe shisnin. A qau shumë pastaj ka thënë: “O robtë e kësaj bote dhe punëtorë të saj, ditën vetëm betoheni dhe natën në shtretërit tuaj flini, gjatë kësaj kohe për Botën Tjetër jeni të pavetëdijshëm. Kur do të përgatiteni dhe do të mendoni për takimin e fundit.”¹

Autori thotë:

E pashë të arsyeshme që të sjell këtu disa thënie:

“O harxhues i jetës në pavetëdije. Çfarë ke me vete, çfarë ke bërë dhe ku është puna jote.

“Çfarë është ai?”

“Çfarë ke përgatitur për Botën Tjetër dhe për këtë rrugë të gjatë, ndërkohë që të ka ardhur pleqëria me letren e vdekjes?”

“Mund të bëheshe melek me dije dhe me punë, por ty të pengoi kjo dynja dhe u bashkove me kafshët e egra dhe të buta.”

“Kur të bëhesh banor i shoqëruar nga hyritë e Xhennetit do ta kuptosh se të gjithë ata zemrat të cilët janë të lidhura me ujin dhe bimët, janë si kafshët.”

“Mundohu që të mos e kesh të ndaluar lumturinë. Përmirësoje gjendjen tënde, sepse nuk do të qëndrosh këtu më shumë se dy apo tri ditë.”

Shejh Nidhamiju thotë:

“Lëre mënjane bisedën për fëmijërinë tënde dhe vetëpëlqimin, sepse ajo është bisedë e dembelizmit dhe dehjes.”

“Kur të arrijë mosha tridhjetë por dhe njëzetë, nuk duhet të jetosh si i pavemendshëm dhe mosnjohës.”

“Ngelet të punosh me zell deri në të dyzetat dhe me kalimin e të dyzetave të bien puplat dhe krahët.”

“Pas kalimit të pesëdhjetave nuk ngelet diçka e shëndoshë në trupin tënd, shikimi është i dobët dhe këmbët të pafuqishme.”

“Me arritjen e të gjashtëdhjetave do të dukesh sikur je i ulur. Me arritjen e të shtatëdhjetave dobësohet mekanizmi i trupit gjatë punës së tij.”

”Ndërsa kur të arrish tetëdhjetë apo nëntëdhjetë do të kalosh vështirësitë më të mëdha në jetë.”

“Dhe, nëse do arrish t'i kalosh këto në drejtim të të njëqindtave kjo është vdekja por në fytyrën e dynjasë.”

“Qeni i gjuetisë i cili ndjek drerin, kur të jetë plakur dreri e ndjek atë.”

“Kur thinjë mbulojnë flokët e zinj, janë shfaqur shenjat e dëshpërimit.”

“Nga qimet e shumta do të duket veshi si të ishte i veshur me qefin dhe do të vazhdosh të mos i heqësh qimet nga veshët tuaj.”

Dikush tjetër ka thënë:

“Si rezultat i rrotullimit të këtij universi të kaltërt kaluan nga jeta ime gjashtëdhjetë vite.”

“Në fillim të çdo viti të kësaj jete gëlltita të shijshmet e të kaluarës.”

“Unë çuditëm nga rrotullimi i jetës. Sa herë më është dhënë mua, unë e kam refuzuar atë.”

¹ “Biharul Envar”; kap 77, f. 422-423.

“Shterroi forca nga gjunjët e lart, sikurse shterroi uji nga fytyra ime dhe ngjyra e flokëve të mi.”

“U shkëput varësja dhe dhëmbët e mi më ranë një nga një.”

“Nuk ngeli asgjë nga kjo dhe ajo që nuk u përmend përveç mbartjes së gabimit dhe mbajtjes së shpresës.”

“Bie dhe sinjali i nisjes duke të treguar, ja ku i ke ata shoqëruesit e udhëtimit që po kalojnë.”

“Oh nga furnizimi i pakët për ditën e takimit, ai është i pakët dhe rruga është e gjatë.”

“Pesha është e rëndë mbi supet e mia sikur mali, madje edhe mali nuk është i aftë të mbajë peshën time.”

“Si është gabimi para faljes së madhe sikur bimët përballë përmytjeve të pranverës.”

“Dhe, nuk do të përfundonte rruga ime vetëm se për në Xhehenem dhe se nuk do të jetë në vend tjetër qëndrimi im veçse në greminë.”

“Unë jam robi i turpëruar i paditur, unë jam i mbyturi në rrugën e gjynaheve.”

“Ti je Krijuesi, Dhënësi dhe Mirësuesi. Ti je i Vetmi që e ringjall të varfërin me falje.”

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Moshat dyzet vjeçare korrin atë që kanë mbjellë. Po ju të të pesëdhjetëve çfarë keni punuar? Çfarë keni parapërgatitur? Moshë gjashtëdhjetë vjeçare e jani në llogari ndërsa moshë shtatëdhjetë numëroni vetat tuaja me të vdekurit.”

Në një hadith thuhet se gjeli në këngën e tij thotë: “Kujtojeni All’llahun o ju të pavëmendshëm.”¹ “A e di përse këndon gjeli gjithmonë sa fillon të zbardhë dita.”

“Ai thotë se ligji i mëngjezit të thotë ty: “Kaloi një natë nga jeta jote dhe ti je i pavëmendshëm.”

Shejh El Xhami thotë, gjithashtu:

“O zemër, luaj me këtë kështjellë joreale sikurse luajnë fëmijët me lojra dhe me dheun.”

“Ti je zog shtegtar; të përshtatet një fole larg nga kjo tokë.”

“Përse je kaq i huaj nga kjo jetë dhe përse je bërë si më i keqi nga të gjithë zogjtë e kësaj bote të shkatërruar.”

“Shkundi krahët dhe puplat e tua nga dheu që të ka ngelur dhe fluturo larg nga kjo botë e vogël për tek galaktika e madhe.”

“Shko si i dashur në mbretërinë e bindjes duke përsëritur thënien: “Nuk i dua ata që perëndojnë.”

Shembulli i dytë

Pasuria

Bluvher ka thënë:

Banorët e një qyteti sillnin një burrë të panjohur që nuk ishte në dijeni për çështjet e tyre dhe e vendosnin si të parë një vit dhe nuk dyshonte se pushteti i tij ishte i përhershëm për ta falë mosnjohjes së tij me popullin. Kur kalonte një vit e nxirrnin nga qyteti të zhveshur apo të veshur. Atë e godiste halli dhe fatkeqësia. I kaloi ajo çfarë kishte nga pushteti me hidhërim dhe fatkeqësi ku i përshtatet fjalës së poetit që thotë:

“O ti që je dehur nga dashuria e kësaj bote, zgjohu se agimi po të lë.”

“Mos u zhyt në këtë botë se është e mbushur me tradhti, sepse nuk të ngelet në dorën tënde përveçse dy apo tri ditëve.”

Më pas, banorët e atij qyteti morën një burrë tjetër dhe e sollën përsëri në pushtet.

Kur e pa burri që ai ishte i huaj në mesin e tyre nuk e diskutoi me ata por kërkoi një burrë nga vendi i tij që ishte i zgjuar t’i tregonte për këtë çështje. E gjeti një njeri të tillë i cili i premtoi për mbajtjen e sekretit para popullit të tij. Ai i tha që të nxirrte pasuri nga

¹ Teksti është me nënkuptim.

ajo që kishte në dorë sa të kishte mundësi pak nga pak dhe ta linte këtë pasuri tek vendi që ata do ta nxirrnin nga qyteti. Nëse populli do ta nxirrte, ai do të kishte pasuri të mjaftueshme nga ajo që nxori. Ai e përcolli burrin, bëri ashtu sikurse i tha dhe nuk e harroi porosinë e tij.

Bluvheri thotë: “Unë shpresoj o djalë i Mbretit që ai burrë të jetë nga ata që nuk shoqërohet me të huajt dhe nuk e mashtron pushteti. Unë jam ai burri që kërkove dhe tek unë ke argumenta, njohje dhe ndihmë.”¹

Autori thotë: All’llahu i Madhëruar në Kur’anin Famëlartë thotë: **“Kush punon vepra të mira, vetat e tyre lehtëson”**. Pra, ata që punojnë vepra të mira, u lehtësojnë rrugën vetave të tyre.

Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) thotë: “Puna e besimtarit shkon dhe i parapërgatit atij Xhennetin, sikurse njeriu dërgon shërbyesin e tij për t’i përgatitur vendfjetjen. Më pas ka lexuar ajetin e lartpërmendur.

Prijësi i besimtarëve në disa fjalë të shkurtra të tij ka thënë: “O biri i Ademit, bëhu këshilltar i vetes dhe vepro me pasurinë tënde ashtu siç shpreson që të veprohet në të pas teje.”

O i dashur: “Dërgo mjetet e lehtësimi tek varri yt, të cilat nuk do t’i dërgojë kush pas vdekjes tënde.”

“Ushqehu, pi dhe shpenzo e parapërgatit për veten tënde sepse nuk e ke të siguruar atë që ke.”

”Shpenzoje (jepe për të mirë) arin dhe mirësinë tani, sepse pas teje ajo nuk do të jetë në dorën tënde dhe urdhri e ndalimi për atë mirësi do të jetë i dikujt tjetër.”

“Merr furnizimin me vete dhe mbaje vetë atë. As gruaja e as djali nuk do të të bëjnë dobi.”

“Kushtoji rëndësi vetes tënde në këtë botë, sepse lakmia nuk e lë të afërmin tënd që të të kushtojë rëndësi.”

“Përmirëso veten tënde me dorën tënde, sepse asgjë nuk ta kruan lëkurën më mirë se thoi yt.”

Profeti ka thënë: “Dijeni se çdo njeri që ka punë të mira do t’i shohë dhe ai që nuk ka punë të mira do të pendohet.”

Është përcjellë nga Amalij el Mufijid Neshaburiji dhe nga historia e Bagdatit se prijësi i besimtarëve kur e ka parë Hidrin në gjumë ka kërkuar nga ai që ta këshillojë dhe kur ka parë krahun e tij ka gjetur të shkruar në të:

Ishe i vdekur dhe u bërë i gjallë dhe pas pak do kthehesh i vdekur.

Prandaj për në Bbotën e Përhershme ndërto një shtëpi dhe lëre ndërtimin e shtëpisë së botës që ka fund.

Shembulli i tretë

Bluvher thotë:

Tregohet se një mbret ishte inteligjent dhe i afërt me njerëzit, u rregullonte problemet e tyre. I shikonte me të mirë dhe ishte i drejtë me ta. Ai kishte një vezir (mëkëmbës) të singertë dhe besnik që e ndihmonte në të mirë, ku i mjaftonte ndihma e tij duke u këshilluar me të për çështjet mbretërore. Veziri ishte i moralshëm, i mençur, besimtar, i devotshëm, objektiv dhe i mjaftueshëm me dynjanë (jetën). Ai kishte takuar të parët e fesë, kishte dëgjuar fjalët e tyre dhe kishte njohur mirësitë e tyre, ku iu është përgjigjur, ka marrë shumë nga ata dhe kur është ndarë u ka dhënë fjalën dhe premtimin e tij.

Ai kishte një shtëpi të mirë që ia kishte dhënë mbreti, i cili i përgjigjej gjithmonë për çdo çështje. Në këtë gradë ishte dhe veziri por ai nuk i kishte folur shumë për çështjet e fesë

¹ “Biharul Enuar”; kap.78, f. 401. (Vargjet këtu janë me kuptim dhe jo si në origjinal.)

dhe nuk i kishte treguar të fshehtë e urtësisë. Ata jetuan në këtë mënyrë për një kohë të gjatë. Veziri sa herë që hynte tek mbreti binte në sexhde për idhujt dhe i madhëronte ata thjesht për sy të mbretit.

Veziri priste momentin dhe rastin që t'i fliste mbretit për fe. Por e këshilluan disa të afërm të tij duke i thënë që të ketë kujdes: nëse mbreti nuk beson nuk duhet që pushteti të zhytet me të. Mund të jetë kjo hapje e fesë para tij shkak për eliminimin e njerëzve të fesë tënde.

Një natë vonë mbreti i tha vezirit: A je i gatshëm që të dalim në qytet dhe të shikojmë gjendjen e njerëzve dhe dëmet e shiut që i ka goditur ata këto ditë.

Bënë një shëtitje së bashku në disa zona të qytetit ku kaluan nëpër disa rrugë të mbushura me mbeturina që dukeshin si male. Mbreti pa një dritë zjarri në anën tjetër të mbeturinave dhe i tha vezirit: “Ai zjarr duhet të ketë një histori, prandaj le të zbresim dhe të marrim vesh se çfarë është puna”. Kur arritën tek vendi që jepte dritë zjarri gjetën një kasolle në formën e një shpelle në të cilën ishte një i varfër. Kur u afruan, panë një burrë të varfër, i cili ishte veshur me rroba të vjetra, mesa duket të mbledhura në mbeturina dhe në njërën dorë kishte një ibrik me pije dhe në dorën tjetër kishte një daire që i biente. Afër tij ishte gruaja e tij pak a shumë me të njëjtat veshje e cila kërcente për burrin kur ai i binte daires. Burri sa herë që e ngrete ibrikun për të pirë i dërgonte shëndet mbretit dhe e quante gruan e tij si gruan më të bukur. Të dy së bashku e përshkruanin njëri-tjetrin për të mirë dhe të bukur dhe kështu i kaplonte gëzimi dhe e qeshura e papërshkruar.

Mbreti qëndroi duke e menduar këtë gjë së bashku me të dhe vezirin. Të habitur me kënaqësinë e tyre në atë gjendje që ishin, u larguan.

Mbreti tha: “Nuk besoj se kemi pasur unë dhe ti gëzim dhe kënaqësi të tillë për gjatë gjithë jetës sonë sikurse kishin ata këtë natë dhe besoj se ata kështu e kalojnë çdo natë”.

Veziri shfrytëzoi rastin dhe i tha: “Kam frikë o mbreti im se kjo jeta jonë është një arrogancë, dhe se pasuria jote dhe çfarë kemi ne nga kënaqësia dhe gëzimi në sytë e atij që njeh mbretërinë e përhershme janë sikur ato mbeturinat dhe ata dy personat. Ata të varfërit që pamë se dukeshin si të gëzuar dhe shpërblimet e Botës Tjetër duken si ajo shpellë në sytë tanë. Trupi jonë për ata që njohin pastërtinë, mirësinë dhe shëndetin është sikur trupi i atyre që pamë me sytë tanë dhe se habia e tyre me atë se çfarë jemi ne është sikurse habij jonë me ata dy personat dhe me çfarë kishin ata”.

Mbreti tha: A njeh njerëz me këto cilësi?

Veziri tha: Po

Mbreti tha: Kush janë ata?

Veziri tha: Njerëzit e fesë që kanë njohur Botën Tjetër dhe e kanë kërkuar atë.

Mbreti tha: Kush është mbreti i Botës Tjetër?

Veziri tha: Ai është Mirësia ku s'ka të keqe pas Tij, i Pasuri që nuk ka varfëri pas Tij, Ai është Gëzimi ku nuk ka hidhërim pas Tij, Shëndeti ku nuk ka sëmundje pas Tij, Pëlqimi ku nuk ka kundërshti pas Tij, Siguria ku nuk ka frikë pas Tij, Jeta ku nuk ka vdekje pas Tij, Ai është Mbreti që nuk ka zbritje nga froni, ajo është Bota e Përhershme; s'ka shkëputje dhe ndryshim në të. All'llahu i Madhëruar e ka mbrojtur nga varfëria, sëmundja, dyshimi, humbja, urija, padrejtësia dhe vdekja.

Mbreti tha: A njihni për këtë botë hyrje apo derë dhe rrugë për hyrjen në të.

Veziri tha: Po, është bota e përgatitur për ata që e kanë kërkuar atë dhe kush e ka gjetur derën e saj do të hyjë në të.

Mbreti tha: Çfarë të ka penguar që të më njoftosh për këtë më parë?

Veziri tha: Më ka penguar madhëria juaj dhe respekti për pushtetin tënd.

Mbreti tha: Nëse është kjo çështje e vërtetë, për të cilën na fole, nuk duhet që ta lëmë punën për të dhe duhet që të përpiqemi derisa të meritojmë njohjen e saj.

Veziri tha: A po më urdhëron mua që ta përsëris dhe një herë.

Mbreti tha: Të urdhëroj që të mos kalojë natë as ditë pa më kujtuar këtë gjë sepse çështja është e madhe dhe nuk bëhet lojra me të.

Pas kësaj, mbreti iu përkushtua devotshmërisë në besim dhe në shpëtim.¹

Autori thotë:

E kam parë të arsyeshme për dobi të besimtarëve të kujtoj këtu pjesë nga një predikimi i prijësit të besimtarëve ku ka thënë:

Ruhuni nga kjo botë mashtruese dhe dredharake që është zbukuruar me hilet dhe përçarjet duke zbehur shpresat që i ka nën kontrollin e saj. Është bërë si nuse e stolitur që të gjithë e shikojnë me sy, nefsi i tyre është në ankth për të dhe zemrat e tyre rrahin për të ku me t'u martuar me ta ajo i vret të gjithë.² Mbetjet nga e kaluara nuk merren në konsideratë dhe as e para me gjurmët e saj të këqija nuk kanë lidhje me tjetrën, sa që ka thënë Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!): Çfarë bën të duket se dynjaja është e ulët dhe e keqe, është dhe fakti se All'llahu i Madhëruar e ka zvogëluar dynjanë për të dashurit dhe të zgjedhurit e Tij në shikimin dhe zgjedhjen e tyre. Sikurse e ka bërë shumë të lehtë për armiqtë e Tij në përçarje dhe armiqtësi. Ka nderuar kundrejt saj Muhamedin (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), të Dërguarin e Tij kur largoi dhimbjet e urisë nga barku i tij. Ruajti Musain (paqja qoftë mbi të!) nga sëmundja që kishte në barkun e tij të mos dobësohet.

E vazhdoi prijësi i besimtarëve fjalën përreth devotshmërisë së Profetëve, të cilët e larguan dynjanë dhe e trajtuan atë sikur të ishte diçka e vdekur që nuk i lejohet askujt t'i afrohet vetëm në rast se janë të detyruar, ku mund të hanë prej saj një sasi të vogël sa të mbajnë frymën gjallë. E konsideruan në gradën e një kalbësire ku kalbet çdo moment më shumë dhe kushdo që kalon pranë saj mban hundët me dorë nga era e saj e keqe për sa munden, por nuk përfundojnë kurrë nga era e fëlliqur e saj dhe habiten nga kjo erë, ndërsa ai që është i kënaqur me të e ka për pjesë.

Vëllezër, betohem në All'llah, kështu është me jetën e kësaj bote dhe të Botës Tjetër për atë që e ka kthyer veten e tij në shembull duke ia kushuar atë mendimit më të keq se era e kalbësirës apo dhe më të keqe se era e ngordhësirës, me ndryshim se ai që merret me regjien e lëkurave nuk e ndien erën dhe nuk e shqetëson ajo erë sikurse e dëgjon ai që kalon andej apo ai që ulet tek ai.³

Imami thotë, gjithashtu:

I mjeri ti, nëse lëkundesh nga ajo që shikon dhe u afrosh atyre që ajo i ka gëlltitur sepse ata janë si qenër të uritur dhe kafshë grabitqare që sulmojnë njëra-tjetrën dhe ha e forta të dobtën dhe e madhja të voglën prej tyre.

Autori thotë:

Kuptimin e këtyre fjalëve e ka marrë Senai dhe i ka hedhur në vargje ku thotë:

“Kjo botë është si një ngordhësirë dhe njerëzit përreth saj rrathë-rrathë”

“Kjo futën nën kthetrat e saj të gjithë dhe pastaj i godet ata me sqepin e saj.”

“Dhe, në fund të këtij udhëtimi ikin të gjithë dhe mbetet vetëm kjo ngordhësirë.”

“O Senai, largohu këtyre qenve dhe zgjidh një vend që të qëndrosh në të.”

“Kujdes dhe kujdes se mos të bëjnë si vetet e tyre dhe biesh në kurthin e shejtanit të mallkuar.”

Prijësi i besimtarëve ka thënë:

¹ “Biharul Envar”; kap. 78 fq. 410-412.

² Transmetohet nga imam Sadik se Isait (paqja qoftë mbi të!) i është shfaqur dynjaja në formën e një gruaje esmere, ku ai e ka pyetur dhe i ka thënë: Me sa veta je martuar? Ajo ka thënë: Shumë. Isai i ka thënë: dhe të gjithë të kanë ndarë? Ajo është përgjigjur: Jo, por të gjithë i kam vvarë. Ai i ka thënë: Të mjerë burrat e tu të ardhshëm si nuk i marrin në konsideratë ata të kaluarit. “Sefinetul Bihar” vëll.1 fq. 466.

³ “Sefinetul Bihar”; vëll.1 fq.466-467.

Betohem në All'llahun se kjo dynjaja juaj është e dëmshme në syrin tim sikur shiriti i derrit në dorën e të sëmurit me lebrozë.

Shiriti i derrit nuk lë mish vetëm se kocë, ndërsa lebroza si sëmundje shumë e rëndë. Kjo është përbuzja e dynjasë, sepse kockat nuk kanë vlerë po si do të ishin sikur të ishin kockat e derrit dhe si do të ishte sikur këto kocka të derrit të ishin në dorën e atij që ka lebrozë. Nuk do të kishte gjë më të urryer.

Shembulli i katërt

Besimtari dhe qeni

Ky shembull është i dobishëm në veçanti për ata njerëz të cilët në jetën e tyre kanë përbuzur mirësinë që u ka dhënë Zoti i Madhërishtëm dhe kur të përballen me sprovën dhe vështirësinë, ata do t'i mbulojë mosmirënjohja ndaj mirësisë ku do të përballen me Dhuruesin e Vërtetë. Duke qenë në këtë gjendje ata shpejtojnë për t'u kthyer pas dhe me këtë gjë bëjnë diçka që nuk duhej bërë.

Këtë shembull e ka përmendur shejh El Behaj në "El Kushkul".

Ai thotë: Transmetohet se në një mal në Liban ishte një burrë i devotshëm që ishte shkëputur nga njerëzit dhe qëndronte në një shpellë të këtij mali. Ai agjëronte çdo ditë ku në darkë i vinte një bukë, ku me gjysmën e të cilës hante iftarin dhe me gjysmën tjetër hante syfyryn. Këtë gjë e bënte prej një kohe të gjatë dhe nuk zbriste nga mali.

Një natë prej netësh u ra dakort që të mos i dërgohej buka. Atij iu shtua uria dhe iu pakësua qetësia, fali namazin e jacisë dhe e kaloi këtë natë në pritje të ndonjë gjëje që do t'i largonte urinë por nuk iu mundësua asnjë gjë e tillë.

Në rrëzë të malit ishte një fshat i banuar nga të krishterët. Në të zbardhur, besimtari zbriti tek ata, ku kërkoi ushqim nga një i moshuar i cili i dha dy bukë elbi. Besimtari i mori ato dhe u drejtua për në mal.

Në shtëpinë e këtij plakut të krishterë ishte një qen i dobët dhe i zgjebosur, i cili e arriti besimtarin dhe i lehu duke u varur në rrobat e tij. Besimtari i hodhi njëren nga bukët që të largohej nga ai. Qeni e hëngri bukën dhe arriti besimtarin për herë të dytë dhe filloj t'i lehte duke iu vërsulur. Besimtari ia hodhi qenit dhe bukën tjetër, por ai e hëngri dhe e arriti përsëri besimtarin dhe i egërsoi të lehurat sa që e kapi besimtarin për rrobash dhe e grisi atë. Besimtari tha: Madhërija i takon All'llahut, unë nuk kam parë qen më të paturpshëm se ti, pronari yt më dha vetëm dy bukë të cilat m'i more ti, po çfarë kërkon me lehjen tënde dhe me grisjen e rrobave të mia?

All'llahu i Madhëruar i dha gojë qenit që të fliste dhe ai tha:

Unë nuk jam i paturpshëm, dije se unë jam rritur në shtëpinë e atij kristjanit ku kujdesem për delet e tij dhe i ruaj shtëpinë. Mjaftohem me çfarë më hedh nga kockat dhe buka, por ka raste që më harron dhe ngel me ditë pa ngrënë gjë. Madje, ka mundësi që kalojnë ditë dhe ai nuk gjen as për vete dhe as për mua gjë për të ngrënë, por unë përsëri nuk e braktis shtëpinë e tij që kur kam njohur veten time dhe nuk i jam drejtuar asnjëherë ndonjë shtëpie tjetër. Nga morali im ka qenë që nëse më ka gjetur gjë për të ngrënë e kam falënderuar dhe nëse jo kam duruar. Ndërsa ti, me ndërprerjen e bukës një natë të vetme, nuk gjete tek vetja durim. Nuk munde që të qëndrosh derisa u drejtove nga dera e furnizuesit të besimtarit tek dera e një të krishterit, nxore sekretin nga i dashuri dhe miqësorë armiqte e tij të dyshimtë. Kush nga ne është më i paturpshëm unë apo ti!!!

Kur dëgjoi besimtari këtë goditi kokën e tij me duar dhe ra duke u mbuluar me to.¹

Autori thotë:

Nuk ka më bukur se të sjellë këtu fjalët e shejh Sa'dij ku thotë:

¹ "El Keshkul"; vëll. 1 fq. 124-125. Këtë histori shejh Behaji e ka thurur, gjithashtu, dhe në poezi në gjuhën perse dhe autori një pjesë të këtyre vargjeve i ka sjellë me shkurtime.

Shkaku i krijesave të tjera sipas asaj që duket është njeriu dhe modestia e atyre që ekzistojnë është qeni. Mendimtarët kanë rënë dakort se qeni besnik është më i mirë se njeriu jobesnik, i cili nuk falënderon atë që i jep mirësinë.

“Qeni nuk e harron kafshatën që i kam dhënë edhe sikur ta godas me gurë njëqind herë.”

“Por sikur të kujdesesh për një njeri të ulët për gjatë gjithë jetës së tij, mund të të kapë për fyti për më të voglin shkak.”

Është mëse e domosdoshme dhe e dobishme që të përmend këtu një hadith të nderuar, i cili ndriçon zemrën dhe hap sytë.

Transmetohet se imam Sadiku kishte një djalë i cili i ruante mushkën e tij kur hynte për t'u falur në xhami. Në një rast, kur djali ishte i ulur, pranë tij ishte dhe mushka, erdhi një grup nga Horasani ku një burrë nga grupi i tha: A mund ta pyetësh që të më lirojë vendin e tij dhe do të jap shumë gjëra, do të jap të gjithë pasurinë time sepse unë jam i pasur në shumë drejtime, prandaj shko merr lirinë nga ai, unë të jem me mushkën time në vend të tij.

Djali tha: Të pyes për këtë. Ai hyri tek Ebu Abdullah dhe i tha: Tu bëfsha dëshmorë, ti e di shërbimin tim dhe kohën e gjatë që të kam shoqëruar, nëse më ka dërguar All'llahu i Madhëruar një të mirë a do të më ndalosh mua në të?

Imam Sadiku i tha: Të jap nga vetja ime dhe të ndaloj nga të tjerët.

Djali i tregoi historinë e burrit dhe imam Sadiku i tha: Nëse je bezdisur duke na shërbyer dhe të pëlqen më shumë burri se ne atëherë ne pranojmë dhe të dërgojmë, dhe kur desh ti i jepte lirinë e thirri dhe i tha: Të këshilloj që të zgjatësh shoqërimin, sepse ti ke në dorë zgjedhjen. Në Ditën e Kijametit Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi tël) do të jetë i lidhur me Dritën e All'llahut të Madhëruar, prijësi i besimtarëve do të jetë i lidhur me Profetin e Zotit, imamët do të jenë të lidhur me prijësin e besimtarëve, ndërsa ndjekësit tanë do të jenë të lidhur me ne dhe do të hynë aty ku do të hymë ne dhe do të priten sikurse do të pritemi ne.

Djali tha: Do të jem nën shërbimin tënd dhe do të preferoj Botën Tjetër nga kjo botë.

Doli djali për tek burri i cili i tha: Dole tek unë me një fytyrë tjetër nga ajo me të cilën hyre. Djali i tregoi ndodhinë dhe e futi burrin tek Ebi Abdullah, i cili pranoi drejtësinë e tij dhe urdhëroi që t'i jepen djalit një mijë dinar.¹

I njëjti person i thothë imam Sadikut: O zotëria im, unë që kur mbaj mend e di veten në shtëpinë tuaj, më është rritur trupi dhe lëkura nga mirësitë tuaja, ju lutem që të më mbani këtu deri në momentin e fundit të jetës time dhe të mos më largoni nga shtëpia juaj. Unë them me gjuhë dhe me shpirt gjithmonë.

Nga kujdesi juaj si të largohem; ajri juaj për mua është nder.

Zotëria im, më mirë të mos jetoj kur të shoh veten duke qëndruar para shtëpisë së dikujt tjetër.

Shembulli i pestë

Ultësia e injorancës dhe kërkimi i diturisë dhe artit

Ebu Kasim Ragib el Esfehanejji në librin e tij “Edh Dherrijetu” ka përmendur se një burrë filozof , i ditur ka shkuar tek një burrë ku ka parë shtëpinë e tij të mobiluar dhe zbukuruar me sexhade mbretërore, por i zoti i shtëpisë ishte injorant dhe i zhveshur nga ana e dijes dhe nga kjo anë ai ishte thjesht në formën e njeriut.

Kur e pa filozofi përshtyu në fytyrën e burrit të paditur, i cili u habit nga sjellja e tij dhe tha: Çfarë është kjo idiotësi dhe budallallëk që bëre o filozof?

¹ “Biharul Enuar”; kap. 47, fq. 50-51.

Filozofi tha: Kjo nuk është idiotësi, por kjo është një urtësi sepse pështyma hidhet në vendin më të pisët të shtëpisë dhe nuk gjeta vend tjetër më të pisët në shtëpinë tënde se sa ti, prandaj mendova si vend të tillë.

Autori thotë:

Shiko burrin e ditur në krahasim me injorantin dhe të ulët në dije dhe se padija e tij nuk plotësohet me mbushjen e shtëpisë dhe të paturit e rrobave të mira. Prandaj, është e qartë se mirësia e ditorisë qëndron në të praktikuarit e saj me punë, sepse kështu të dyja së bashku janë si dy binjakë që shkojnë së bashku. I ka qëlluar ai që ka thënë:

“Për në qiellin e pafund nuk ka shkallë më të mira se dituria dhe puna.”

“Dituria të shpie tek dera e All’llahut të Madhëruar dhe jo tek mbretëria, pasuria dhe mirësia.”

“Ai që nuk merr nga kjo, është i humbur dhe i pamundur për të arritur tek kjo mirësi.”

“Puna pa dituri është si fara e hedhur në tokë të kripur dhe dija pa punë është si i gjalli në varr.”

“Të ditorit dhe mospunimi me këtë dituri është argument i All’llahut të Madhëruar kundra teje.”¹

Isai (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: Njeriu më i pakënaqur është ai që njihet nga njerëzit për dijen e tij dhe nuk njihet për punën e tij.

Filozofi Senai thotë:

“O njeri që pëlqen lodrat, lodrat tua zemërojnë Zotin.”

“I përkushtohesh rrugës, por je i humbur, nuk njeh forcë dhe ti je i ulët.”

“Padituria është më mirë se dituria që të ka gëzuar ty njëqind herë.”

“Është e neveritshme kjo dituri që i dëgjon vetëm fjalët dhe nuk dëgjon nga ajo punë.”

“Mësuesi juaj është i pakujdesshëm për pasojë dhe ju, a e zgjon nga gjumi i fjeturi të fjeturin.”

“Kur do të bëhesh i pastër, përderisa nuk largon nga dera qenin dhe nuk largon mbulesën që ke para vetes.”

“Kjo që ke në gjoksin tënd është fshat dhe jo zemër, sepse është e mbushur me lopë, gomarë, mobilime dhe të padobishme.”

“Udhëheqësi, Drejtuesi, Sirati është All’llahu i Madhëruar dhe mos mendo se ka më të mirë se Kur’ani dhe hadithi.”

Mbyllja e librit

Përfundoi çfarë ka qenë e caktuar të shkruaj në këtë libër të nderuar në mesin e muajit të Ramazanit të Madhërueshëm të vitit 1347 sipas kalendarit hënor, ditën e lindjes së imam Hasanit. Meqë libri është përfunduar në këtë muaj të nderuar, është e rastit që ta mbyll me dy lutje:

E Para:

Transmetohet nga shejh Mufidi në “El Mukniatu” sipas një vargu të sigurt nga Ali Bin Mehzejari se Ebu Xhaferi (paqja qoftë mbi të!) pëlqente ta thonte shumë këtë lutje në çdo kohë të natës dhe të ditës gjatë këtij muajit nga fillimi deri në mbarim:

O Ti që ke qenë para çdo gjëje, pastaj krijove çdo gjë, pastaj përfundon dhe shkatërrohet çdo gjë. O Ti që nuk të përngjason askush, O Ti që në qiejt e lartë dhe në tokën e ulët nuk ka sipër tyre, poshtë tyre dhe në mes tyre Zot tjetër që adhurohet veç Teje. Për Ty është falënderimi, falënderim që nuk e meriton kush tjetër veç Teje. Mëshiroje Muhammedin dhe familjen e tij; më shumë se Ju nuk i mëshiron kush tjetër.

E Dyta:

¹ Kuptimi i vargjeve nga persishtja.

Shejh Kulejni si dhe të tjerë transmetojnë se Imam Sadiku ia ka mësuar Zerares këtë dua që të lutet me të në kohën kur njerëzit vetëm do të marrin nëpër gojë të tjerët dhe në spovën e shijave:

O Zot më mundëso të të njoh Ty, nëse nuk të njoh Ty nuk do të njoh të Dërguarin Tënd. O Zot më mundëso të njoh Profetët Tuaj, nëse nuk njoh Profetët nuk do të di argumentet Tuaja. O Zot më mundëso të njoh argumentet Tuaja, nëse nuk njoh argumentet tuaja do të rrëshkas nga feja ime.

Dijetarët kanë thënë së është vaxhib në kohën e gïbetit (përgojimit) lutja për imamin e kohës dhe besnikëria ndaj tij. Nga duatë e pëlqyera, gjithashtu, që lexohen pas Madhërimit të All'lahut dhe salavateve mbi të Dërguarin dhe familjen e tij është dhe kjo:

O Zot ji dëshmitarë për mëkëmbësin Tënd, Ibn Hasanin, mëshira Jote qoftë mbi të dhe mbi prindërit e tij në këtë orë. Në çdo orë që vjen ji mbrojtës, ruajtës, dhe ndihmues për të, deri sa të jetë banorë në tokën tënde me dëshirë dhe mundësoja atij për një kohë të gjatë.

